



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“MBI AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
“INSTITUTIN E STATISTIKAVE”

TIRANË, Shtator 2024

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
II. HYRJA	8
a. Objektivat dhe qëllimi	11
b. Identifikimi i çështjes.....	12
c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese	13
d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:.....	13
e. Kriteret e vlerësimit:	13
f. Standardet e Auditimit.....	14
g) Metodot e auditimit.....	14
h) Dokumentimi i auditimit	15
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16
1. Informacion i Përgjithshëm.....	16
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	16
2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.	16
2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.	28
2.3 Auditimi i llogarive vjetore.....	34
2.4 Prokurimet e fondeve publike.	52
2.5 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.	96
2.6 Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....	108
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	116
V. ANEKSE.....	135
VI. LISTA E DOKUMENTEVE.....	143

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 505/1, datë 15.04.2024, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditori Institutin e Statistikave (INSTAT), për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Njohjen me aktivitetin ekonomiko-financiar të saj dhe organizimin e funksionimin sipas rregulloreve të miratuara.

2. Vlerësimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe auditimin e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2021, 2022 dhe 2023 si dhe transaksionet financiare për gjithë periudhën objekt auditimi, detyrimeve të prapambetura etj.

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika cilësore, asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Si institucioni që disponon burimin më të madh të informacionit statistikor në Shqipëri, INSTAT përpiqet t'u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje, kërkime dhe arsimim në Shqipëri. INSTAT ndihmon komunitetin e interesuar ndërkombëtar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor relativ, të sigurt dhe të krahasueshëm.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si organi Kushtetues i kontrollit të fondeve buxhetore ka për qëllim që, nga studimi i vlerësimit të riskut në lidhje me menaxhimin e fondeve buxhetore vjetore të INSTAT, për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, të auditojë nëse këto fonde janë përdorur me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë.

b. Rëndësia e auditimit.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të ndikimit në publik mbi transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve të Buxhetit të shtetit, në drejtim të prodhimit të statistikave zyrtare cilësore, asnjëse, transparente dhe të përditësuara.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2021 deri ne 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë gjetje e rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga INSTAT. Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit;

- Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;

- Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik;

- Zbatimi i dispozitave ligjore në funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm, etj.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e blerjeve është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të Audituesve janë përdorur veçmas

ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

Verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se INSTAT për periudhën në auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 27 gjetje/masa organizative, 2/Gjetje/masa për eliminimin e efekteve negative financiare dhe ka dhënë 38 rekomandime.

f. Gjetjet kryesore sipas drejtimeve.

I. Sipas drejtimit 1: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit u konstatuan:

1. Nga auditimi i PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026 të përgatitura konstatohet se në institucionin e INSTAT nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-ve, si dhe nuk ka dokumentim të minutave të takimit për mbledhjet e EMP-së;

2. Nga auditimi u konstatua se INSTAT ka hartuar raportet e monitorimit 4 mujore të konsoliduara, por nga ana institucioneve të varësisë (*Zyrat Rajonale Statistike*), si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raporte monitorimi 4 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete. Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se në relacionin shpjegues përmbledhës, analiza sipas zërave buxhetorë është kryer vetëm pas planit të rishikuar të buxhetit, e jo planit fillestar në PBA, duke sjellë mungesën e një analize të qartë në lidhje me ndryshimet dhe devijimet e planit të rishikuar në krahasim me planin fillestar. Nga ana tjetër, u konstatua se nuk janë analizuar dhe argumentuar në mënyrë shteruese shpenzimet operative, projektet dhe investimet të realizuara, si dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e punës në INSTAT, si dhe sa i takon kërkesave për ndryshime buxhetore të ndodhura gjatë vitit, nuk ka argumentim të plotë për të cilat janë realizuar këto ndryshime.

II. Sipas drejtimit 2: Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, u konstatuan:

1. Nga auditimi i urdhërshpenzimeve mbi ardhurave të trashëguara nga donatorët ndër vite, konstatohet se për 6 (gjashtë) urdhërshpenzime në shumën prej 2,213,360 lekë për dieta jashtë vendit dhe bileta avioni janë likuiduar në mospërputhje me marrëveshjet/kontratat përkatëse me donatorët IPA 2015, IPA 2017, si dhe legjislacionin shqiptar, specifikisht VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*", lidhja 1. Nga auditimi i kontratave specifike të lidhura me donatorët IPA 2015 dhe IPA 2017, konstatohet se për pagesën e dietave/biletave të avionit ku përfaqësues të INSTAT kanë qenë pjesëmarrës nëpër konferenca/forume të ndryshme, të cilat nuk janë kryer në përputhje me objektin e marrëveshjes së lidhur, por janë përdorur sipas vendimmarrjes të INSTAT-it, duke mos u bazuar në legjislacionin shqiptar. Për rrjedhojë, vlera e paguar në shumën prej 2,213,360 lekë , konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shtetit.

2. Nga auditimi me zgjedhje i urdhërshpenzimeve me datën e faturës tatimore, nga ana e grupit të auditimit u konstatua se për vitet 2022 dhe 2023 u konstatua se janë kryer likuidime në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor. Konkretisht, nga kryerja e testeve mbi urdhër shpenzimet, u konstatuan se 46 urdhër shpenzime të vitit 2022 dhe 96 urdhër shpenzime të vitit 2023, të cilat janë likuiduar mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore.

III. Sipas drejtimit 3: Auditimi i pasqyrave financiare, periudha 2021-2023, u konstatuan:

1. Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura dhe njohjes së tyre në pasqyrat financiare të INSTAT u konstatua se:

1. detyrimet e prapambetura të regjistruara mbi sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si edhe tatimit nga të ardhurat personale paraqiten në shumën 0 (zero) lekë, ku nga krahasimi i kryer me të dhënat e raportuara nga sistemi C@ts konstatohet se INSTAT ka gjendjen e detyrimeve në shumën 1,387,556 lekë. Periudha e lindjes së këtyre detyrimeve fillon që nga viti 2014. Institucioni nuk ka marrë asnjë masë për evidentimin dhe pasqyrimin e këtyre detyrimeve në pasqyrat financiare apo asnjë masë që të kryejë shlyerjen e tyre. Gjithashtu institucioni nuk ka marrë asnjë masë për evitimin e lindjes së këtyre detyrimeve të cilat janë përgjegjësi e punonjësve të cilët merren me deklarin e këtyre detyrimeve në sistemin C@ts. Detyrimet e lindura gjoha për “*Deklarime te vonuara*” në shumën 1,000,000 lekë janë shumë lehte të evitueshme duke bere deklarimet në kohë. Sa më sipër, diferenca prej 1,387,556 lekë nuk është njohur dhe regjistruar në pasqyrat financiare të institucionit;

2. Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore, njohjen e tyre në kontabilitet dhe likuidimin e tyre nëpërmjet bankës rezultoi se në vitin 2023 janë likuiduar në shumën totale vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë në shumën prej 818,960 lekë

Këto vendime gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer.

- Si pasojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2022 dhe 2023. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.

- Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit.

3. Nga auditimi i rakordimit të të ardhurave konstatohet se kemi mospërputhje midis pasqyrës së performancës me rakordimin e thesarit, konkretisht në rakordim “*Te ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve*” paraqiten në shumën 48,486,700 lekë, ndërsa në pasqyrën e performancës paraqiten në shumën 37,704,000, pra me një diferencë prej 10,782,700 lekë, të pajustificuara. Gjithashtu, sa i takon njohjes së granteve të huaja, nga grupi i auditimit konstatohet se grantet e huaja në INSTAT, nuk janë njohur në pasqyrat financiare në total, por paraqiten vetëm në vlerën e cila është përdorur gjatë vitit ushtrimor. Mos njohja e shumës totale të granteve dhe sponsorimeve në pasqyrat financiare sjell një pasqyrim jo të drejtë të këtyre fondeve.

4. Nga auditimi i pasqyrës së aktiveve neto konstatohet se llogaria 105 “*Teprica e granteve kapitale të brendshme*” në shumën 296,350,065 lekë e cila përfaqëson investimet nga buxheti për vitin 2023 dhe llogaria 106 “*Teprica e granteve kapitale te huaja*”, e cila përfaqëson investimet nga organizatat e huaja, dhe pse janë investime të cilat janë përfunduar brenda vitit 2023, rezulton se nuk janë kapitalizuar brenda periudhës ushtrimore të vitit 2023

IV. Sipas drejtimit 4: Auditimi i procedurave të prokurimeve publike si dhe zbatimi i kontratave, për periudhën 2021-2023, u konstatuan:

1. Nga auditimi me përzgjedhje mbi bazë risku i procedurave të prokurimit u konstatua:

- Në 8 dosje prokurimi dokumentacioni justifikues i procedurës nuk ishte i protokolluar.

- Në të gjithë procedurat e prokurimit fizike të arkivuara mungonte dokumentacioni i nevojshëm për gjurmë auditimi.

-Në 4 raste procedurat e prokurimit nuk ishin të arkivuara në SPE.

- Në 8 dosjet e audituara nuk dokumentohet verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE para shpalljes së fituesit.

2. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.962/8, datë 27.07.2023 me objekt “*Trajtimin e punonjësve me catering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS 2023*” me vlerë u konstatua se me urdhrin nr.98, datë 01.08.2023 të titullarit të AK është caktuar një punonjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, dhe nuk është ngritur një komision për marrjen në dorëzim të shërbimit, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 42-43.

Nga auditimi i praktikës së bashkëlidhur urdhër shpenzimit, procesverbalet e hartuara, konkretisht i datë 31.08.2023 dhe një procesverbal pa datë por që i bashkëlidhet faturës të datës 04.10.2023, për marrjen në dorëzim nuk janë të shoqëruara me listat emërore të pjesëmarrësve siç citohet në procesverbal nga personi i ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

3. Nga auditimi u konstatua se blerja e biletave është realizuar në kufijtë e datës së nisjes megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/ aktivitetit është dërguar disa javë para kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave. Kjo ka ardhur si pasojë e miratimit me vonesë të autorizimeve, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të INSTAT në këto aktivitete. Një fenomen i tillë sjell si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë, kur prokurohet pak ditë para datës së nisjes, krahasuar me çmimet e tregut.

4. Nga auditimi u konstatua se INSTAT ka planifikuar dhe realizuar tre procedura të prokurimit me vlerë të vogël me objekt “*Shërbimin e monitorimit mediatik*” për vitet objekt auditimi, konkretisht për vitin 2021 me vlerën 458.900 lekë (mosrealizim kontrate), për vitin 2022 me vlerën 733,323 lekë me tvsh dhe 2023 me vlerën totale 720.000 lekë me tvsh. Referuar kontratave të nënshkruara me OE respektivë rezultoi se më anë të këtyre prokurimeve janë ndërtuar arkiva elektronike të çdo lajmi në mediat e monitoruara, shërbim ky, që duhet të realizohej nga pozicioni specifik i parashikuar në strukturën e institucionit, ‘*Specialisti për Monitorimin dhe Raportimin Mediatik*’ i cili ka detyrë funksionale realizimin e shërbimit për të cilin është pajtuar OE, bazuar në Rregulloren e Brendshme të INSTAT dhe përshkrimeve të pozicioneve të punës. Planifikimi dhe realizimi i këtyre shpenzimeve është bërë pa efektivitet në vlerën 1,453,323 lekë.

V. Sipas drejtimit 6: Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit, mbi auditimin e magazinës Cens, u konstatuan:

1. Nga auditimi i fazës parapërgatitore e Projektit të Cens-it 2023 u konstatua se INSTAT ka detyrimin të marrë të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurisë për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në instalimet ku të dhënat personale të censit mbahen, përpunohen ose ruhen, dhe për t’i mbrojtur ato nga shkatërrimet e paligjshme, aksidentale, humbjet aksidentale, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. INSTAT-i duhet t’i trajtojë të dhënat e mbledhura, të përpunuara e të ruajtura të censit si rreptësisht konfidenciale duke mos lejuar individët dhe njësitë e tjera statistikore të identifikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Grupi i ngritur nga titullari i INSTAT për sigurimin e një ambienti (magazinë) “**privat**” (me kontratë qiraje), për vendosjen e pajisjeve elektronike të cilat shërbejnë për grumbullimin e të dhënave të popullsisë dhe banesave, në kuadër të organizimit të të gjithë procesit të Cens-it 2023 bazuar në kërkesën e Ekipit të Organizimit dhe Logjistikës cënon parashikimet ligjore duke rrezikuar në mënyrë të ndjeshme parimet e “sigurisë” së të dhënave sensitive si edhe “konfidencialitetin” e tyre, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”, pikat 4 dhe 5.

2. Për periudhën 2021-2023, Komisioni Qendror i Censit, i cili është një organ i cili ndjek përgatitjen dhe zbatimin e Cens-it si edhe mbështet INSTAT-in për çdo problematikë që mund të dalë gjatë projektit të Cens-it duke bashkërenduar punën me të gjitha Institucionet Publike dhe Ministrinë e Linjës, është mbledhur 2(dy) herë dhe është mjaftuar me informacionet periodike të

hartuara nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Cens-it të dorëzuara tek ky komision nëpërmjet postës elektronike. Nga auditimi i raporteve periodike të dërguara nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Cens-it, konstatohet se sa i takon sigurimit të një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për pajisjet elektronike (tableta), të cilat përdoren për grumbullimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre, në rast të problematikave në këtë drejtim si një nga pjesët e zbatimit të projektit të Cens-it, KQC nuk është vënë në dijeni nga ana e INSTAT-it, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”, neni 11 e 12.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

2.1: Instituti i Statistikave, në bashkëpunim me njësitë shpenzuese në varësi të saj dhe ekipet e ngritura për menaxhimin e programeve buxhetore, të marrin masat e nevojshme për rritjen e bashkëpunimit me tyre dhe kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucional, me qëllim shmangien e ndryshimeve të paargumentuara të fondeve në buxhet;

4.1: Nga ana e strukturave drejtuese përkatëse në INSTAT të merren masat për planifikimin sa më real dhe të besueshëm të buxhetit, duke planifikuar dhe miratuar përdorimin e të ardhurave të trashëguara nga donacionet sipas nevojave të INSTAT, me qëllim përdorimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të burimeve;

4.3: Drejtoria e Financës dhe Projekteve të marrë masat e nevojshme, që për çdo përdorim të të ardhurave të trashëguara, për nevojat e institucionit për blerje mallra/shërbime/punë të përgatisë kërkesën për rritje të autorizuar, duke specifikuar rritjen e kërkuar për secilin artikull.

7.1: INSTAT të marrë masat për një planifikim/programim sa më real dhe të besueshëm të buxhetit, duke u mbështetur në analizën e të dhënave që raportohet nga Sektori i Financës, me qëllim shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura;

17.1: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vazhdimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat mund ta vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

19.1: Titullari i Institucionit të INSTAT të marrë masa në vijimësi, që çdo dokument i krijuar nga vetë Institucioni, si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, të evidentohen në regjistrin e protokollit të institucionit, si dhe të jenë pjesë e dosjeve të arkivuara;

20.1: Titullarit i INSTAT të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune për verifikimin, analizimin dhe dokumentimin e zbatimit të kontratës, pasi ndjekja e zbatimit të saj nga një person nuk ofron siguri të arsyeshme të përdorimit të fondeve të shpenzuara për këtë shërbim;

22.1: Titullari i institucionit të marrë masa që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet jo në datë të përafërt (apo brenda ditës) me datën e nisjes;

25.1 Nga ana e Titullarit të Institucionit në bashkëpunim me strukturat drejtuese në INSTAT, të merren masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin e mangësive të evidentuara gjatë fazës së planifikimit të kryerjes së Projektit të Cens-it, mbi procedurat e magazinimit të pajisjeve elektronike në një ambient privat, duke sjellë risk të lartë mbi sigurinë e të dhënave, si dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse mbi mospërputhjen e specifikimeve teknike

midis kërkesës drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe kërkesave të parashikuara nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës (EOL).

26.1: Nga ana e Titullarit të Institucionit në bashkëpunim me strukturat drejtuese në INSTAT të merren masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizimin e problematikave të konstatuara në lidhje me procesin e përzgjedhjes së ambienteve dhe pas evidentimit të mangësive në lidhje me kushtet e sigurisë, të kryhen përmirësimet konkrete duke rishikuar kushtet e kontratës së qirasë, me qëllim parandalimin në të ardhmen për rreziqet e mundshme nga humbja e të dhënave sensitive në kuadër të Projektit të Cens-it 2023.

27.1: Nga ana e Strukturave përgjegjëse të merren masat e nevojshme për finalizimin e procesit të mbledhjes së tabelave që vijojnë të jenë në përdorim për projekte dhe anketa të ndryshme jashtë Projektit të Cens-it, me qëllim reduktimin e riskut mbi dokumentimin e plotë të gjurmës së auditimit.

1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

1. Opinioni për auditimin financiar¹: i kualifikuar²:

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Institutit të Statistikave, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për Opinionin*”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

1 - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

2 -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 24,274 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një *“Opinionit të Kualifikuar”* të auditimit.

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në institucionin e pavarur Instituti i Statistikave, sipas kërkesave të legjislacionit mbi buxhetin dhe kontabilitetin, kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, të identifikuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale rezulton se për llogaritë 203 *“Koncesione, patenta, licenca të ngjashme”*, 214 *“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”*, 215 *“Mjete transporti”*, 218 *“Inventar ekonomik”* norma e amortizimit nuk është përlllogaritur bazuar në përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

- Nga auditimi i llogarisë 42 *“Detyrime ndaj personelit”* konstatohet kontabilizimi i detyrimeve për qira ambientesh duke sjellë paraqitje jo të saktë të llogarive përkatëse të detyrimeve ndaj personelit dhe ndaj të tretëve;

-Nga auditimi i llogarive 435 *“Sigurime shoqërore”* dhe 436 *“Sigurime shëndetësore”* në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohet se tepricat e tyre paraqesin vlerën kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 të cilat nuk rakordojnë me listepagesën E-sig025 të deklaruar në sistemin e tatimeve C@ts. Shumat sipas deklarimeve sistemin e tatimeve C@ts janë 13,055,383 lekë për sigurime shoqërore edhe 1,893,610 lekë për sigurime shëndetësore. Në pasqyrat financiare tepricat e kontabilizuara llogaritë përkatëse janë 3,959,995 leke dhe 487,512 lekë duke sjellë paraqitje jo të saktë të këtyre llogarive.

- Nga auditimi i llogarisë 437, 438 *“Organizma të tjerë shtetërore”* konstatohet se teprica e saj në shumën 6,442,766 lekë përfaqëson kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 për punonjësit me kontratë, Teprica e kësaj llogarie duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 435, *“Sigurime shoqërore”* dhe llogarinë 436 *“Sigurime shëndetësore”*.

- Nga auditimi i llogarisë 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* konstatohet kontabilizimi i detyrimeve për paga, dieta, kompensime dhe shpërblime si dhe kreditorë të ndryshëm.

-Nga auditimi i pasqyrës së aktiveve neto konstatohet se llogaria 105 *“Teprica e granteve kapitale të brendshme”* në shumën 296,350,065 lekë e cila përfaqëson investimet nga buxheti për vitin 2023 dhe llogaria 106 *“Teprica e granteve kapitale të huaja”*, e cila përfaqëson investimet nga organizatat e huaja, dhe pse janë investime të cilat janë përfunduar brenda vitit 2023, rezulton se nuk janë kapitalizuar brenda periudhës ushtrimore të vitit 2023, por janë mbyllur me teprica. Nga auditimi i rakordimit të të ardhurave konstatohet se kemi mospërputhje midis pasqyrës së performancës me rakordimin e thesarit, konkretisht në rakordim *“Te ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve”* paraqiten në shumën 48,486,700 lekë, ndërsa në pasqyrën e performancës paraqiten në shumën 37,704,000, pra me një diferencë prej 10,782,700 lekë, të pajustificuara. Gjithashtu, sa i takon njohjes së granteve të huaja, nga grupi i auditimit konstatohet se grantet e huaja në INSTAT, nuk janë njohur në pasqyrat financiare në total, por paraqiten vetëm në vlerën e cila është përdorur gjatë vitit ushtrimor. Mos njohja e shumës totale të granteve dhe sponsorimeve në pasqyrat financiare sjell një pasqyrim jo të drejtë të këtyre fondeve.

-Nga auditimi i shpenzimeve dhe rakordimit me thesarin, konstatohet se për shpenzimeve për blerje mallra dhe shërbime janë kontabilizuar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Nga auditimi i llogarisë analitike 602, konstatohet klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve në nënlllogaritë e saj, e cila ka sjellë denatyrimin e shpenzimit të kryer

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (i Kualifikuar³).

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit INSTAT me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e INSTAT, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë”.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Instituti i Statistikave në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga INSTAT dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar**.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

1. Nga auditimi i procedurës mbi përzgjedhjen e ambientit për magazinimin e materialeve dhe tabletave për realizimin e CENS-it, konstatohet se ka një mospërputhje të specifikimeve të kërkuara për ambientin (magazinë) ku do të mbahen pajisjet elektronike me kërkesat drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe kërkesës së Ekipit të Organizimit dhe Logjistikës (EOL) drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të INSTAT-it, konkretisht:

- Referuar procesverbalit mbi vlerësimin e ofertave të paraqitura, Komisioni i ngritur për përzgjedhjen e ambientit (magazinë) me qira në kuadër të Projektit të Cens 2023 nuk ka respektuar përcaktimet e pikës 5 dhe 6 të Urdhrit të DP nr.76 datë 13.06.2023, konkretisht nga 4 (katër) oferta pjesëmarrëse, nga të cilat vetëm njëra prej tyre rezultoi sipas specifikimeve të kërkuara.

- Sa i takon procesit të sigurimit të një ambienti për magazinim të pajisjeve, INSTAT nuk i është përmbajtur specifikimeve të sipërfaqeve sipas kërkesës fillestare drejtuar MM-së, si dhe gjatë procesit të marrjes me qira të ambientit nga lidhja e kontratës bashkë me amendimin e kryer, i gjithë procesi ka qenë i pa argumentuar dhe i pa studiuar, konkretisht duke mos i'u përmbajtur kërkesave fillestare të përcaktuara në lidhje me sipërfaqen e ambientit si dhe nëpërmjet amendimit të kontratës së qirasë me qëllim zgjatjen e afatit mbi të cilin nuk paraqitet një analizë konkrete me arsyet specifike të këtij ndryshimi. Nga verifikimi në terren i ambientit të kontraktuar me qira,

³ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

njësia “Garazh” është përdorur si parkim gjatë dorëzimit të materialeve për procesin e Cens, si dhe marrjes në dorëzim pas mbylljes së procesit, por aktualisht, kjo njësi nuk ka asnjë material brenda dhe nuk përdoret nga INSTAT, por vazhdon të paguhet qira mujore.

2. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.962/8, datë 27.07.2023 me objekt “*Trajtimin e punonjësve me katering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS 2023*” me vlerë 38,803,105 lekë u konstatua se me urdhrin nr.98, datë 01.08.2023 të titullarit të AK është caktuar një punonjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, dhe nuk është ngritur një komision për marrjen në dorëzim të shërbimit, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pika 42-43.

Nga auditimi i praktikës bashkëlidhur urdhër shpenzimit si dhe faturës së datës 04.10.2023, evidentohet se është dhe një procesverbal pa datë për marrjen në dorëzim, i cili nuk është shoqëruar me listat emërore të pjesëmarrësve në trajnim si detyrim për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

3. Nga auditimi i procedurave të prokurimit të realizuara nga INSTAT për vitin 2023 u konstatua se Urdhri i titullarit të AK për ngritjen e komisionit të vlerësimit për procedurat e prokurimit; “*Blerje licenca*”, “*Blerje tonera*”, “*Furnizime me automjete me qira për CENS*”) ka përfshirë të njëjtët zyrtarë që janë angazhuar në procese të tjera, siç është përllogaritja e fondit limit; Në procedurat e prokurimit Anëtarët e grupit të përllogaritjes së fondit limit nuk kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit; Në dosjet e audituara nuk dokumentohej formulari për zbatimin dhe raportimin e zbatimit të kontratës; Nga auditimi u konstatua se komisioni i blerjeve të vogla në INSTAT për dy procedura prokurimi me objekt “*Shërbim larje automjetesh*” të realizuara për vitin 2022 dhe 2023 *mungon argumentimi i kriterëve të kualifikimit.*

3. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve nga të ardhurat e trashëguara ndër vite, me burim donacionet, konstatohet se për 6 (gjashtë) urdhër shpenzime në shumën prej 2,213,360 lekë për dieta jashtë vendit dhe bileta avioni janë likuiduar në mospërputhje me marrëveshjet/kontratat përkatëse me donatorët IPA 2015, IPA 2017, si dhe legjislacionin shqiptar, specifikisht VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*”, lidhja

4. Nga auditimi i kontratave specifike të lidhura me donatorët IPA 2015 dhe IPA 2017, konstatohet se për pagesën e dietave/biletave të avionit ku përfaqësues të INSTAT kanë qenë pjesëmarrës nëpër konferenca/forume të ndryshme, të cilat nuk janë kryer në përputhje me objektin e marrëveshjes së lidhur, por janë përdorur sipas vendimmarrjes të INSTAT-it, duke mos u bazuar në legjislacionin shqiptar.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*”, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 505/1 prot., datë 15.04.2024, i ndryshuar, në INSTAT, nga data 16.04.2024 deri më datën 04.07.2024, për periudhën e auditimit 01.01.2021-31.12.2023, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.GJ, (përgjegjës grupi),
2. E.SH, anëtar
3. J.K, anëtar
4. M.M, anëtar
5. A.C, anëtar

a. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivat specifike të auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Instituti i

Statistikave me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu veprimtaria e institucionit, procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Qëllimi i auditimit: Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave.

b. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të institucionit të Instituti i Statistikave, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së INSTAT, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të INSTAT, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e

mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Institutit të Statistikave.

c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese

Drejtimi i institucionit të INSTAT është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Institutit të Statistikave dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe Kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Institutit të Statistikave është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

e. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”;
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e

ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” i ndryshuar;

- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimin MF nr. 5, datë 21.02.2022.

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”,

- Udhëzimi MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;

- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së;

-Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

f. Standardet e Auditimit

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

g) Metodat e auditimit

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 0,7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përlllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin e Insitutit të Statistikave, niveli i materialitetit për vitin 2023 rezultoi në vlerën 24,274 mijë lekë.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të

kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri në të moderuar.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të Audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të MB, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

h) Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022 dhe atij të përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe

evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i Përgjithshëm

Sistemi statistikor në shtetin shqiptar është themeluar me Vendimin nr. 35, dt. 13.01.1945 me krijimin e Drejtorisë së Statistikës të atashuar pranë Këshillit të Ministrave. Më vonë kjo drejtori kaloi nën varësinë e Komisionit të Planit të Shtetit.

Veprimtaria e Institucionit të INSTAT, rregullohet me Ligjin nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, ku përcaktohen objektivat, funksionet dhe detyrimet që ka si një Institucion Kushtetues i Republikës së Shqipërisë. Në zbatim të ligjit të sipërcituar, ky sistem përbëhet nga një numër institucioneve të ngarkuar për prodhimin e statistikave zyrtare dhe institucione të tjera, publike ose jo, të cilët nxjerrin statistika të fushave të ndryshme për monitorimin apo zbatimin e politikave të veta zhvilluese. Sistemi Kombëtar Statistikor e ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin e lartpërmendur dhe Programin shumëvjeçar të Statistikave i cili miratohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Shqipërisë. Përgjegjës për zbatimin e Programit dhe monitorimin e Sistemit Statistikor është Instituti i Statistikave (INSTAT) si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare.

Miratimi i Strukturës dhe të organikës së Institutit të Statistikave është miratuar me anë të Vendimit të Kuvendit Nr. 127, datë 29.12.2018, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave (INSTAT)”, ku është përcaktuar numri në total 236 punonjës.

Vlerësimi i aktivitetit të INSTAT, me qëllim dhënien e opinionit, është shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Subjekt auditimi direkt nga grupi i auditimit, është Aparati i INSTAT (për programet që ky i fundit administron). Për programet e tjera, i kemi referuar komunikimeve shkresore që lidhen me përgatitjet e PBA-ve, raportet e monitorimit si dhe është bërë një analizë më së shumti statistikore, mbi trendin e realizimit të tyre dhe krahasimet plan-fakt.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm 2022-2024 dhe PBA-në 2023-2025;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2021, vitin 2022 dhe 2023, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;
- 3) Raportet e monitorimit të 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit.
a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Instituti i Statistikave është institucioni përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare cilësore, asnjane, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

INSTAT e ushtron aktivitetin financiar në grupin 50 në programin buxhetor “01320 “Veprimtaria Statistike”.

Burimet e financimit të INSTAT-it janë:

- a) buxheti i shtetit;
- b) të ardhurat nga shërbimet statistikore ndaj të tretëve;
- c) burimet të tjera të ligjshme.

Nën administrimin e INSTAT përfshihen Zyrat Rajonale të Statistikave të nivelit vendor.

Programi Buxhetor Afatmesëm

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe udhëzimeve plotësuese vjetore përkatëse.

INSTAT ka hartuar dokumentin e PBA 2022-2024, PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026 për të dyja fazat (*strategjike dhe teknike*) në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, sipas formatit dhe brenda afateve të përcaktuara. Sa i takon Ekipit të Menaxhimit të Programit për PBA 2022-2024 u ngrit EMP për programin buxhetor “*Veprimtaria statistikore*”, bazuar në Urdhrin të DP nr. 23, datë 17.03.2021 “Për krijimin e Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor në Instat”. Nga auditimi i PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026 u konstatua se në institucionin e INSTAT nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018, paragrafi 2.5, pika 5, citohet se “...Drejtuesi i programit dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj. Përgatitja e fishave të projekteve të cilat financohen nga buxheti i shtetit për PBA-në bëhet nga secila drejtori përkatëse Në përgatitjen e PBA-së janë konsideruar kërkesat e paraqitura nga drejtoritë e institucionit dhe janë përpunuar nga Sektori i Financës.

▪ **Grupi i Menaxhimit Strategjik**

Me anë të Urdhrit të DP nr.21 datë 10.03.2021 “Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik në INSTAT”, u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe anëtarët janë caktuar sipas funksioneve si vijon: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive të Përgjithshme të Prodhimit Statistikor, DP i TI dhe Mbledhjes së të Dhënave si dhe DP i Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit. *Nga auditimi u konstatua se ky urdhër nuk është rishikuar për çdo vit për të përcaktuar personat përgjegjës.* Gjithashtu, sa i takon takimeve të GMS rezultoi se takimet e kryera janë të dokumentuara veprime në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 1.

Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

▪ **Viti 2021**

Në zbatim të Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr. 1821 prot., datë 28.12.2020 të Institutit të Statistikave, me shkresat nr.23724/70, datë

14.01.2021 dhe nr.23724/108, datë 18.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është miratuar detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale.

Në mijë lekë

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2021-2023	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2021	Buxheti i Rishikuar i vitit 2021	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
50	Veprimtaria Statistikore	2,062,761	925,600	564,690	1,498,071

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Për vitin 2021, janë planifikuar në PBA 2021-2023, shuma prej 2,062,761 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2021, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 564,690 mijë nga INSTAT, pra 1,498,071 mijë lekë më pak se plani në PBA, për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19 dhe mosrealizimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave.

▪ Viti 2022

Në zbatim të Ligjit nr.115, datë 16.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr.2097/1 prot., datë 05.01.2022 të INSTAT, me shkresat nr.22922/97, datë 18.01.2022 dhe nr.22922/100, datë 18.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është miratuar detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale.

Në mijë lekë

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2022-2024	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2022	Buxheti i Rishikuar i vitit 2022	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
50	Veprimtaria Statistikore	1,914,234	1,968,400	745,200	1,498,071

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Për vitin 2022, janë planifikuar në PBA 2022-2024, shuma prej 1,914,234 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2022, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 745,200 mijë lekë nga INSTAT, pra 1,169,034 mijë lekë më pak se plani në PBA, e cila ka ardhur si shkak i mosrealizimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave.

▪ Viti 2023

Në zbatim të Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr.3/1 prot., datë 05.01.2023 të INSTAT, me shkresat nr.22851/111, datë 20.01.2023 dhe nr. 601/1, datë 02.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është miratuar detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale.

Në mijë lekë

Kodi buxhetor	Programi Buxhetor	Kërkesa PBA 2023-2025	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2023	Buxheti i Rishikuar i vitit 2023	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
50	Veprimtaria Statistikore	2,061,295	1,531,000	1,851,051	210,244

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Për vitin 2023, janë planifikuar në PBA 2023-2025, shuma prej 2,061,295 mijë lekë dhe, deri në

fund të vitit 2023, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 1,851,051 mijë lekë nga INSTAT, pra 210,244 mijë lekë më pak se plani në PBA.

▪ **Rishpërndarja e fondëve**

Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga INSTAT janë kryer rishikimet si vijon: në vitin 2021 janë kryer 5 rishikime buxhetore, për vitin 2022 janë kryer 9 rishikime buxhetore dhe për vitin 2023, janë kryer 16 rishikime buxhetore, të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së INSTAT. Nga auditimi i rishikimeve të kërkuara nga ana e INSTAT për shtesa dhe pakësime fondesh u konstatua se nuk janë të shoqëruara me argumentet si: a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondëve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 71 ku citohet ... “Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat.” Dhe pika 75. “Numri i rishpërndarjeve të fondëve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.

▪ **Raportet e monitorimit**

Sa i takon raporteve të monitorimit, konstatohet se INSTAT ka hartuar raportet e monitorimit 4 mujore të konsoliduara, por nga ana institucioneve të varësisë (*Zyrat Rajonale Statistike*), si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raporte monitorimi 4 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se në relacionin shpjegues përmbledhës, analiza sipas zërave buxhetorë është kryer vetëm pas planit të rishikuar të buxhetit, e jo planit fillestar në PBA, duke sjellë mungesën e një analize të qartë në lidhje me ndryshimet dhe devijimet e planit të rishikuar në krahasim me planin fillestar. Nga ana tjetër, grupi i auditimit konstatoi se nuk janë analizuar dhe argumentuar në mënyrë shteruese shpenzimet operative, projektet dhe investimet të realizuara, si dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e punës në INSTAT. Gjithashtu, sa i takon kërkesave për ndryshime buxhetore të ndodhura gjatë vitit, nuk ka argumentim të plotë për të cilat janë realizuar këto ndryshime. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22 të MFE, datë 17.11.2016 dhe nr.14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, shtojca nr.3 dhe kapitulli 4, pika 49 dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit”, kapitulli VI, pika 271.

▪ **Të ardhurat jashtë limiti**

Nga auditimi i të ardhurave jashtë limitit, konstatohet se INSTAT gjeneron të ardhura nga shërbimet statistikore ndaj të tretëve si dhe të trashëguara nga donatorët.

a) Të ardhurat nga shërbimet statistikore ndaj të tretëve (kapitulli nr. 5)

INSTAT gjeneron të ardhura nga veprimtaria ekonomike nga shërbimet që realizon për anketa të ndryshme që kryen për të tretët për vrojtime të ndryshme statistikore. Bazuar në Udhëzimin e

përbashkët nr.1 datë 23.05.2007 midis Ministrisë së Financave dhe Institutit të Statistikave, ku përcaktohet se përdorimi i këtyre të ardhurave ku 10% e tyre do të derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe 90% nga Institucioni. Pjesa që i mbetet Institucioni, do të përdoret për pagesën e punonjësve me kontratë dhe shpenzimet për investime.

Viti 2021

Gjatë vitit 2021, të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet e kryera nga INSTAT, paraqiten si vijon:
‘në lekë

<i>Te ardhura Kapitulli 5 viti 2021</i>			
Te ardhura faktike	Artikulli	Plani vjetor Buxheti	Shpenzime 2021
45,046,600	600	32,264,000	30,167,954
	601	5,384,000	5,101,098
	602	2,000,000	11,300
45,046,600		39,648,000	35,280,352

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Në vitin 2021, INSTAT ka realizuar 45,046,600 lekë të ardhura nga anketat e kryera për Bankën e Shqipërisë, të cilat i realizon çdo vit në varësi të nevojave për anketa që ka BSH. Sipas planit të buxhetit, për llogaritë 600, 601 dhe 602 janë planifikuar 39,648,000 lekë, dhe janë realizuar në shumën 35,280,352 lekë.

Viti 2022

Gjatë vitit 2022, të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet e kryera nga INSTAT, paraqiten si vijon:
‘në lekë

<i>Te ardhura Kapitulli 5 viti 2022</i>			
Te ardhura kap 5	Artikulli	Plan vjetor Buxheti	Shpenzime 2022
43,496,600	600	27,457,400	27,398,806
	601	5,250,370	4,646,763
	602	800,000	52,780
43,496,600		33,507,770	32,098,349

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Në vitin 2022, INSTAT ka realizuar 43,496,600 lekë të ardhura nga anketat e kryera për Bankën e Shqipërisë, të cilat i realizon çdo vit në varësi të nevojave për anketa që ka BSH. Sipas planit të buxhetit, për llogaritë 600, 601 dhe 602 janë planifikuar 33,507,770 lekë, dhe janë realizuar në shumën 32,098,349 lekë.

Viti 2023

Gjatë vitit 2023, të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet e kryera nga INSTAT, paraqiten si vijon:
‘në lekë

<i>Te ardhura Kapitulli 5 viti 2023</i>			
Te ardhura kap 5	Artikulli	Plan vjetor Buxheti	Shpenzime 2023
48,486,700	600	32,264,000	32,264,000
	601	5,385,000	5,385,000
	602	2,000,000	55,000
48,486,700		39,649,000	37,704,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Në vitin 2023, INSTAT ka realizuar 48,486,700 lekë të ardhura nga anketat e kryera për Bankën e Shqipërisë, të cilat i realizon çdo vit në varësi të nevojave për anketa që ka BSH. Sipas planit të buxhetit, për llogaritë 600, 601 dhe 602 janë planifikuar 39,649,000 lekë, dhe janë realizuar në shumën 37,704,000 lekë.

b) Të ardhurat të trashëguara nga donatorët (kapitulli nr. 6)

Nga auditimi i të ardhurave të trashëguara nga donatorët ndër vite, konstatohet se INSTAT i gjeneron të ardhura, nga projekte të huaja cilat janë ekzekutuar ndër vite për të cilat nga ana e INSTAT nuk ka relacione/sqarime për realizimin dhe rakordimin financiar të tyre nga fillimi i projektit, transfertat dhe gjendjet.

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 sipas llogarive analitike të vëna në dispozicion, e cila paraqitet në Aneksin nr.1, tabela 2, konstatohet se mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin të ardhurave të trashëguara nga donacionet në buxhet, nga ana e INSTAT nuk ka një vendimmarrje nga organet përkatëse për detajimin dhe përdorimin e tyre, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.17/2018 “Për statistikën zyrtare”, Neni 18, pika 1 ku citohet... “Bordi drejtues është organ drejtues i INSTAT-it, i cili ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe të propozojë planet për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave të tij.”

INSTAT ka një aktrakordim me thesarin për shpenzimet e realizuar me burim financimi të ardhurat e kapitullit 6 për shumën totale të projekteve, e cila nuk paraqitet me evidencë të detajuar për secilin nga projektet e financuara. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se për të tre vitet objekt auditimi, në zërin e Donatorit “Gopa PPP” janë përfshirë disa projekte të ndryshme, për të cilat gjendja fillestare, hyrjet, daljet dhe gjendja në fund janë mbajtur në total, duke bërë të pamundur identifikimin e vlerave përkatëse për secilin projekt/marrëveshje/kontratë, si dhe mënyrën e përdorimit të buxhetit të tyre. Nga ana tjetër, konstatohet se INSTAT ka përdorur të ardhurat e trashëguara nga donacionet (fonde gjendje), për shpenzime udhëtimi dieta me jashtë duke mos u bazuar në përcaktimet e legjislacionit shqiptar, por duke i përdorur këto fonde për pagimin e dietave jashtë vendit, duke ndjekur praktiken e përdorimit të fondeve sipas legjislacionit të huaj (Komisionit Europian, United Nations, OKB etj). Disa nga projektet e përfshira në zërin GOPA PPP (IPA 2015 dhe IPA 2017) kanë përfunduar, por nga ana e INSTAT këto të ardhura vazhdojnë të mbarten nga viti në vit, dhe të përdoren për aktivitete të ndryshme të INSTAT të paplanifikuara për vitet buxhetore respektive.

▪ **Investimet**

a) Planifikimi në PBA dhe realizimi i buxhetit për shpenzimet kapitale

Viti 2021

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2021, grupi i auditimit krahasoi planifikimin e tyre në raport me realizimin. Më hollësisht, në tabelën e mëposhtme paraqiten ndryshimet mes fondit të planifikuar në PBA 2021-2023 dhe realizimit për projektet me financim të brendshëm.

Në mijë lekë

Nr	Kodi i Projektit	Përshkrimi	Parashikimi viti 2021 (PBA 2021-2023)	Realizimi Viti 2021	Diferenca midis PBA dhe Realizim
1	M500011	Infrastruktura e nevojshme software- të përditësuara	3,850,000	3,682,200	167,800
2	M500002	Pajisje te teknologjisë se informacionit te blera	188,900,000	4,554,000	184,346,000
3	M500005	TVSH	26,850,000	6,899,100	19,950,900
TOTALI			219,600,000	15,135,300	204,464,700

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përse i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2021 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2021-2023, nga ku u konstatua se për 3 projektet (të listuara në tabelën më sipër) në shumën **15,135 mijë** lekë, janë realizuar gjatë vitit 2021, por kanë qenë të planifikuara në PBA 2021-2023, me vlera më të larta në shumën 219,600 mijë lekë, me një diferencë prej 204,465 mijë lekë, duke sjellë mungesë analize në planifikimin e investimeve.

Viti 2022

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2022, grupi i auditimit krahasoi planifikimin e tyre në raport me realizimin. Më hollësisht, në tabelën e mëposhtme paraqiten ndryshimet mes fondit të planifikuar në PBA 2022-2024 dhe realizimit për projektet me financim të brendshëm.

Në mijë lekë

Nr	Kodi i Projektit	Përshkrimi	Parashikimi viti 2022 (PBA 2022-2024)	Realizimi Viti 2022	Diferenca midis PBA dhe Realizim
1	M500011	Blerje pajisje ,sisteme, makineri të ndryshme	3,870,000	3,381,700	488,300
2	M500002	Blerja pajisjeve teknologjisë se informacionit për të pajisur punonjësit me bazën e nevojshme për grumbullimin edhe përpunimin e të dhënave	2,100,000	0	2,100,000
3	M500005	TVSH	9,630,000	8,336,700	1,293,300
TOTALI			15,600,000	11,718,400	3,881,600

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përse i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024, nga ku u konstatua se për 3 projektet (të listuara në tabelën më sipër) në shumën **11,718 mijë** lekë, janë realizuar gjatë vitit 2022, por kanë qenë të planifikuara në PBA 2022-2024, me vlera më të larta në shumën 15,600 mijë lekë, me një diferencë prej 3,882 mijë lekë, duke sjellë mungesë analize në planifikimin e investimeve.

Viti 2023

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2023, grupi i auditimit krahasoi planifikimin e tyre në raport me realizimin. Më hollësisht, në tabelën e mëposhtme paraqiten ndryshimet mes fondit të planifikuar në PBA 2023-2025 dhe realizimit për projektet me financim të brendshëm.

Në mijë lekë

Nr	Kodi i Projektit	Përshkrimi	Parashikimi viti 2023 (PBA 2023-2025)	Realizimi Viti 2023	Diferenca midis PBA dhe Realizim
1	M500011	Infrastruktura e nevojshme softëare- te perditsuara	5,032,000	3,379,530	1,652,470
2	M500002	Pajisje te teknologjisë se informacionit te blera	2,268,000	270,732,000	(268,464,000)
3	M500005	TVSH	8,300,000	22,238,537	(13,938,537)
TOTALI			15,600,000	296,350,067	(280,750,067)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përse i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2023 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2023-2025, nga ku u konstatua se për 3 projektet (të listuara në tabelën më sipër) në shumën **296,350 mijë** lekë, janë realizuar gjatë vitit 2023, por kanë qenë të planifikuara në PBA 2023-2025, me vlera më të vogla në shumën 15,600 mijë lekë, me një diferencë prej 280,750 mijë lekë, duke sjellë mungesë analize në planifikimin e investimeve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7 dhe Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat

standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1, ku përcakton se “Të gjitha projektet e investimeve të reja duhet të përgatiten përmes formatit të propozimit të politikave të reja dhe të ndjekin procedurat e përgjithshme të shqyrtimit dhe miratimit të tyre.”

b) Investimet me financim të huaj

Nga auditimi i projekteve të investimit me financim të huaj, konstatohet se që nga planifikimi, në zbatim e deri në raportim, këto investime nuk paraqiten me kode buxhetore të veçanta, por paraqiten me vlerën totale që secili donator ka financuar për projekte specifike, duke bërë të pamundur identifikimin e investimeve të realizuara me financim të huaj.

Gjithashtu, sa i takon investimeve me bashkëfinancim, në të cilat nga buxheti i shtetit paguhet dhe likuidohet TVSH e projektit, konstatohet se nga ana e Sektorit të Financës në INSTAT, për të gjitha projektet, likuidimi i TVSH-së është bërë në një kod buxhetor, dhe jo i ndarë veçmas për secilin projekt. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Pika 8/f dhe Udhëzimi nr.36 datë 17.12.2019 “Për përgjegjësitë e përdoruesve në sistemin informatik të menaxhimit financiar për modulën e përgatitjes së buxhetit, modulën e menaxhimit të investimeve publike dhe modulën e monitorimit të buxhetit dhe portofolit të projekteve”, pika 2.2.

Buxheti i Cens-it të Popullsisë dhe Banesave

a) Të dhëna të përgjithshme mbi procesin e Cens-it si dhe objektivave të tij

Censi i Popullsisë dhe i Banesave është procesi i numërimit të plotë të të gjithë individëve, njësie ekonomike familjare dhe banesave. Ai ka një rëndësi të veçantë sociale dhe ekonomike. Censusi bën një fotografi të momentit mbi gjendjen sociale dhe nivelin e jetesës së popullsisë në një çast të përzgjedhur. Vetëm Censi mund të gjenerojë të dhëna kaq të plota dhe të detajuara. Rezultatet e tij janë vitale për vendim-marrjen politike, ekonomike e sociale.

Objektivi kryesor i Censit është të japë një kuadër të përditësuar të realitetit shoqëror dhe demografik të vendit, sa më afër standardeve raportuese europiane. T’i ofrojë qeverisë të dhëna statistikore të përshtatshme për qeverisjen kombëtare dhe monitorimin e reformave. Rezultatet e Censit shërbejnë si guidë orientuese në planet strategjike të zhvillimit dhe ofrojnë një panoramë aktuale dhe të saktë të realitetit demografik, ekonomik dhe social në vend, të cilat janë jetësore për politikën dhe marrjen e masave efektive. Informacioni që merret nga statistikat e Censit nuk mundësohet nga asnjë burim tjetër. Një nga qëllimet e Censit është edhe bërja e prognozave të sakta për popullsinë sipas grup-moshave me synim zhvillimin e ardhshëm të shoqërisë. Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2023 është Censi i 12-të i kryer në historinë e Shqipërisë. Censusi i Popullsisë dhe Banesave është kryer për herë të parë në Shqipëri në vitin 1923. Ky proces kryhet një herë në 10 vjet për të matur statistakisht realitetin demografik, ekonomik dhe social në vend. Regjistrimi i fundit i Përgjithshëm i Popullsisë dhe Banesave është kryer në vitin 2011. Frekuenca e regjistrimit të popullsisë një herë në 10 vjet është një standard european për të lejuar krahasueshmërinë e të dhënave të të gjitha shteteve europiane dhe Censusi kryhet pothuajse në një njëjtën periudhë për të gjitha vendet e Europës. Censusi mbulon të gjitha zonat urbane dhe rurale të territorit të RSH. Ai përfshin popullsinë banuese, si dhe të gjitha objektet brenda territorit të Republikës, që përdoren për banim, pavarësisht nëse ato janë pronë e luajtshme ose e paluajtshme. INSTAT ka kryer Censusin e fundit të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2023, ku janë regjistruar:

- Njësitë ekonomike familjare;
- Individët;
- Bashkëjetesat kolektive;
- Banesat rezidenciale (të banuara ose jo) dhe tipe të tjera banesash;


- Të huajt (prezentë në momentin e Censurit).

b) Buxhetimi i Projektit të Cens-it, nga fillimi i implementimit të tij deri në 31.12.2023, bashkë me burimet e financimit

Kryerja e Censit të Popullsisë dhe Banesave mbështetet nga buxheti i shtetit dhe donatorë të ndryshëm.

Kostoja gjithsej e këtij procesi është vlerësuar të jetë 16.9 milion Euro. Kjo përfaqëson mesatarisht 5.7 Euro për banorë, e cila korrespondon me mesataren e vendeve evropiane që kryejnë një Cens tradicional. Mbi 50% e kostove janë për stafin e angazhuar në terren, ndërkohë komponentë të tjerë të buxhetit janë investime afatgjata për një sistem të qëndrueshëm statistikor.

Paraqitja grafike e buxhetit të Cens-it



Aktivitetet e Censit ndahen në tre faza kryesore:

- 1.Faza përgatitore ose para-numërimit;
- 2.Faza e numërimit;
- 3.Faza e pas-numërimit.

Sipas Plani Vjetor 2023 “Për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”, të miratuar nga INSTAT, është parashikuar se numërimi i Popullsisë dhe Banesave do të fillojë me datë **18 Shtator 2023 dhe do të vazhdojë për një periudhë 6 (gjashtë) javore**, si dhe pas numërimit në terren, INSTAT do të organizojë anketën “Pas Censit”, për të llogaritur nivelin e besueshmërisë dhe cilësinë e të dhënave të mbledhura, duke përdorur modele statistikore të rekomanduara nga organizatat ndërkombëtare.

Tabela – Mbi të dhënat e Afateve të Cens-it, sipas Planeve Vjetore të INSTAT

Përshkrimi	Periodiciteti I Aktivitetit	Burimet Financiare	Afati I Grumbullimit te te dhenave sipas Planit	Afati I Perpuni mit te te dhenave sipas Planit	Afati I Publikimi mit te te dhenave sipas Planit	Fillimi I Censit sipas Aneks 2	Afati I Grumbullimi te te dhenave	Afati I Perpuni mit te te dhenave	Afati I Publikimi mit te te dhenave
Plani Vjetor 2022 (Cens)	10 vite	Kombinuar (Buxhet + Donatore)	V + 46 D	V + 81 D	V + 273 D	01.10.22	17.11.22	22.12.22	03.07.23
Plani Vjetor 2023 (Cens)	10 vite	Kombinuar (Buxhet + Donatore)	V + 46 D	V + 81 D	V + 272 D	18.09.23	04.11.23	10.12.23	20.06.24
Plani Vjetor 2024 (Cens)	10 vite	Kombinuar (Buxhet + Donatore)		D + 256 D	V + 286 D			16.05.24	16.06.24

Burimi: Të dhënat sipas Planeve Vjetore të INSTAT, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga ana e Grupit të Auditimit pas verifikimit të Planeve Vjetore të hartuara dhe miratuara nga INSTAT, në lidhje me projektin Cens-it, si dhe në zbatim të Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, konstatoi se sipas Planit Vjetor 2022 të miratuar ka qenë e parashikuar kryerja e Projektit të Cens-it i cili së bashku me Anekset e këtij Plani Vjetor do të fillonte në datën 01.10.2022 faza e grumbullimit të të dhënave dhe më pas të procedohej me fazat e tjera të përpunimit të të dhënave dhe publikimit të tyre, por gjatë vitit 2022 nga ana e INSTAT nuk ka filluar Projekt i Cens-it duke mos iu përmbajtur vetë Planit Vjetor të miratuar prej tyre dhe afateve respektive. Me buxhetit e vitit 2022, nga ana e INSTAT është parashikuar “Blerje pajisje Tableta dhe Power Banks për CENS” me fond limit total 233,583,847.36 (dy qind e tridhjetë e tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzet e shtatë /pikë tridhjetë e gjatë) lekë, pa TVSH, me burim financimi buxhetin e shtetit planifikuar në datën 19.04.2022, me kohëzgjatje kontrate është planifikuar 60 ditë nga nënshkrimi i saj. Me shtojcën përkatëse janë modifikuar disa kriterë kualifikuese, që ka ndikuar në zgjatjen e afatit për zhvillimin e procedurës. Nga ana e KPP-së, procedura e ndjekur nga INSTAT është konstatuar me mangësi në vendimin nr. 703/2022 datë 22.07.2022, ku ndër të tjera citohet: “... ka mospërputhje midis kërkesave të parashikuara nga AK në specifikimet teknike dhe specifikimeve teknike kombëtare të miratuara nga AKSHI, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në hartimin e ofertës ekonomike të OE, si dhe vlerësimin e ofertave nga KVO, duke qenë në mospërputhje me LPP-në duke përbërë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë OE”. Sa më sipër, KPP ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit për blerjen e tabletave duke shkaktuar pamundësinë e vijimit të Cens-it dhe shtyrjen e realizimit të tij. Sa më sipër, nga ana e grupit të auditimit konstatohet se nga ana e INSTAT kemi një planifikim të dobët përsa i përket projektit Cens. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 4.

Në lidhje me Planin Vjetor 2023, nga ana e INSTAT është parashikuar se do të procedohej me Projektin e Cens-it, duke filluar nga muaji Shtator 2023 me grumbullimin e të dhënave për një periudhë 6 javore, dhe më pas me përpunimin e tyre dhe publikimin. Faza e përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të Planit Vjetor 2023 dhe Aneks nr.2 në zbatim të këtij Plani mbi afatet e Cens-it, parashikohet se do të jetë (V+81D), pra afati fillon nga dita e fillimit të grumbullimit të të dhënave 18.09.2023 plus 81 ditë, që përkon me datën 10.12.2023, si afat përfundimtar, si dhe për publikimin e rezultateve të Cens-it afati fillon nga dita e fillimit të grumbullimit të të dhënave 18.09.2023 plus 272 ditë, që përkon me datën 20.06.2024

Gjatë vitit 2023 është kryer faza përgatitore dhe faza e numërimit, dhe në vitin 2024 do të realizohet faza e pas numërimit. Deri në datën 31.12.2023, buxheti i përdorur sipas donatorëve, paraqitet si më poshtë:

Në euro

Financuesit/Donatorët	Buxhet	Realizimi 31.12.2023	Diferenca	% realizimit
Buxheti i shtetit	9,362,876	7,415,937	1,946,939	79.2%
BE	4,800,000	3,671,318	1,128,682	76.5%
Sida	1,583,798	1,388,758	195,040	87.7%
Salstat	720,386	256,583	463,803	35.6%
UNFPA	167,649	164,300	3,349	98.0%
Donatore të tjerë	276,323	110,806	165,517	40.1%
Total	16,911,032	13,007,702	3,903,330	76.9%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër, deri në 31.12.2023, për fazën përgatitore dhe fazën e numërimit, është realizuar rreth 76.9% e buxhetit të planifikuar.

Në raport me realizimin faktik deri 31.12.2023, peshën më të madhe specifike e ze buxheti i shtetit prej 57%.

Sipas zërave, buxheti i realizuar deri më 31.12.2023 nga secili donator, paraqitet si vijon:

Në euro

<i>Financuesi</i>		<i>Buxheti i shtetit</i>	<i>BE</i>	<i>SIDA</i>	<i>Salstat</i>	<i>UNFPA</i>	<i>Të ndryshme</i>
<i>Zërat</i>							
1	Burimet njerëzore	4,475,716	1,566,156	1,056,220	-	-	-
2	Kostot e udhëtimit	-	-	-	-	-	-
3	Pajisje zyre dhe mjete elektronike	2,488,147	522,594	17,000	129,000	164,300	110,806
4	Qiratë e zyrave	56,877	-	-	-	-	-
5	Kosto të tjera për shërbime(konferenca, kërkim, publikime)	-	1,362,578	79,144	54,796	-	-
6	Te tjera	395,196	219,990	231,506	72,786	-	-
Totali		7,415,937	3,671,318	1,383,870	256,583	164,300	110,806

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të INSTAT

- Për zërin “*Burimet njerëzore*” në shumën 4,475,716 Euro janë përfshirë pagat për punonjësit teknik si mbikëqyrës, anketues, shoferë etj. për zhvillimin e Censurit;

- Për zërin “*Pajisje zyre dhe mjete elektronike*” në shumën 2,488,147 Euro janë përfshirë automjetet e marra me qira për realizimin e projektit të Censurit nëpër qarqe dhe bashki, si dhe blerja e pajisjeve kompjuterike (tabletat).

- Për zërin “*Qiratë e zyrave*” në shumën 56,877 Euro janë përfshirë të gjitha kostot e ambienteve të marra me qira nëpër bashki dhe qarqe;

- Për zërin “*Te tjera*” në shumën 395,196 Euro janë përfshirë kostot për karburantin e përdorur për realizimin e Censurit në shumën 61,060 Euro dhe kostot e trajnimit për aktivitetet e stafit në terren në shumën 334,136 Euro. Të analizuara sipas shpenzimeve specifike, paraqiten në Aneksin I, tabela 1.

▪ **Raportimet dhe likuidimet e projektit Cens**

Nga auditimi u konstatua se për llogari të projektit të Pilot Cens, në vitin 2021 janë kryer likuidimet si vijon, duke u bazuar në Marrëveshjen Bilaterale nr. 1407 prot., datë 10.07.2019, midis INSTAT dhe UNFPA, të cilat nuk janë raportuar në buxhetin e projektit Cens, sipas zërave si vijon: Shpenzime për qira ambjentesh në vlerën 610,000 lekë (likuiduar me Urdhërshpenzimet nr.955 datë 12.10.2021, nr.956 datë 12.10.2021, nr.957 datë 12.10.2021, nr.958 datë 12.10.2021, nr.959 datë 25.10.2021, nr.999 datë 25.10.2021, nr.1089 datë 17.11.2021, nr.1098 datë 23.11.2021, nr.1108 datë 18.11.2021), Blerje karburant në vlerën 315,000 lekë, likuiduar me USH nr.979 datë 25.10.2021 dhe Shpenzime për automjete me qira në shumën 724,227 lekë (likuiduar me Urdhërshpenzimet nr.1090 datë 17.11.2021 dhe nr.1224 datë 07.12.2021). Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, pika 7 dhe pika 138.

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.654/19 prot., datë 02.09.2024, protokolluar në KLSH me nr. 505/5, datë 03.09.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:-Sa i takon mosfunksionimit të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve për procedurat e planifikimit të buxhetit, ju bëjmë me dije se Titullari i institucionit do të marrë masa për ngritjen e EMP-së;

-Sa i takon rishpërndarjes së fondeve, sqarojmë se shtesat dhe pakësimet e fondeve janë bërë sipas kërkesave të institucionit, ku janë shoqëruar me argumentet përkatëse ku për vitin 2021 kanë ardhur si shkak i pandemisë covid-19, për vitin 2022 pakësimi ka ardhur si shkak i anulimit të tenderit nga KPP “Blerje tableta” dhe për vitin 2023 në zbatim të VKM-ve përkatëse për rritjen e pagave. Në vijimësi INSTAT do të marrë masat që kërkesat për ndryshime të bëhen sa më të detajuara;

-Sa i takon raporteve të monitorimit, Instat ka hartuar raportet 4 mujore dhe për njësitë vartëse, duke përfshirë të dhënat e tyre, dhe sa i takon relacioneve shoqëruese në vijimësi do të jetë më i detajuar në lidhje me informacionin që përmban;

-Sa i takon të ardhurave të trashëguara në kapitullin nr.6, për periudhën e audituar janë kryesisht nga donatori GOPA me disa kontrata për projekte, UNFPA, UNDP, Salstat etj, ku në asnjë kontratë nuk citohet detyrimi i INSTAT për raportim financiar apo kthim të fondeve të papërdorura. Fondet e përdorura në aktivitetet e cituara në aktkonstatim ju kanë shërbyer linjave të objektivave apo rezultateve të projekteve GOPA, i cili bëhet pas miratimit të akt rakordimit dhe kërkesës për rritje të autorizuar nga institucioni. Sektori i Financës ka mbajtur në mënyrë analitike të ardhurat dhe shpenzimet për çdo projekt, dhe në vijimësi do të marrë masa për të mbajtur në mënyrë analitike sipas planit të aktiviteteve të ardhurat dhe shpenzimet nga kontrata. Sa i takon planifikimit të të ardhurave limiti, Instat nuk mund të planifikojë fonde të ardhura jashtë limiti. Në lidhje me rritjet e autorizuar për kapitullin nr.6, bashkëlidhur gjeni rritjet e autorizuar për vitet 2021, 2022 dhe 2023;

-Sa i takon raportimit mbi projektin Cens, për shpenzimet e UNFPA sqarojmë se nuk kanë qenë pjesë e buxhetit total për projektin Cens, për rrjedhojë nuk janë përfshirë

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:- Në lidhje me komentin tuaj mbi të ardhurave të trashëguara në kapitullin nr.6, sqarojmë se INSTAT nuk ka relacione/sqarime për realizimin dhe rakordimin financiar të tyre nga fillimi i projektit, transfertat dhe gjendjet. Në zërin e Donatorit “GOPA PPP” janë përfshirë disa projekte të ndryshme, për të cilat gjendja fillestare, hyrjet, daljet dhe gjendja në fund janë mbajtur në total, duke bërë të pamundur identifikimin e vlerave përkatëse për secilin projekt/marrëveshje/kontratë, si dhe mënyrën e përdorimit të buxhetit të tyre, dhe me emailt e dërguara nga ana juaj, nuk është e detajuar gjendja fillestare, hyrjet, daljet dhe gjendja në fund për secilin nga projektet në vijimësi; - Në lidhje me planifikimin e të ardhurave jashtë limitit, sqarojmë se në zbatim të Udhëzimit nr.35, datë 21.02.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, pika 6.5 specifikon se ndihmat në natyrë ose në para që Institucionet publike marrin nga jashtë detyrimisht do të regjistrohen dhe kanalizohen nëpërmjet llogarive të të ardhurave të buxhetit të shtetit nëpërmjet degëve të thesarit, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.10, datë 12.07.2024, “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, pika 3.4 citohet se: “Projektet me financim të huaj grante i nënshtrohen skemës me thesar të plotë, nëse nuk është parashikuar ndryshe në marrëveshjen e nënshkruar. Në rast se është parashikuar ndryshe skema e përdorur do të jetë e njëjtë me skemën me thesar të pjesshëm që i nënshtrohen kreditë” si dhe pika 4 ku specifikon “Procedurat që ndiqen nga NJZP-ja për projektet me financim të huaj sipas skemës me thesar të plotë” ku është e përshkruar në mënyrë të detajuar e gjithë procedura që duhet të ndiqet, për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë. - Në lidhje me komentin tuaj mbi shpenzimet e UNFPA ku shpenzimet janë kryer në kuadër të projektit Cens,

sqarojmë se këto shpenzime duhet të jenë pjesë e raportimit të buxhetit total për projektin Cens. Për rrjedhojë, observacioni nuk merret në konsideratë. Sa i takon rritjeve të autorizuara për kapitullin nr.6, bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur, observacioni merret në konsideratë dhe është trajtuar në material.

2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Institutin e Statistikave rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, i ndryshuar.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”* dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2021 janë në vlerën totale 471,958 mijë lekë;

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2022 janë në vlerën 488,145 mijë lekë;

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2023 janë në vlerën totale 1,450,777 mijë lekë.

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhër shpenzimeve të realizuara në bazë të vlerave më të larta. Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

Nga auditimi u konstatua:

- Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit përgjithësisht është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.

- Gjatë auditimit të transaksioneve me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë u përdorën teknikat e auditimit si: kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

2.2.1 Auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve për vitet 2021, 2022 dhe 2023, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat*

standarde të zbatimit të buxhetit", pika 184 "Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik", si dhe Ligji nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7.

Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e INSTAT, me datën e faturës tatimore, nga ana e grupit të auditimit u konstatua se për vitet 2022 dhe 2023 janë kryer likuidime në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor. Konkretisht, nga kryerja e testeve mbi urdhër shpenzimet, u konstatuan se 46 urdhër shpenzime të vitit 2022 dhe 96 urdhër shpenzime të vitit 2023, të cilat janë likuiduar mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 52 ku citohet: "...specifikohet se Nëpunësi zbatues i njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, si dhe Ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7.

2.2.2 Urdhër shpenzimet mbi qiranë e ambienteve

Nga auditimi mbi likuidimin e urdhërshpenzimeve për Censusin konstatohet se:

Gjatë vitit 2023, INSTAT ka likuiduar 7,267,550 lekë për shpenzimet e qirasë, nga të cilat 300,232 lekë janë likuiduar në muajin Janar, por për llogari të buxhetit të vitit 2023 sipas përcaktimeve të udhëzimit të MF nr.31 datë 13.12.2023 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023". Nga ky total likuidimesh të muajit Janar, rezulton pagesa për llogari të muajve tetor-nëntor, jashtë afatit 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore, si dhe parashikimit në nenin 4 të kontratës ku citohet "Pagesa do të behet brenda datës 5 të çdo muaji pasardhës".

Gjithashtu, nga verifikimi i të dhënave të raportuara në Ministrinë e Financave me likuidimet konkrete të kryera, rezulton se INSTAT ka raportuar për shpenzimet e qirasë në Ministrinë e Financave në masën 56,877 Euro(6,967,318 lekë), ndërsa në fakt janë realizuar 7,267,550 lekë, duke krijuar pasiguri për raportimet e kryera.

-Gjithashtu, nga auditimi i urdhër shpenzimeve të likuidimeve mbi qiratë, konstatohet se në rastet kur INSTAT ka lidhur kontratë qiraje me Person Fizik, likuidimi i këtyre kreditorëve është kryer duke prekur llogarinë 421 "Detyrime ndaj personelit", dhe jo llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm". Kjo ka ardhur si shkak i mbajtjes së tatimit në burim, dhe për këtë qëllim, shlyerja e këtyre detyrimeve është kryer duke përdorur listëpagesat e duke i trajtuar dhe qiratë si kontratë shërbimi, e jo si Kontratë Qiraje. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.

2.2.3. Urdhër shpenzimet mbi vendimet gjyqësore

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se për një punonjës, është marrë Vendim i Formës së Prerë nga Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 563 datë 21.02.2019 ku citohet "... lënien në fuqi të Vendimit 41/89(80-2016-4215) datë 19.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku në dispozitivin e të këtij të fundit ndër të tjera citohet ... pala e paditur ka detyrim pagesën e paditësit me pagën nga data 23.05.2016 deri në kthimin në Punë", pra Gjykata ka vendosur kthimin në vendin e punës dhe përfitimin e pagës deri në momentin e kthimit në punë.

Nga auditimi u konstatua se nga momenti i lindjes së detyrimit e deri në momentin e rikthimit të punonjësit në Pozicionin përkatës, ky shpenzim është njohur dhe paguar në llogarinë nr. 6027

“Shpenzime për detyrime për kompensime legale”, dhe jo në llogarinë 600 “Shpenzime për pagën” dhe 601 “Shpenzime për sigurime” dhe punonjësit i është paguar paga bruto, duke u tatuar vetëm në normën 15% (si tatim në burim). Grupi i auditimit konstatoi se në pagën bruto nuk janë mbajtur ndalesat që lindin nga përfitimet e pagës për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Për rrjedhojë, nga ana tjetër shpenzimet për pagesën e këtij punonjësi, nuk janë njohur në listëpagesat mujore të INSTAT, si dhe nuk janë mbajtur ndalesat përkatëse, deri në momentin e rikthimit në pozicionin e punës. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”, i ndryshuar, VKM nr. 187, datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

2.2.4. Urdhër shpenzimet mbi likuidimin e TVSH-së për projektet me financim të huaj

Projektet me financim të huaj, të cilat menaxhohen nga INSTAT-i paraqiten si më poshtë:

1. SALSTAT - Statistika të Forta Vendore;
2. Mbështetje për CENS;
3. IPA 2019 Multi-Beneficiary Statistical Cooperation Programme;
4. Sida Direct Funding - Instat Census 2022.

Sa më sipër, nga auditimi i urdhërshpenzimeve mbi likuidimin e TVSH-së për projektet me bashkëfinansim me donatorët e huaj, konstatohet se bashkëlidhur urdhër shpenzimeve janë shkresa për pagesën e TVSH-së dhe fatura tatimore nga OE për pjesën e TVSH-së. Nga ana e Sektorit të Financës, nuk paraqitet i plotë dokumentacioni justifikues pasi nuk ka bashkëlidhur Kontratën e lidhur me OE, Grant Kontratën apo marrëveshjen me donatorin, procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”, pika 35 sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.

Nga ana tjetër, kontratat e vëna në dispozicion nga ana e Sektorit të Projekteve, konstatohet se marrëveshjet dhe kontratat e lidhura me donatorët përkatës si SIDA, Salstat, IPA 2019, i gjithë dokumentacioni është përpiluar në gjuhën angleze, por nuk rezulton të jetë nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKM Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”, Neni 4, pika 9 ku citohet ... “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”.

2.2.5 Të ardhurat e trashëguara nga donacionet(kapitulli 6)

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve të likuiduara nga kapitulli 6 “Të ardhura të trashëguara nga donatorët” u konstatua se për periudhën 2021-2023 janë likuiduar nëpërmjet bankës shpenzimet si vijon:

- Gjatë vitit 2021 janë likuiduar 89,740,587 lekë nëpërmjet thesarit nëpërmjet fondeve të kapitullit 6, të cilat janë shlyer sipas të ardhurave të trashëguara nga donatori “PPP Gopa” në vlerën 83,995,438 lekë (ku shuma prej 71,353,852 lekë është vlera e kthimit të fondeve për projektin IPA 2019), UNFPA në vlerën 5,061,402 lekë dhe EHIS në vlerën 683,747 lekë;
- Gjatë vitit 2022 janë likuiduar 9,111,763 lekë nëpërmjet thesarit nëpërmjet fondeve të kapitullit

6, të cilat janë paguar me fondet e përfshira tek donatori “PPP Gopa”;

-Gjatë vitit 2023 janë likuiduar 5,819,167 lekë nëpërmjet thesarit nëpërmjet fondeve të kapitullit 6 të cilat janë paguar me fondet e përfshira tek donatori “PPP Gopa” në vlerën 3,996,521 lekë dhe donatori Salstat 1,822,646 lekë.

Sa më sipër, grupit të auditimit i është vënë në dispozicion llogaria analitike e të ardhurave të trashëguara nga donacionet e cila është e mbartur ndër vite e parakorduar me evidencë të detajuar për projektet me thesarin,

Sa më sipër, nga informacioni dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi donatorin PPP(GOPA), dhe kryqëzimi i të dhënave me urdhër shpenzimet e likuiduara nëpërmjet bankës, u konstatua se:

Një pjesë e likuidimeve janë realizuar duke i përjashtuar nga përcaktimet e legjislacionit shqiptar sipas referimeve në marrëveshje. Totali i gjendjes monetare nga projektet konstatohet se është trashëguar ndër vite dhe zbatimi financiar nuk i raportohet donatorëve përkatës. Akt marrëveshjet dhe kontratat e vëna në dispozicion për vitin 2021, 2022 dhe 2023 paraqiten në gjuhën angleze, të pa përkthyer në gjuhën shqipe, dokumentacioni është përpiluar në gjuhën angleze, por nuk rezulton të jetë nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKM Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “rregullores së njëzuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”, Neni 4, pika 9 ku citohet ... “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj.”

a) Nga auditimi dokumentacionin mbi urdhërshpenzimet të likuiduara nëpërmjet bankës me kapitullin nr.6 “Të ardhura të trashëguara nga donatorët”, konstatohen mangësi në dokumentacionin bashkëlidhur si kontrata/marrëveshja përkatëse mbi të cilën janë shlyer urdhërshërbimet, dokumentacioni justifikues për kryerjen e udhëtimit si boarding pass, urdhërshërbimet për dieta jashtë vendit, autorizime pa nr.protokolli/datë, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur i fotokopjuar, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimi”, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

– Me urdhërshpenzimin nr. 568 datë 12.07.2021 me objekt “Paguar staf (pastrim dhe imputimi i database të anketës EHIS)” me vlerë 124,644 lekë është likuiduar pagesa për 2(dy) punonjës të INSTAT me nga 120 ore shtese për të cilët është mbajtur vetëm tatim në burim bazuar ne urdhrin e DP me nr. 1094 datë 01.07.2021. Nga Sektori i Financës, për pagesën është mbajtur tatim në burim në vlerën 15% dhe nuk është trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e punonjësve. Sa më sipër veprime në kundërshtim me neni 8 dhe neni 9 pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998,

“Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe shfuqizuar me ligjin me nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” neni 12, i cili shtrin efektet nga data 1 janar 2024 dhe Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar paragrafi 2.3, pika 2.3.1, i shfuqizuar me Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” paragrafi 12, i cili ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2024.

b) Nga auditimi me zgjedhje i urdhërshpenzimeve të likuiduara nëpërmjet kapitulli 6 “Të ardhura të trashëguara nga donatorët”, u konstatua se nga ana e INSTAT janë përdorur të ardhurat nga donacionet për projektet, për shpenzime udhëtimi dieta jashtë vendit dhe bileta avioni, të cilat janë likuiduar duke mos u bazuar në marrëveshjet përkatëse, të cilat paraqiten si më poshtë:

1- Me urdhërshpenzimin nr. 101 datë 21.02.2023 me objekt “Shpenzime udhëtimi jashtë vendit” janë likuiduar në vlerën 995,684 lekë shpenzime udhëtimi dieta jashtë vendit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), bazuar në urdhrin e SP me nr. 221/1 datë 08.02.23 ku citohet: “...të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe për dieta do të mbulohen nga INSTAT ndërkohë që UNDP merr përsipër mbulimin e udhëtimit dhe dietave për 5 dite. Për ditët e pambuluara shpenzimet do të mbulohen nga INSTAT”. Sa më sipër, në këtë urdhër citohet se pagesa e dietave do të bëhet bazuar në rregullat e Kombeve të Bashkuara, por nuk ka të specifikuar kontratën/marrëveshjen përkatëse mbi të cilën bazohet ky likuidim. Dietat e sipërcituara, janë paguar nga të ardhurat e trashëguara nga donatorët në kapitullin 6, në zërin “Gopa PPP”.

2 - Me urdhërshpenzimin nr. 275 datë 05.04.2023 me objekt “Paguar Biletë avioni - Kili” është likuiduar biletë avioni sipas faturës nr. 5/2023 në vlerën 466,000 lekë, bazuar në kërkesën pa nr. prot të datës 13.01.2023, e Specialistit z. B.K, e paaprovuar nga Përgjegjësi i Sektorit, dhe e miratuar nga SP (personi udhëtues). Me anë të Urdhrit të prokurimit me nr. 79 prot., datë 17.01.2023 të miratuar nga DP, citohet se financiarisht kjo procedurë do të mbështetet në fondin e INSTAT “Për zbatimin e programit të bashkëpunimit statistikor IPA 2017” (i cili nuk gjendet bashkëlidhur) si dhe procedura është zhvilluar si “Blerje e drejtpërdrejtë” bazuar në rregullat PRAG, në zërin “Gopa PPP”.

3 - Me urdhërshpenzimin nr. 423 datë 29.05.2023 me objekt “Shpenzime udhëtimi jashtë vendit” janë likuiduar me kapitullin nr.6 shpenzime dieta në vlerën 147,691 lekë, referuar urdhrin të SP me nr. 681/4 prot., datë 20.04.2023 “Për pagesën e udhëtimeve jashtë vendit” për marrjen pjesë në një takim të Forumit të të dhënave të Kombeve të Bashkuara që do të zhvillohet në Hangzhou, Kinë. Në urdhër ndër të tjera citohet: “...Për shpenzimet e dietës dhe siguracionit të shëndetit për personin udhëtues do të mbulohen nëpërmjet fondeve të projektit 7.2 Indikatorët e OZHQ sipas kontratës të nënshkruar midis INSTAT dhe GOPA, në shumën 217 euro/ dita”.

4 - Me urdhërshpenzimin nr. 361 datë 12.05.2022 me objekt “Shpenzime udhëtimi jashtë vendit” me vlerë 274,365 lekë, referuar në urdhrin e DP me nr. 774/1 prot., datë 11.05.2023 “Për pagesën e udhëtimeve jashtë vendit” për marrjen pjesë në një konferencë në Universitetin Shtetëror të Utah, Logan që zhvillohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Në urdhër ndër të tjera citohet: “Shpenzimet e udhëtimit, biletës, akomodimit dietës siguracionit të shëndetit dhe pagesës se konferencës do të mbulohen nga fondet e donatorit GOPA IPA MBP 2017, sipas rregullave të kombeve të bashkuara”. Bashkëlidhur gjendet urdhër shërbimi për dieta jashtë vendit me përlllogaritjet përkatëse.

5 - Me urdhërshpenzimin nr. 278 datë 15.04.2022 me objekt “Paguar Bilete avioni - Gjenevë” është likuiduar bilete avioni sipas faturës nr. 39/2022 në vlerën 101,620 lekë, bazuar në kërkesën pa nr. prot të datës 30.03.2022 e Specialistit z. B.K, e aprovuar nga Përgjegjësi i Sektorit znj.

V.S(personi udhëtues) , dhe e miratuar nga DP. Me anë të Urdhrit të prokurimit me nr. 548 prot., datë 01.04.2022 të miratuar nga DP, citohet se financiarisht kjo procedurë do të mbështetet në fondin e INSTAT “Për zbatimin e programit të bashkëpunimit statistikor GOPA IPA MBP 2015 – Projekti 7.2 SDG ” (i cili nuk gjendet bashkëlidhur) si dhe procedura është zhvilluar si “Blerje e drejtpërdrejtë” bazuar në rregullat PRAG. Nga ana tjetër, dokumentacioni në urdhërshpenzim, është fotokopjuar.

6 - Me urdhërshpenzimin nr. 514 datë 28.06.2022 me objekt “*Paguar Bilete avioni – UTAH USA*” me vlerë 228,000 lekë është likuiduar biletë avioni sipas faturës nr. 1/2022 në vlerën 228,000 lekë, bazuar në kërkesën pa nr. prot të datës 05.05.2022 e Specialistit z. B.K, e aprovuar nga Përgjegjësi i Sektorit znj. V.S , dhe e miratuar nga DP. Me anë të Urdhrit të prokurimit me nr. 792 prot., datë 12.05.2022 të miratuar nga DP, citohet se financiarisht kjo procedurë do të mbështetet në fondin e INSTAT “Për zbatimin e programit të bashkëpunimit statistikor GOPA IPA MBP 2017” (i cili nuk gjendet bashkëlidhur) si dhe procedura është zhvilluar si “Blerje e drejtpërdrejtë” bazuar në rregullat PRAG.

Nga auditimi dokumentacionin mbi urdhërshpenzimet e likuiduara nëpërmjet bankës me kapitullin nr.6 “*Të ardhura të trashëguara nga donatorët*”, konstatohet mangësi në dokumentacionin bashkëlidhur si kontrata/marrëveshja përkatëse mbi të cilën janë shlyer urdhërshërbimet, dokumentacioni justifikues për kryerjen e udhëtimit si boarding pass veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “*Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative*”, nenin 2, pika 16 “*Gjurma e auditimi*”, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “*Dokumente vërtetues*”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” dhe VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*” lidhja 1.

Gjithashtu, nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se 6 (gjashtë) urdhërshpenzimet e mësipërme në shumën prej 2,213,360 lekë për dieta jashtë vendit dhe bileta avioni janë likuiduar në mospërputhje me marrëveshjet/kontratave përkatëse me donatorët IPA 2015, IPA 2017, si dhe legjislacionin shqiptar, specifiku VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*”, lidhja 1. Nga auditimi i kontratave specifike të lidhura me donatorët IPA 2015 dhe IPA 2017, konstatohet se për pagesën e dietave/biletave të avionit ku përfaqësues të INSTAT kanë qenë pjesëmarrës nëpër konferenca/forume të ndryshme, të cilat nuk janë kryer në përputhje me objektin e marrëveshjes së lidhur, por janë përdorur sipas vendimmarrjes të INSTAT-it, duke mos u bazuar në legjislacionin shqiptar. Për rrjedhojë, vlera e paguar në shumën prej 2,213,360 lekë , **konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shtetit.**

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.654/19 prot., datë 02.09.2024, protokolluar në KLSH me nr. 505/5, datë 03.09.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:-Sa i takon likuidimit mbi afatin 30 ditor, Sektori i Financës do të marrë masat për likuidimin e pagesave brenda afatit ligjor;

- Sa i takon sistemimeve të nevojshme për klasifikimin e tatimit në burim në llogarinë e kreditorëve, dhe jo si llogari të detyrimeve ndaj personelit, Sektori i Financës ka kryer sistemimet përkatëse;

- Sa i takon Vendimeve Gjyqësore, në vijimësi Sektori i Financës do të marrë masat për klasifikimin e shpenzimeve në formë page 600 “Shpenzime për paga” dhe 6027 “Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”;

-Sa i takon urdhërshpenzimeve për likuidimet e TVSH-së, Instat do të marrë masat për vendosjen e një kopje të praktikës, si dhe sa i takon dokumentacionit në gjuhë të huaj, janë marrë masat duke përfshirë dhe kostot e përkthimit në parashikimet buxhetore, dhe në vijimësi do të marrë masa për përkthyer kontratat që ka në zbatim për vitin 2024;

-Në zbatim të rekomandimit tuaj, Titullari i Institucionit do të marrë masa për hartimin e urdhrimit për ngritjen e grupit të punës me qëllim verifikimin e ligjshmërisë për të gjitha pagesat e kryera për trajtimet financiare të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit me burim financimi donatorët e huaj si dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Sa më sipër, nga subjekti i audituar janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna, të cilat janë pranuar dhe nga institucioni i INSTAT do të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre.

2.3 Auditimi i llogarive vjetore.

Në zbatim të pikës 3 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2023;
2. Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitin 2023;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin 2023;
5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023;
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2023;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitin 2023;
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2023.

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin

e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MF me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Konstatohet se, veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga INSTAT, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit. PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- Për vitin 2023 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Aparatit INSTAT pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 558 Prot., datë 29.03.2024 “Dërgohen pasqyrat financiar vjetore për vitin 2023”.

Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se Pasqyrat Financiare të Aparatit të INSTAT janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 558 Prot., datë 29.03.2024 “Dërgohen pasqyrat financiar vjetore për vitin 2023” brenda afatit të përcaktuar. Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Gjithashtu, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Pasqyrat Financiare viti 2023

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”, i ndryshuar.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të INSTAT konstatohet se:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si me poshtë:

- Te drejtat (Aktivet)	630,215 mijë lekë
- Detyrimet (Pasivet)	62,328 mijë lekë
- Fondet Neto (Aktivet neto)	567,887 mijë lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto (567,887 mijë lekë).

1.1. Te Drejtat (Aktivet)

Aktivet më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **630,215,543 lekë** dhe përbëhen nga:

në lekë

Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Pesha % për 2023	Pesha % për 2022	Ndryshimi
I. Aktivet Afatshkurtra	148,555,327.00	127,392,093.00	24%	34%	21,163,234.00
II. Aktivet Afatgjata	481,660,216.00	243,619,860.00	76%	66%	238,040,356.00
III. Aktivet afatgjata financiare	-	-	0%	0%	-
IV. Investime	-	-	0%	0%	-
Totali	630,215,543.00	371,011,953.00	1.00	1.00	259,203,590.00

Burimi: INSTAT/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi u konstatua se në vitin 2022 Aktivet e afatshkurtra kanë zënë 34% të totalit të të Drejtave në vlerë 127,392 mijë lekë ndërsa Aktivet afatgjata kanë zënë 66% të totalit në vlerë 243,619 mijë lekë.

Gjatë vitit 2023 ky raport ka ndryshuar me trend rritës dhe më konkretisht aktivet e afatshkurtra kanë zënë 24% të totalit të aktiveve në vlerë 148,555 (mijë lekë) ndërsa aktivet afatgjata kanë zënë 76% të totalit të aktiveve në vlerë 481,660 (mijë lekë).

Ndryshimi në Aktivet e afatshkurtra gjatë vitit në vlerë është 21,163 (mijë lekë) I cili pavarësisht se është me rritje në vlerë në raport me peshën specifike me totalin e aktiveve është në rënie me 10% ndërsa për aktivet afatgjata gjatë vitit ndryshimi në vlerë është në rritje me 238,040 (mijë lekë) duke u rritur dhe në peshë specifike me 10% të totalit të aktiveve në vlerë.

I.1.a Aktivet afatshkurtra (qarkulluese)

AASH paraqiten në vlerën 128,555,327 lekë dhe përbëhen nga shumatat e rubrikave që përfaqësojnë:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 93,458,048 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 14,649,774 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 40,447,505 lekë

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar F1 të vitit 2023 në mbyllje paraqitet në shumën prej 93,458,048 lekë, e cila rakordon me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 93,458,048 lekë të formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”

Është bere rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave

Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 93,458,048 lekë e cila përfaqëson gjendjet si me poshte:

Në lekë

Disponibilitete në thesar	93,458,048
Fonde të pashpenzuara nga Sponsorizimet	71,577,096
Mjete në ruajtje	160
Shpenzime të njohura nga thesari për likuidim në janar	21,880,792

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Pika 50 e udhëzimit: Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato

të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2023 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2023 paraqitet e njëjtë me atë të vitit 2022.

Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe me ditarin e bankës rezultojnë të jenë të rakorduara.

- Fonde te pashpenzuara nga sponsorizimet paraqiten te detajuara në aneksin nr.1, tabela 1
- Fondet e pashpenzuara brenda datës së mbylljes së pasqyrave financiare si shpenzime të njohura kryesisht të muajit dhjetor 2023 nga thesari për likuidim në janar të vitit 2024 e detajuar, paraqiten si më poshtë:

		<i>Në lekë</i>
Shpenzime te njohura nga thesari për likuidim ne janar		21,880,792
Kreditore të ndryshëm		6,824,722
Paga		6,763,948
Dieta/kompensime/shpërblime		8,292,122

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Klasa 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

		<i>Në lekë</i>	
Llogaria	Emërtimi	2023	2022
	2. Gjendje inventari qarkullues	14,649,774	14,889,201
31	Materiale	13,523,580	13,758,687
32	Inventar i imët	1,126,194	1,130,514

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të INSTAT në 31.12.2023 paraqitet në shumën 14,649,774 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 13,523,580 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 1,126,194 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 239,427 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 239,427 lekë.

Për vitin 2023, është kryer inventarizimi i aktiveve, bazuar në urdhrin e Sekretarit Përgjithshëm me nr. 1854 prot., datë 25.09.2023, është bere ngritja e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2023.

Gjendja e llogarive kontabël është e kuadruar me gjëndjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

▪ Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaria	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca
	3. Llogari të arkëtueshme	40,447,505	24,282,611	16,164,894
468	Debitorë të ndryshëm	281,785	285,721	(3,936)
4342	Operacione me shtetin (të drejta)	40,165,720	23,996,890	16,168,830

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 281,785 lekë përfaqëson të drejtat që i kanë lindur institucionit për të arkëtuar debitorë të cilët janë kryesisht punonjës dhe ish punonjës për të

cilët janë vendosur detyrime nga Auditi i brendshëm dhe nga vendime gjyqate. Kjo llogari vjen e pakësuar nga viti 2022 në shumën 3,936 lekë si kthim parardhënie e detyrimit të një punonjësi, e cila daton që në vitin 2012 dhe përfaqësojnë të drejta ndaj punonjësve.

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Të drejta)” në shumën 49,165,720 lekë përfaqëson detyrimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, detyrimet e TAP si dhe detyrime të tjera. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436, 437 dhe 467. Llogaria analitike 4342 “*Operacione me shtetin(Të drejta)*” paraqitet në aneksin nr.1, tabela 2.

1.1.b Aktivet Afatgjata

AAGJ përbehen nga aktivet afatgjata jomateriale dhe aktivet afatgjata materiale, të cilat paraqiten në aneksin nr.1 tabela 3. Ato paraqiten në vlerën 481,660,216 lekë dhe përbehen nga shumatat e rubrikave që përfaqësojnë llogaritë e grupit 203, 212, 214, 215 dhe 218.

Aktivitet afatgjata jo materiale përbehen nga Llogaria 203 “*Koncesione, patenta, licenca e te ngjashme*” në shumën 26,816,533 lekë

Aktivitet afatgjata materiale përbehen nga:

- a- Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” në shumën 107,353,957 lekë;
- b- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në shumën 18,009,324 lekë;
- c- Llogaria 215 “Mjete transporti” në shumën 5,800,378 lekë;
- d- Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në shumën 323,680,024 lekë.

Llogaritë e Klasës 20 “**Aktivitet Afatgjata Jo materiale**”, paraqitet në vlerë kontabël neto në shumën 26,816,533 lekë dhe përbehen nga llogaria 203 “*Koncesione, patenta, licenca të ngjashme*” e cila përfaqëson licenca të ndryshme software, serverash etj në funksion të aktivitetit të INSTAT. Në vitin 2022 vlera kontabël neto e AAJM-ve paraqitet në shumën 5,326,495 lekë, ndërsa në vitin 2023 kemi një rritje të AAJM-ve në shumën 21,490,038 lekë neto. Ndryshimi në vlerë i kësaj llogarie vjen si rezultat i shtesës në vlerën 26,452,106 lekë, që vijnë si rezultat i blerjeve në shumën 3,379,528 lekë dhe 23,072,578 lekë hyrje jashtë sistemit nga grantet dhe donacionet dhe pakësimeve që vijnë si rezultat i nxjerrjeve jashtë përdorimit në vlerën 2,659,464 lekë si dhe amortizimit vjetor.

Nga auditimi i kësaj llogarie konstatohet se përlllogaritja e amortizimit të grupit është bërë me normë 25% si dhe me metodë amortizimit me “*Vlerë te mbetur*”. Norma e amortizimit duhet të ishte 15% ndërsa metoda duhet të ishte “Lineare”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 36

Llogaritë e Klasës 21 “**Aktivitet Afatgjata Materiale**”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 454,843,683 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 238,293,365 lekë, me një shtim të AAM-ve në shumën 216,550,318 lekë.

Llogaritë përbërëse te AAM analizohen si më poshtë:

-Llogaria 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 107,353,957 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën prej 113,004,165 lekë. Metoda e llogaritjes së amortizimit është me “*Vlerë te mbetur*”. Norma e amortizimit e përdorur për të llogaritur amortizimin është 5%. Amortizimi në vlerë konstatohet në shumën 5,650,208 lekë ose 5% mbi vlerën kontabël neto në çelje të vitit ushtrimor.

Nga analiza e llogarisë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*” konstatohet se përbëhet nga vetëm një ndërtesë dhe ndryshimi mes dy viteve në vlerë ka ardhur si rezultat i amortizimit vjetor.

-Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, pasqyrohet me vlerën neto 18,009,324 lekë dhe përfaqëson pajisje të ndryshme si dhe licenca programesh kompjuterike financiare dhe personeli. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e AAM-ve pasqyrohet në shumën 20,396,968 lekë, me një pakësim të tyre në shumën 940,009 lekë që ka ardhur si rezultat i daljes jashtë përdorimi, dhe 1,447,635 lekë vlera e amortizimit vjetor.

Nga auditimi i llogarisë analitike u konstatua se amortizimi është përlllogaritur me normën 5% për një pjesë të pajisjeve, duke sjellë një vlerë jo të saktë të zhvlerësimit nga amortizimi, veprim në kundërshtim me Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 36. Për një pjesë amortizimi është përlllogaritur me normën 25% duke sjellë një vlerë jo të saktë të zhvlerësimit nga amortizimi, veprim në kundërshtim me Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 36. Një pjesë e këtyre aseteve siç janë “HR modul program personeli”, “Kontabiliteti Alpha net” të cilat janë AAJM janë kontabilizuar në llogarinë 214 te AAM veprime ne kundërshtim me Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”

-Llogaria 215 “*Mjete transporti*” pasqyrohet me vlerën neto 5,800,378 lekë dhe përfaqëson mjetet e transportit në pronësi dhe funksion të institucionit. Institucioni posedon 4 automjete. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e AAM-ve pasqyrohet në shumën 6,038,842 lekë, me një pakësim të tyre në shumën 238,464 lekë vlerë e amortizuar gjate vitit. Nga auditimi i llogarisë analitike u konstatua se amortizimi është përlllogaritur me normën 5% duke sjellë një vlerë jo të saktë të zhvlerësimit nga amortizimi, veprim në kundërshtim me Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 36.

-Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” paraqitet me vlerën neto 323,680,024 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën absolute 224,826,634 lekë në rritje nga viti i 2022. Gjatë vitit 2023 INSTAT ka pasur shtesa në asete në vlerë 280,292,915 lekë. Shtesat në asete për këtë llogari janë rezultat i blerjeve me pagesë nga fondet e miratuara nga buxheti për vitin 2023 në shumën 270,732,000 lekë dhe shtesa pa pagesë ne shumën 9,560,915 lekë si rezultat i granteve dhe donacioneve. Kjo llogari është pakësuar në vlerën 6,768,795 lekë të cilat përfaqësojnë daljet jashtë përdorimit, si dhe efektit të amortizimit vjetor.

Nga auditimi i llogarisë analitike 218 u konstatua se një pjesë e këtyre aseteve të kontabilizuara në këtë llogari siç janë “Laptop 131156.8 KE”, “Kompjuter Workstation sida” duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”. Një pjesë tjetër siç janë “firewall sida”, “Firewall UTM” duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 203 “*Koncesione, patenta, licenca të ngjashme*”. Nisur nga analiza e zërave të aktiveve dhe amortizimit të tyre zë për zë u konstatua se disa artikuj janë amortizuar me normën 20% që nuk i përket grupit të cilit ato bëjnë pjesë, një pjesë tjetër janë amortizuar me normë 25%, një pjesë tjetër janë amortizuar me normë 5%. Metoda e zgjedhur e amortizimit e aplikuar nga institucioni është ajo me “Vlerë te mbetur”.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar pika 36, duke ndikuar në mos pasqyrimin e saktë të gjendjen neto të aktiveve, si dhe ndikimi i amortizimit vjetor në fondin neto të institucionit.

1.2. Detyrimet (Pasivet)

Detyrimet në datën 31.12.2023 janë pasqyruar në shumën 62,328,457 lekë dhe përbëhen vetëm nga detyrimet afatshkurtra.

1.2.a- *Detyrimet afatshkurtra* në datën e mbylljes së pasqyrave financiare paraqiten të përbëra vetëm nga llogaritë afatshkurtra të paraqitura në aneksin nr.1, tabelën 4.

Llogaritë e klasës 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e INSTAT në datën 31.12.2023 kundrejt furnitorëve, punonjësve për pagat e muajit dhjetor 2023, tatimeve për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorëve të ndryshëm etj, të analizuar si më poshtë:

- Llogaria 42, *“Detyrime ndaj personelit”* në shumën 20,015,206 lekë, e cila përfaqëson shumën e pagave neto të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, e cila nuk rakordon me vlerën sipas listë pagesës së muajit Dhjetor 2023. Sipas listëpagesës E-sig025 detyrimet për personelin (paga neto) janë 44,445,679 lekë. Në këtë llogari janë kontabilizuar edhe detyrimet për qira ambientesh. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar.

- Llogaria 431 *“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”* në shumën 4,642,123 lekë e cila përfaqëson vlerën e mbajtur punonjësve për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për pagat e muajit dhjetor 2023 e cila paguhet në janar të vitit pasardhës e cila rakordon me listëpagesën e deklaruar në muajin dhjetor 2023 në shumën 4,642,123 lekë si dhe tatim në burim

- Llogaria 435, *“Sigurime shoqërore”* dhe llogaria 436 *“Sigurime shëndetësore”* përfaqëson vlerën kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 dhe që paguhet në muajin janar 2024 përkatësisht në vlerat 6,321,726 lekë dhe 955,446 lekë. Këto teprica nuk rakordojnë me listëpagesën e deklaruar në muajin dhjetor 2023. Në formularin E-Sig025 për muajin dhjetor të deklaruar në sistemin e tatimeve C@ts shumat e deklarimeve janë përkatësisht:

- i. Për kontribute të sigurimeve shoqërore në shumën 13,055,383 lekë;
- ii. Për kontribute të sigurimeve shëndetësore në shumën 1,893,610 lekë.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar.

- Llogaria 437, 438 *“Organizma të tjerë shtetërorë”* në shumën 6,442,766 lekë përfaqëson kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 për punonjësit me kontrate, Teprica e kësaj llogarie duhet të ishte kontabilizuar në llogaritë 435 dhe 436. Ky kontabilizim i kryer është në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar.

- Llogaria 466 *“Kreditorë për mjete në ruajtje”*, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2023 paraqitet në vlerën kontabël prej 160 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave të kryera nga ana e INSTAT por të pambyllur akoma. Nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhblokimin e kësaj teprice, veprim në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar.

- Llogaria 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* përfaqëson:

Kreditore të ndryshëm	22,041,308
Kreditorë të ndryshëm	6,985,235
Paga	6,763,948
Dieta/kompensime/shpërblime	8,292,125

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” konstatohet se janë kontabilizuar detyrime për paga, dieta, kompensime dhe shpërblime si dhe kreditore te ndryshëm. Një pjese e detyrimeve të regjistruara në këtë llogari janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” siç janë pagat apo kreditorët e ndryshëm për të cilët ekzistojnë fatura për shërbimet që ata kane kryer ndaj INSTAT. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” sipas udhëzimit të MF nr.8, datë 09.03.2018 përfaqëson “Konstatimin e detyrimeve të tjera për t’u paguar, të cilat nuk rezultojnë nga marrëdhëniet tregtare...” Tepricat për paga, dieta kompensime dhe shpërblime duhet të ishin kontabilizuar në llogaritë 42 “Detyrime ndaj personelit”

- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në shumën 281,785 lekë” përfaqëson detyrimin që INSTAT i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarketuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari rakordon me llogarinë 468 “Debitore te ndryshëm”.

1.3. Fondet Neto

Nga auditimi konstatohet se Aktivët neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivët Neto (567,887 mijë lekë), nga të cilat llog 101 “Fondi i akumuluar” është 167,236,428 lekë, llogaria 12 “Rezultatet e mbartura” në shumën 74,151,327 lekë e cila përfshin rezultatin e mbartur në vitin 2022 shtuar me rezultatin e vitit 2022. Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në shumën (2,574,228) lekë përfaqëson rezultatin e vitit ushtrimor 2023. Llogaria 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në shumën 296,350,065 lekë përfaqëson investimet nga buxheti për vitin 2023 i cili ka ardhur në rritje nga viti 2022. Llogaria 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” përfaqëson investimet nga organizatat e huaja.

Ne zbatim të UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” aneksi 1, pika 1.1.2.c respektive citon se: “... **Llogaritë 105** mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllën (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.” “**Llogaritë 106** mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllën (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.”

Sa më sipër, llogaritë 105 dhe 106 duhet të kapitalizoheshin brenda periudhës ushtrimore dhe jo të mbylleshin me teprica. Mbyllja me tepricë e llogarive 105 dhe 106 është kryer në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar aneksi 1, pika 1.1.2.c. Pasqyra e aktiveve neto/fondeve neto paraqitet në aneksin nr.1, tabela 5.

Llogaria 101 “Teprica/Deficiti i akumuluar”, është shtuar këtë vit me vlerën 104,157,430 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit të cilat janë shtuar me tepricën në mbyllje të

vitit 2022 te granteve kapitale te brendshme dhe granteve kapitale te huaja pakësuar me amortizimin e vitit 2023 ne shumën 68,705,204 lekë, ndryshimin e gjendjes magazinës ne shumën 239,427 lekë si dhe

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën -2,574,228 lekë dhe përfaqëson fondet jashtë buxhetore të ngelura pranë Institucionit të cilat do të trashëgohen në vitin 2024. Kjo tepricë debitore përfaqëson rezultatin nga funksionimi që institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) për t’u trashëguar në ushtrimet e mëpasme.

2. Pasqyra e Performancës F2

Nga auditimi i gjendjes së llogarive ne pasqyrën e performancës rezultoi se, konstatimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.

Totali i te “Ardhurave” në Pasqyrën e Performancës F2 është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit. Për vitin 2023 pasqyra paraqiten si me poshtë:

- a- Të ardhurat (grupi A) = 1,211,544,220 lekë
- b- Shpenzimet (grupi B) = 1,214,118,448 lekë
- c- Rezultati i ushtrimit (llog.85)= (2,574,228) lekë

Llogaria 85 “Teprica ose deficioni i periudhës“ në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Ndryshimi i gjendjes se llogarive te klasës 2 ne Pasqyrën e pozicionit financiar në formatin F1 (diferenca midis tepricës më 31.12.2022 me 31.12.2023, përkatësisht 14,649,774 minus 14,889,201 konstatohet (239,427) lekë). Kjo vlerë konstatohet e barabartë me tepricën e llogarisë 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Pasqyra performancës financiare”.

2.1 Të ardhurat

A	TË ARDHURAT	1,211,544,220.00
71	III. TË ARDHURA JOTATIMORE	37,704,000.00
72	V. GRANTE KORRENTE	1,173,840,220.00

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i pasqyrës se performancës konstatohet se te ardhurat e realizuara gjate vitit 2023 ne vlerën 1,211,544,220 lekë janë rezultat i:

- a- Te ardhurave jotatimore
- b- Grantet korrente

‘në lekë

Llogaria	A	TË ARDHURAT	1,211,544,220
	71	III. TË ARDHURA JOTATIMORE	37,704,000
43	7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	37,704,000
	72	V. GRANTE KORRENTE	1,173,840,220
55	7200	Nga buxheti për NJQP (Qendrore)	1,130,429,562
61	7206	Financim i pritshëm nga buxheti	40,165,720
66		Nga organizata ndërkombëtare	3,244,938

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Te ardhurat jotatimore janë rezultat i të ardhurave të krijuara nga ana e INSTAT të kontabilizuara në llogarinë 7113 *“Te ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve”* për shërbimin e kryer për llogari të Bankës së Shqipërisë për anketat e kryera në shumën 37,704,000 lekë.

Nga auditimi i rakordimit të të ardhurave konstatohet se kemi mospërputhje midis pasqyrës së performancës me rakordimin e thesarit, konkretisht në rakordim *“Te ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve”* paraqiten në shumën 48,486,700 lekë, ndërsa në pasqyrën e performancës paraqiten në shumën 37,704,000, pra me një diferencë prej 10,782,700 lekë, veprim në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësisive e Qeverisjes së Përgjithshme”* pika 37, ku citohet: *“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë Cash, me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët”*.

Grantet korrente përbehen nga financimet nga buxheti dhe nga financimet nga organizatat ndërkombëtare.

- Llogaria 7200 *“Nga buxheti për NJQP (Qendrore)”* përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit në shumën 1,130,429,562 lekë.

- Llogaria 7206 *“Financim i pritshëm nga buxheti”* përfaqëson shumën që institucioni u detyrohet punonjësve për pagat e muajit dhjetor, detyrimet ndaj shtetit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin e mbajtur për tatimin mbi pagat si dhe detyrime të konstatuara ndaj të tretëve të muajit dhjetor 2023 për shërbime ndaj INSTAT, shpenzime të cilat do të kryhen në janar 2024.

Grantet korrente llogaria 721 *“Nga organizata ndërkombëtare”* përfaqëson shumën e fondeve në formën e granteve të akorduara nga organizata të huaja për institucionin.

Nga grupi i auditimit konstatohet se grantet e huaja në INSTAT, nuk janë njohur në pasqyrat financiare në total, por paraqiten vetëm në vlerën e cila është përdorur gjatë vitit ushtrimor. Mos njohja e shumës totale të granteve dhe sponsorimeve në pasqyrat financiare sjell një pasqyrim jo të drejtë të këtyre fondeve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.02.2022 *“Për disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të financave dhe ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësisive e Qeverisjes së Përgjithshme”* pika 3.

2.2 Shpenzimet

Llogaria 600 *“Pagat dhe përfitimet e punonjësve”* në shumën prej 527,345,798 lekë, përfaqëson pagat e personelit të përhershëm dhe të përkohshëm sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesa të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts. Nga verifikimi i kësaj llogarie konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar edhe shpenzime për qira ambientesh duke sjellë një pasqyrim jo të saktë të shpenzimeve për paga, veprim në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar.

Llogaria 601 *“Kontribute të Sigurimeve”* në shumën prej 86,682,487 lekë, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e kontributeve e paguar nga punëdhënësi sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesa të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts.

Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në shumën prej 598,544,921 lekë, përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve e cila përbëhet nga:

a) Llogaria 6020 “Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme” për 2,177,847 lekë cila paraqet shpenzimet që institucionet ka kryer për blerje materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme dhe kancelari gjatë vitit 2023. Në këtë llogari gjejmë të kontabilizuara shpenzime të cilat nuk i përkasin kësaj klase siç janë “Blere goma dhe bateri makine nga B.M” te cilat duhet te regjistroheshin në llogarinë 6023 “Shpenzime transporti” apo “Blere kafe dhe ujë nga N.C” të cilat duhet të regjistroheshin në llogarinë 6029 “Shpenzime të tjera operative”. Nga auditimi konstatohet se llogaria analitike nuk përputhet me tepricën sintetike të deklaruar në pasqyrën e performancës F2. Diferenca është 265,131 lekë

b) Llogaria 6021 “Materiale dhe shërbime speciale” për 41,718,618 lekë përbëhet nga shpenzime të kryera nga institucioni për “trajtim i punonjësve me shërbim catering në kuadër te Cens 2023” në shumën 38,803,105 lekë, “Blere shtypshkrime” nga tre shoqëri në shumën 2,898,613 lekë. Shpenzimet për “trajtim i punonjësve me shërbim catering në kuadër te Cens 2023” janë keqklasifikuar si shpenzime “Materiale dhe shërbime speciale”. Ato duhet të kontabilizoheshin si “Shpenzime të tjera operative” në llogarinë 6029

c) Llogaria 6022 “Shërbime nga të tretë” për 472,671 070 lekë përbëhet nga shpenzime për shërbime utilitare si energji elektrike, ujë, shërbim telefoni/internet, shërbime postare, shërbim ruajtje objekti, taksa vendore, shërbim monitorimi mediatik, shërbim akomodim hotelerie në kuadër te CENS-it, si dhe shpenzimet në kuadër të CENS dhe anketave të ndryshme për paga dhe tatime. Shpenzimet për paga dhe tatime të kontabilizuara në këtë klase janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”

d) Llogaria 6023 “Shpenzime transporti” në shumën 7,840,620 lekë përbëhet nga shpenzime për karburant, pjesë këmbimi, dhe policat e sigurimit të detyrueshëm për automjetet në pronësi të subjektit

e) Llogaria 6024 “Shpenzime udhëtimi” në shumën 20,565,484 lekë përbëhet nga shpenzime për dieta dhe bileta avionësh për udhëtimet jashtë shtetit si dhe dieta për stafin në kuadrin e CENS-it. Shpenzimet për dietat të kontabilizuara në këtë llogari janë të keqklasifikuara. Kontabilizimi i drejtë do te ishte në llogarinë 6009 “Shpenzime te tjera për personelin” sipas UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”

f) Llogaria 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në shumën 14,518,246 lekë përfaqëson shpenzime për shërbime mirëmbajtje pajisje kompjuterike, rinovim licencash, shërbim mirëmbajtje automjetesh.

g) Llogaria 6026 “Shpenzime për qiramarrje” në shumën 38,215,401 lekë përfaqëson shpenzimet për qiramarrje ambientesh në shumën 7,578,827 si dhe automjetesh në shumën 30,636,575 në kuadër te CENS-it.

h) Llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në shumën 818,960 lekë përfaqësojnë “shpenzime për ekzekutim te vendimeve gjyqësore për largim nga puna” për punonjës in E.Nuzi. Nga auditimi konstatohet se ky shpenzim është ekzekutim vendim gjyqi për përfitim pagash për largim nga puna. Ky shpenzim është keqklasifikuar në këtë klase, duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” ne zbatim të UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

i) Llogaria 6029 “Shpenzime të tjera operative” ne shumën 18,675 lekë

1. Llogaria 604 “Transferime korrente tek institucione qeveritare të ndryshme” në shumën prej 414,000 lekë “Kont.pag.K.Statistikave, Kont.pag.K.Nomenklatures korrik, tetor dhjetor” përfaqëson pagesa për pjesmarrjen në mbledhjet e këshillit të statistikave dhe komisionit kombëtar të nomenklatures për muaj të ndryshëm. Nga Sektori i Financës për punonjësit e brendshëm në INSTAT, që janë pjesë e KS dhe KKN, për këto pagesa është mbajtur tatim në burim në vlerën 15% dhe nuk është trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e punonjësve. Sa më sipër veprime në kundërshtim me neni 8 dhe neni 9 pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe shfuqizuar me ligjin me nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” neni 12, i cili shtrin efektet nga data 1 janar 2024 dhe Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar paragrafi 2.3, pika 2.3.1, i shfuqizuar me Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” paragrafi 12, i cili ka hyrë në fuqi nga data 1.1.2024.

Konstatohet shuma e paguar për anetaret e komisioneve të sipercituar është keqklasifikuar në llogarinë 604. Në zbatim të UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” duhet të ishin kontabilizuar në një nga nenllogaritë e klasës 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”

Llogaria 6061 “*Transferta të paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor*” në shumën prej 1,131,242 lekë përfaqëson shpenzime për kompensime për telefonat celulare. Këto shpenzime në zbatim të UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*” duhet të kontabilizoheshin në nenllogarinë e klasës 602 “Blerje mallra e shërbime”.

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejtë në shumën prej 139,427 lekë. Nga auditimi i rakordimit të “Situacion shpenzimesh Janar-Dhjetor 2023” i degës së Thesarit me pasqyrën e performancës kemi mospërputhje vlerash. Shpenzimet korrente sipas pasqyrës performancës pasqyrohen në vlerën 1,214,118,448 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 1,197,949,619 lekë, paraqitur në aneksin nr.1, tabela nr. 7.

Mosrakordimi i të dhënave dhe veprimet e tjera të mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr 31 dt. 13.12.2023 “*Per procedurat e mbylljes se llogarive vjetore te buxhetit per vitin 2023*” pika 34, 41.

▪ **Situata e Detyrimeve të Prapambetura INSTAT:**

Nga detyrimet në kohe reale të detyrimeve nga sistemin tatimor C@TS konstatohet se INSTAT deri më datë 07.05.2024 paraqitet me detyrime të papaguara në shumën 1,648,481 lekë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe detyrime për tatimin nga të ardhurat personale të cilat në Pasqyrën e Pozicionit Financiar nuk janë të paraqitura. Këto detyrime janë vetëm gjopa të regjistruara dhe interes i regjistruar përkatësisht:

a- Gjopa të regjistruara në shumën 1,387,556 lekë të cilat janë për deklarime me vonese të formularëve ESIG027 në shumën 1,000,000 lekë si dhe 387,556 lekë për pagese me vonese të detyrimeve të lindura nga formularët ESIG027 për periudha të ndryshme.

b- Interes i regjistruar në shumën 250,925 lekë janë gjeneruar nga sistemi i tatimeve për pagesat e kryera me vonesë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, tatim mbi të ardhurat personale si dhe tatim në burim

2. Periudha e lindjes së këtyre detyrimeve fillon që nga viti 2014. Institucioni nuk ka marrë asnjë masë për evidentimin dhe pasqyrimin e këtyre detyrimeve në pasqyrat financiare apo asnjë masë që të kryejë shlyerjen e tyre. Gjithashtu institucioni nuk ka marrë asnjë masë për evitimin e lindjes së këtyre detyrimeve të cilat janë përgjegjësi e punonjësve të cilët merren me deklarin e këtyre detyrimeve në sistemin C@ts. Detyrimet e lindura gjoba për “Deklarime të vonuara” në shumën 1,000,000 lekë janë shumë lehtë të evitueshme duke bërë deklarinet në kohë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, nenin 61, Udhëzimi i MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

2. Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore, njohjen e tyre në kontabilitet dhe likuidimin e tyre nëpërmjet bankës rezultoi se në vitin 2023 janë likuiduar në shumën totale vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë në shumën prej 818,960 lekë

Ky vendim gjyqësor nuk është njohur në kontabilitet si detyrim rrjedhimisht, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2022. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor. Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shërbim mirëmbajtje fotokopje, printera dhe plotera” (trajtuar në aktkonstatimin nr. 5), është nënshkruar kontrata nr.161/7 prot., datë 22.09.2022 për lotin 1 në vlerën 536,000 lekë pa tvsh, me OE P.S shpk, ku u konstatua se OE ka faturuar në portalin e fiskalizimit faturën elektronike me nr. 11305/2022 datë 20.12.2022, në vlerën 643,200 lekë me TVSH. Sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi se nga ana e Sektorit të Financës në Instat, këto detyrime nuk janë njohur si detyrime të prapambetura në pasqyrat financiare veprim në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

▪ **F4/Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto**

Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” konstatohet se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë me të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C.

Aktivitet neto rakordojnë me fondet neto, por për disa zëra nuk ka informacion sesi sektori i financës ka arritur në rezultatet e pasqyruara.

Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në burimet e brendshme.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se INSTAT ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...”

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2022-2023. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Inventarizimi i vitit 2022:

Me Urdhrin e Brendshëm të DP nr.prot 1653 datë 21.09.2022 është urdhëruar ngritja e komisionit për inventarizimin, vlerësimin dhe kontabilizimin e aseteve kryesore dhe pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme me përbërje Z. A.B, Znj. A.D dhe Znj. T.K. Gjithashtu është urdhëruar edhe ngritja e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Zyrat Rajonale me përbërje z. I.D me detyre “Përgjegjës i sektorit të administrimit të rrjetit dhe serverave”, Z. E.T me detyre “përgjegjës i sektorit të shërbimeve” dhe znj. E.Sh me detyre “Specialiste e sektorit të financës” Me urdhrin nr 58 datë 12.12.2022 protokolluar me nr. 1653/1 prot dt. 12/12/2022 është urdhëruar ngritja e komisionit për vlerësimin e aktiveve me përbërje z. K.SH kryetar, dhe me anëtarë z. E.T, z. I.D.

Me urdhrin nr. 61 datë 23.12.2022 protokolluar me nr. 1653/2 prot dt. 23/12/2022 është urdhëruar ngritja e komisionit të asgjësimit të pajisjeve dhe materialeve të Instat dhe Zyrave rajonale statistikore me përbërje z. A.D kryetar dhe me anëtarë z. F.S, z. L.B, z. F.D, z. A.E.

Me urdhrin nr. 24 datë 24.02.2023 protokolluar me nr. 1653/3 prot dt. 24/02/2023 është urdhëruar kryerja e kontabilizimit të rezultatit të inventarizimit për vitin 2022.

Mbështetur mbi Urdhërat e mësipërm është shkarkuar nga kontabiliteti shuma 20,512,927 lekë, e përbërë nga:

- Artikuj AQT me vlerë 20,177,257 lekë
- Artikuj AQ me vlerë 335,670 lekë

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me anë të relacionit të datës 30.11.2022 është hartuar raporti mbi inventarizimin e aseteve për zyrat rajonale, ku është realizuar inventarizimi i gjendjes faktike të materialeve krahasuar me kartelën e inventarit. Në raport specifikohet se: “Gjate inventarizimit nuk rezultuan mungesa dhe teprica. Duhet theksuar se kushtet e ruajtjes së aktiveve në përgjithësi janë të mira”.

Gjithashtu në relacion komisioni “propozon të dalin nga përdorimi AQT 21 artikuj në vlerë 1,906,054 lekë dhe AQ 3 artikuj me vlerë 12,133 lekë, në total 1,918,187 lekë

Listat e artikujve të propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit janë nënshkruar rregullisht nga komisioni dhe personat përgjegjës.

- Me datën 30.11.2022 është hartuar relacioni mbi inventarizimin e aktiveve për vitin 2022 të aparatit qendror INSTAT.

Sipas këtij relacioni nga komisioni i ngritur për këtë detyrë janë propozuar të dalin nga përdorimi 80 lloje artikujsh me vlerë 20,084,633 lekë nga të cilat AQT me vlerë 19,761,096 lekë dhe AQ me vlerë 3232,537 lekë. Bashkangjitur relacionit është lista e plotë me artikujt e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit, dhe këto dokumenta janë hartuar në përputhje me Udhëzimin 30.

- Me datën 22.12.2023 është hartuar nga “Komisioni për vlerësimin e aktiveve” relacioni përmbledhës “Mbi vlerësimin e aktiveve të vlerësuara për dalje nga përdorimi për vitin 2022 aparati qendror dhe zyrat rajonale” propozon të dalin nga përdorimi AQT 57 artikuj me vlerë 18,271,203 lekë dhe AQ 19 artikuj me vlerë 323,537 lekë, në total 76 artikuj me vlerë 18,594,740 lekë. Gjithashtu komisioni i vlerësimit të aktiveve vendosi që të mos dalin nga përdorimi 6 artikuj me vlerë 1,489,893 lekë.

- Me datën 24.02.2023 është urdhëruar kontabilizimin e rezultateve të inventarizimit të aparatit qendror INSTAT dhe të zyrave rajonale statistikore të vitit 2022 në shumën 20,512,927 lekë nga të cilat artikuj AQT me vlerë 20,177,257 lekë si dhe artikuj AQ me vlerë 335,670 lekë sipas listave bashkangjitur dhe procesverbalit të asgjësimit.

Referencat e vëna në këto urdhra administrative mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi, janë dispozita në fuqi, përkatësisht me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar përgjithësisht kanë gjetur zbatim.

Konstatime për procesin e inventarizimit të aktiveve materiale:

- Nga grupi i auditimit u konstatua se, materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi që nga momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë. Po ashtu nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive.

- Gjate procedurës së inventarizimit të aktiveve afatshkurtra “Inventar qarkullues” dhe “Inventar i imët” komisioni i inventarizimit dhe komisioni i vlerësimit nuk është shprehur lidhur me mallrat gjendje të cilët kanë një kohe të gjatë në magazine në zbatim të paragrafit 103 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Duke mos u realizuar kjo detyrë nuk na jepet një pasqyre e sakte vlerës në magazinës rrjedhimisht të fondeve neto të Instat

- Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 103, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, që sanksionon se, Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas kritereve të përcaktuara në këtë paragraf.

Inventarizimi i vitit 2023

Me Urdhrin e Brendshëm nr.prot 1854 datë 25/09/2023 nga INSTAT është urdhëruar ngritja e komisionit për inventarizimin, vlerësimin dhe kontabilizimin e aseteve kryesore dhe pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme me përbërje Znj. M.Q, Znj. A.D dhe Z. A.D.

Me Urdhër të Brendshëm nr 161 dt. 15/12/2023, protokolluar me nr.1854/1 prot, datë 15.12.2023, është urdhëruar ngritja e komisionit për vlerësimin të aseteve me përbërje z. K.Sh kryetar komisioni me detyre “Drejtor i drejtorisë se përgjithshme te shërbimeve mbështetëse dhe koordinimit”, z. A.B anëtar me detyre “Përgjegjës i sektorit te financës” dhe z. G.K anëtar me detyre “S/Sektorit i administrimit te rrjetit dhe serverave”

Me urdhrin nr EXTRA datë 22.12.2023 protokolluar me nr. 1854/2 prot dt. 22/12/2023 është urdhëruar ngritja e komisionit për asgjësimin e pajisjeve dhe materialeve te INSTAT dhe zyrave rajonale statistikore me përbërje z. I.D kryetar, dhe me anëtarë z. E.T, z. F.D, z. G.H dhe B.S.

Me urdhrin nr.1854/3 datë 29.12.2023 është urdhëruar kryerja e kontabilizimit të rezultatit të inventarizimit.

Mbështetur mbi Urdhërat e mësipërm është shkarkuar nga kontabiliteti shuma 10,786,469.6 lekë, ku për Aparatin Qendror shuma 10,368,270 lekë është e përbërë nga:

- Artikuj AQT me vlerë 10,368,270.9 lekë
- Artikuj AQ me vlerë 418,198.7

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me anë të relacionit të datës 29.11.2023 është hartuar raporti mbi inventarizimin e aseteve në Drejtorinë e Përgjithshme dhe zyrat rajonale, ku është realizuar inventarizimi i gjendjes faktike të materialeve në çdo zyrë krahasuar me kartelën e inventarit. Në raport specifikohet se: “Inventari ka dal në rregull dhe se një pjese e materialeve nuk funksionojnë për shkak te kalimit te kohës se amortizimit dhe zëvendësimit me lloje dhe tipe te reja”.

Gjithashtu ne relacion komisioni “propozon nxjerrjen jashtë përdorimit të 56 lloje artikujsh me vlerë totale 10,786,469.6 lekë (sipas listës bashkëngjitur) nga të cilat AQT me vlerë 10,368,270,9 lekë AQ me vlerë 418,198.7 lekë

Listat e artikujve të propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit janë nënshkruar rregullisht nga komisioni dhe personat përgjegjës.

- Me datën 21.12.2023 është hartuar relacioni për vlerësimin e aktiveve.

Sipas këtij relacioni nga komisioni i ngritur për këtë detyre janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi 48 artikuj AQT me vlerë 10,368,270.9 lekë dhe 8 artikuj AQ me vlerë 418,198.7 lekë. Bashkëngjitur relacionit është lista e plotë me artikujt e vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit, dhe këto dokumenta janë hartuar në përputhje me Udhëzimin 30.

- Me datën 27.12.2023 është hartuar nga “Komisioni i asgjësimit të pajisjeve dhe materialeve te INSTAT dhe zyrave rajonale” procesverbali në të cilin specifikohen artikujt sipas listës së dorëzuar nga komisioni se janë asgjësuar përmes copëtimit dhe deformimit dhe janë dërguar ne vendin e grumbullimit te mbetjeve.

- Me datën 29.12.2023 është urdhëruar kontabilizimin e rezultateve të inventarizimit.

Referencat e vëna në këto urdhra administrative mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi, janë dispozita në fuqi, përkatësisht me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar përgjithësisht kane gjetur zbatim.

Konstatime për procesin e inventarizimit të aktiveve materiale:

- Në lidhje me procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve të njësisë, pas auditimit të dokumentacionit justifikues të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit u

konstatua: gjurmë jo e plotë e auditit përsa i përket procesit të asgjësimit, në dosje ishin prezente foto të materialeve të cilat do të asgjësoheshin, përpara procesit por jo evidence gjatë dhe pas tij. Në procesverbal specifikohet se mënyra e kryerjes së asgjësimit ishte nëpërmjet copëtimit në pjesë të vogla, deformimit dhe kthimit në gjendje të paidentifikueshme por mungonin provat justifikuese sikundër e kërkon pika 122 e Udhëzimit 30 datë 27.12.2011. Rezultoi se, materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë. Po ashtu nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive.

- Gjate procedurës së inventarizimit të aktiveve afatshkurtra “Inventar qarkullues” dhe “Inventar i imët” komisioni i inventarizimit dhe komisioni i vlerësimit nuk është shprehur lidhur me mallrat gjendje të cilët kane një kohe të gjatë në magazine në zbatim të paragrafit 103 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Konstatohet se vlera e mallrave me mbi 10 vite gjendje në magazine kap shifrën 4,483,006 lekë. Duke mos u realizuar ky vlerësim nuk na jepet një pasqyre e sakte vlerës se magazinës rrjedhimisht të fondeve neto të Instat.

- Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 103, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, që sanksionon se, Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në këtë paragraf.

Magazina qendrore

Magazina qendrore është e ndarë në dy ambiente, të cilat ndodhen brenda institucionit të INSTAT. Grupi i auditimit përzgjedhi artikujt me vlera më të larta nga ku u konstatua se gjendja kontabël përputhej me gjendjen fizike në datën e kryerjes së inventarit, sipas tabelës mëposhtë:

Kartela	Përshkrimi	Njesia	Llogari inventar	Data hyrjes	Gjendja	Kosto	Vlefita
120/1	Toner dell-5330 (16005.36)	cope	3120001	14.06.2016	79	16,005	1,264,423
23/85	Toner (36760.5)	cope	3120001	31.12.2012	21	36,761	771,971
30/12	Toner Dell 5330 (26147.53)	cope	3120003	31.12.2010	28	26,148	732,131
70/2	Toner Konica (9000)	cope	3120001	10.12.2019	75	9,000	675,000
23/11	Toner Konica 220 Color (11392.8)	cope	3120001	31.12.2010	53	11,393	603,818
428/5	Gazoil (Nafte) (211.62)	liter	3122001	05.10.2023	2,260	212	478,261
369/1	Toner Rich Pro C-900 col (31301.1)	cope	3120001	26.07.2016	15	31,301	469,516
167/3	Toner Rich-Pro C-900 col (33120)	cope	3120001	18.09.2017	12	33,120	397,440
091/10	Toner HP 5500 Color (38410.836)	cope	3120001	31.12.2010	9	38,411	345,698
091/9	Toner HP 5500 Black (28487.256)	cope	3120001	31.12.2011	10	28,487	284,873
23/114	Toner konica (12391)	cope	3120001	06.01.2013	21	12,391	260,211
369	Toner Rich Pro C-900 col (25825.26)	cope	3120001	31.12.2010	9	25,825	232,427
23/16	Toner HP LaserJetM9050 (43731.69)	cope	3120001	31.12.2010	5	43,732	218,658
280/11	Toner Xerox col (13420.8)	cope	3120001	23.02.2021	15	13,421	201,312
145/15	Zarfa 26x36 (18.084)	cope	3120001	20.10.2023	10,000	18	180,840
019	Neone (ndricues) (4800)	cope	3120009	26.06.2019	36	4,800	172,800
31/7	Toner Xerox B1022 (5229.6)	cope	3120001	15.03.2022	33	5,230	172,577
23/10	Toner Konica 220 Black (6166.4)	cope	3120001	03.01.2013	27	6,166	166,493
167/2	Toner Rich-Pro C-900 blc (22370.4)	cope	3120001	18.09.2017	7	22,370	156,593

Burimi: INSTAT /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i magazinës u konstatua se:

- 1-Procesi i hyrje-daljeve nga magazina mbahet me libër magazine manualisht, dhe jo me sistemin Alpha Web, të cilin INSTAT përdor për mbajtjet e kontabilitetit të njësisë;
- 2- Dalja e inventarit nga magazina bëhet në fund të muajit, dhe jo për çdo kërkesë për tërheqje malli;

3-Çdo vit bëhet mbartje e gjendjes së vitit paraardhës të inventarit qarkullues, duke hapur një libër të ri magazine, dhe rrjedhimisht sjell vështirësi në identifikimin e vjetërsisë së artikullit në magazinë, me qëllim menaxhimin më efektiv të magazinës;

4- Artikuj të njëjtë të inventarit janë mbajtur në kartela të ndryshme, duke sjellë vështirësi në menaxhimin me efektivitet të magazinës.

Nga verifikimi i datës 30.05.2024, FH dhe FD e fundit janë: FH nr.1 datë 14.02.2024 dhe FD nr.93 datë 29.03.2024. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 37 ku citohet: *“Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)”*.

Komisioni i inventarizimit

Nga grupi i auditimit u konstatua se për vitin 2022 dhe 2023, Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe anëtarë janë specialistët e Sektorit të Financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MF, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se “Komisioni nuk duhet te jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet te kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/ përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi ...” si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22 “veprimtaria e kontrollit” pika 3/ b “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.654/19 prot., datë 02.09.2024, protokolluar në KLSH me nr. 505/5, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

Spektori i financës ka kryer sistemimet perkatese kontabel për pagesat e Qarave duke prekur llogarinë 467 "Kreditore të ndryshëm".

Ne vendimet e gjykatave në vazhdimësi sektori i financës do te marrim masa për klasifikimin e shpenzimeve ne forme page 600 "Shpenzime per personelin" apo ne forme shpenzimi 6027 "Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore".

Spektori i Financës, në vijimësi, do te marre masat përkatëse për sistemimin e regjistrit te Aktiveve, për klasifikimin e aseteve sipas klasave përkatëse, llogaritjen e amortizimit sipas normave përkatëse dhe sistemimet ne programin Alpha Web, në zbatim të udhëzimit të Ministrisë se Financave me nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarde te zbatimit te buxhetit".

Spektori i Financës ka kryer sistemimet përkatëse në programin Alpa Web për detyrimet afatshkurtra konkretisht në llogarinë 437, 438 "Organizma të tjerë shtetërore", në llogarinë 435 "Sigurime shoqërore" dhe në llogarinë 436 "Sigurime shëndetësore".

Spektori i Financës do të kryeje sistemimet kontabël ne pasqyrat financiare për një pasqyrim sa më të drejte të fondit neto për parandalimin e parregullsive te mundshme ne interpretimin e llogarive vjetore.

Spektori i financës do të marrë masa për të pasqyruar sakte shpenzimet e kryera sipas rregullave kontabël ne pasqyrat financiare në vijimësi për te ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve

sipas zërave përkatës.

Nga Sektori i Financës do të merren masa për njohjen e detyrimeve në kontabilitet dhe pasqyrimin e plote, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara

Në vijimësi Sektori i Financës do të beje regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, me qëllim parandalimin e gabimeve dhe parregullsive të mundshme.

Në vijimësi, komisioni i inventarizimit do të marrë masa që për artikujt e aktiveve afatshkurtra "Inventar qarkullues" dhe "Inventar i imët", me një kohe të gjatë në magazinë t'i vlerësojnë si materiale për jashtë përdorimi, duke u bazuar në elemente si vjetërsia, data e skadencës, funksioni që kryen etj.

-Në zbatim të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 çdo hyrje-dalje në magazine dokumentohet menjëherë. Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat një kopje origjinale për fletëhyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit), si dhe fletëdaljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre. Specialisti i financës kryhen veprimet e regjistrimit dhe kontabilizimi të dokumenteve të hyrjeve dhe daljeve në programin financiar Alpha web, sipas veprime që kryhen në magazinë. Dalja e aktiveve nga magazina behet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e trajtuara më sipër, nga subjekti i audituar janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna të cilat janë pranuar, dhe nga institucioni i INSTAT do të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre.

Në lidhje me komentin tuaj mbi hyrje/daljen e mallrave në magazinë, nga ana e grupit të auditimit, bazuar dhe në verifikimin e kryer në vend të mbajtur me anë të aktverifikimit nr.1 datë 30.05.2024 është konstatuar se hyrje daljet e mallrave në magazine bëheshin një here në muaj ndërsa për artikujt të veçantë edhe më rrallë siç është rasti i artikullit "Naftë" i cili kishte mbi tre muaj që nuk kontabilizoheshin daljet. Gjithashtu, konstatohet se nuk janë kuadruar vlerat e daljeve specialistit të financës dhe magazinierit. Për rrjedhojë, observacioni nuk merret në konsideratë.

2.4 Prokurimet e fondeve publike.

I. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga INSTAT, në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Argumentimin dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Autoriteti Kontraktor ka krijuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimin e APP-së, brenda afateve ligjore, të përcaktuara në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" të VKM-së nr. 914, datë

29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP <https://www.app.gov.al>.

Për periudhën objekt auditimi, INSTAT, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK) ka kryer prokurime me procedurë:

- “Blerje me vlerë të vogël” për vitin 2021, në vlerën prej 2,026,587 lekë pa TVSH;
- “Blerje me vlerë të vogël” për vitin 2022, në vlerën prej 4,189,198 lekë pa TVSH, ku “Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” zë vlerën 1,351,307 lekë;
- “Blerje me vlerë të vogël” për vitin 2023, në vlerën prej 2,163,700 lekë pa TVSH, ku “Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” zë vlerën 1,607,671 lekë.
- Regjistri i parashikimit për vitin 2021 është dërguar me shkresën nr. 139, datë 29.01.2021;
- Regjistri i parashikimit për vitin 2022 është dërguar me shkresën nr. 129, datë 25.01.2022;
- Regjistri i parashikimit për vitin 2023 është dërguar me shkresën nr. 161 datë 02.02.2023.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për të audituar procedurat për blerje mallra/ shërbime, si më poshtë:

Periudha	Numri i procedurave të realizuara	Procedurat e zgjedhura	Vlera e kontratës pa TVSH
2021	12	12	2,026,587 lekë
2022	13	13	4,189,198 lekë
2023	10	10	2,163,700 lekë
Totali	35	35	8,379,485 lekë

Për vitin 2021, 2022 dhe 2023 grupi i auditimit ka përzgjedhur për të audituar procedurat si vijon, me objekt:

Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Shërbim larje automjetesh	Shërbim gjelbërimi	Shërbim monitorimi mediatik
Hostim i faqes së aplikacionit për Sistemin WebGis	Shërbim hostimi i faqes së aplikacionit WebGis	Shërbim riparim i sistemit të kondicionimit /Chiller
Abonimi në Programin Financiar në Web, në platformën Cloud	Shërbim mirëmbajtje licensash	Blerë material higjeno-sanitare
Shërbim Gjelbërimi	Blerë materiale elektrike dhe hidraulike	Shërbim hostimi i faqes së aplikacionit(Sistemi WebGis)
Shërbim riparim automjetesh	Blerë materiale higjeno-sanitare	Shërbim profilaktik dhe riparim automjete
Shpenzime pritje përcjellje	Shërbim mirëmbajtje kondicioneri	Shërbim riparim i kondicionerit
Pagesë siguracion i detyrueshëm TPL&Kasko për automjetet e INSTAT	Shërbim larje automjetesh	Abonim në Programin Financiar Alpha, platforma Cloud
Materiale dezinfektimi Covid-19	Shpenzime pritje-përcjellje	Shërbim sigurie i pasurisë nga zjarri, tërmeti etj.
Shërbim monitorimi mediatik	Siguracion TPL dhe KASKO për automjetet	Pagesë siguracion i detyrueshëm TPL&Kasko për automjetet e INSTAT
Shërbim riparim i dy chillerave të INSTAT	Siguracion për ndërtesën	Shërbim larje automjetesh
Shërbim riparim i kondicionerit qendror	Shërbim monitorimi mediatik	
Shërbim profilaktik dhe riparim automjetesh	Blerje goma dhe bateri automjete	
	Abonim në Programin Financiar Alpha, platforma Cloud	

Nga auditimi u konstatua se:

PËR VITIN 2021

1. Për procedurën “Shërbim larje automjetesh”

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 01, datë 12.02.2021 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **193,533 lekë pa TVSh** me objektin “Shërbim larje automjetesh.”

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentet e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se ne dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

Nga ana e Sektorit të Shërbimeve është bërë kërkesa me anë të shkresës të cilës i mungon nr. i protokollit, datë 08.02.2021 për blerjet me vlerë të vogël me objekt “Shërbim larje automjetesh”, sipas preventivit bashkëngjitur kërkesës.

“Si rregull, autoriteti kontraktor do të verifikojë në QKR nëse operatori ekonomik ofertues ka në objektin e ushtrimit të veprimtarisë së tij edhe objektin që po prokurohet”.

Nga verifikimi i procesverbalit të datës 09.02.2021 i cili nuk është protokolluar, rezulton se Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga Z. A.d, Z. A.B dhe Z. K.M, ka studiuar tregun duke përfshirë në studim operatorin ekonomik “J.B” e cila në atë datë në bazë të verifikimeve të bëra në Regjistrin tregtar të QKB nuk e ka pasur pjesë të veprimtarisë së saj, ofrimin e shërbimit të larjes së automjeteve(lavazh) duke krijuar pasiguri për audituesit për vlerën reale të objektit të prokurimit. Në datën 10.02.2021 subjekti ka shtuar si pjesë të aktivitetit të tij ofrimin e shërbimit të larjes së automjeteve. INSTAT ka publikuar ftesën për ofertë me afatin për dorëzim ofertash datën 16.02.2021. Konstatohet se ftesa për ofertë nuk ka as nr. protokollit dhe as datë.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, , ka mbajtur procesverbalin e datës 18.02.2021 ku ka vlerësuar ofertat e paraqitura për këtë procedurë. Nga 7 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 2 OE për arsye se oferta e tyre ishte mbi fondin limit. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 104,200 lekë paraqitur nga subjekti “J.B”. Autoriteti Kontraktor (INSTAT) ka nënshkruar me OE fitues kontratën nr. 259 Prot., datë 22.02.2021 me vlerën 104,200 lekë pa tvsh.

Subjekti i përzgjedhur si fitues ka autorizuar një subjekt tjetër për ofrimin e shërbimit të kërkuar “V.K” me kontratë shërbimi të lidhur në datën 15.01.2021. Në kontratë nuk është parashikuar vlera monetare për shërbimin e kryer në mënyrë që të përcaktohet nëse jemi në kundërshtim me nenin 126 pika 2 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se “Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim nuk mund të tejkalojë 50 % të vlerës së përgjithshme të kontratës”.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimit nr. 360, datë 17.05.2021 në vlerën 43,800 lekë, urdhër shpenzimit nr. 1351, datë 29.12.2021 në vlerën 33,600 lekë, urdhër shpenzimi nr. 1181 datë 03.12.2021 në vlerën 26,640 lekë .

2. Për procedurën “Abonimi në Programin Financiar në Web, në platformën Cloud”

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 13, datë 09.08.2021 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **98,206 lekë pa TVSh** me objektin “Abonim në Programin Financiar në Web, në platformën Cloud”.

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Projekteve është bërë kërkesa me anë të shkresës së paprotokolluar , datë 21.07.2021 për blerjet me vlerë të vogël me objekt “Abonimi në Programin Financiar në Web, në platformën Cloud”.

Kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomik ku asnjëri nuk është skualifikuar. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 98,200 lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentat e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se ne dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

- Nga ana e operatorit ekonomik nuk është plotësuar Deklarata Mbi Konfliktin e Interesit si dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqësore bazuar në pikën 16 të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimin nr. 888, datë 29.09.2021 në vlerën 117,840 lekë .

3 . Për procedurën “Shërbim Gjelbërimi”;

Me Urdhrin e Prokurimit nr.7, datë 17.05.2021, është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **387,633 lekë pa TVSh** me objekt “Shërbim Gjelbërimi”

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentat e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se ne dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në ftesën për ofertë nga ana e Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël të përbërë nga Z. A.B, Z. K.M dhe Z. A.D është vendosur kushti që OE duhet të paraqesë një dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës, të paktën në vlerën sa 40% të fondit limit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se fondi limit për këtë procedurë prokurimi është 387,633 lekë pa tvsh , ndërsa vlera e kontratës së paraqitur nga OE si provë për eksperiencën e mëparshme është 97,990 lekë pa tvsh pra nuk përmbush kriterin e 40 % , çka bie në kundërshtim me kriteret e përgjithshme për kualifikim të përcaktuara në ftesën për ofertë në bazë të nenit 80 pika 1 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se oferta fituese duhet të përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimin nr. 589 datë 09.07.2021 në vlerën 391,999 lekë.

PËR VITIN 2022

1. Për procedurën “Shërbim gjelbërimi”

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 01, datë 22.11.2022 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **99.000 lekë pa TVSh** me objektin “Shërbim gjelbërimi.”

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentat e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se ne dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit . në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Nga ana e Sektorit të Shërbimeve është bërë kërkesa me anë të shkresës nr. 1678 prot., , datë 26.09.2022 për blerjet me vlerë të vogël me objekt “Shërbim gjelbërimi”, sipas preventivit bashkëngjitur kërkesës.

Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion kërkesa për miratimin e prokurimit me vlerë të vogël dhe ftesa për ofertë.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël,(Z. E.T, Z. A.B, Z. D.K), ka mbajtur procesverbalin e datës 30.11.2022 ku ka vlerësuar ofertat e paraqitura për këtë procedurë. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 92,700 lekë. Gjithashtu konstatohet se nuk janë pjesë e dosjes Deklarata mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike, Deklarata mbi Konfliktin e Interesit si dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik bazuar në pikën 16 të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” .

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimin nr. 1200, datë 22.12.2022 në vlerën 111,240 lekë .

2. Për procedurën “Hostim i faqes së aplikacionit për Sistemin WebGis”

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 9, datë 31.05.2022 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **299,522 lekë pa TVSh** me objekt “Hostimi i faqes së aplikacionit për Sistemin WebGis.”

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentet e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se ne dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit . në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të shkresës të cilës i mungon nr. i protokollit dhe data, INSTAT ka publikuar ftesën për ofertë, ku afati për dorëzimin e ofertave është data 01.06.2022.

Nga verifikimi i procesverbalit të datës 26.05.2022, konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël i përbërë nga Z. A.D, Z. A.B dhe Z. D.K ka reflektuar kryerjen e përlogaritjes së fondit limit, pasi ka vendosur të bëjë studim tregu.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur nga Titullari i INSTAT me Urdhrin nr. 2, datë 07.01.2022, ka mbajtur procesverbalin e datës 08.06.2022 ku ka vlerësuar ofertat e paraqitura për këtë procedurë. Nga 12 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 9 OE për arsye se oferta e tyre ishte mbi fondin limit dhe 1 OE për arsye se objekti i prokurimit nuk është i pasqyruar në objektin e veprimtarisë, në ekstraktin e shoqërisë të lëshuar nga QKB. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 249,000 lekë.

Faza e lidhjes së kontratës

Me anë të shkresës nr.757/1 Prot., datë 14.06.2022 është lidhur kontrata e shërbimit midis palëve kontraktuese INSTAT(autoriteti kontraktor) dhe A.A shpk. (kontraktuesi) për “*Hostimi i faqes së aplikacionit për sistemin WebGis*”.

Nga auditimi i dosjes së prokurimit u konstatua se në ftesën për ofertë, AK ka kërkuar kritere për operatorët ekonomikë, si vijon:

- Objekti i prokurimit, duhet të jetë i pasqyruar në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga QKB.

- Operatori ekonomik duhet të ketë kryer të paktën 1(një) shërbim të ngjashëm hostimi faqesh Web. Për të vërtetuar eksperiencën e ngjashme me institucionet publike duhet të paraqesin kontratën dhe vërtetimin e realizimit ose faturën tatimore. Për shërbimet e kryera në sektorin privat duhet të paraqesin vetëm faturat tatimore përkatëse.

-Kontrata midis INSTAT si AK dhe kontraktorit është lidhur me datë 14.06.2022 .

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur pranë AK, Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas shtojcës 6 dhe Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore sipas shtojcës 8 bazuar në pikën 16 të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdher shpenzimin nr. 596, datë 13.07.2022 në vlerën 298,800 lekë.

3. Për procedurën “Shërbim larje për automjete për vitin 2022 ”

Me Urdhërin e Prokurimit nr.8, datë 04.05.2022 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **203.733 lekë pa TVSh** me objektin “*Shërbim larje për automjete për vitin 2022*”

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentat e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se ne dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit . në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Nga ana e Sektorit të Shërbimeve është bërë kërkesa me anë të shkresës të cilës i mungon nr. i protokollit, datë 13.04.2022 për blerjet me vlerë të vogël me objekt “*Shërbimin larje automjetesh*”, ku janë parashikuar dhe specifikimet teknike që duhet të plotësoj OE ku parashikohet që operatori ofertues duhet të ketë Leje Mjedisi të tipit C për:Larje dhe pastrim automjete motorike.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga Z. A.B, Z. A.D dhe Z. D.K ka bërë argumentimin e fondit limit duke bërë studimin e tregut, ka publikuar ftesën për ofertë ku ka parashikuar se data e zhvillimit të procedurës do të jetë 09.05.2022 si dhe ka parashikuar kushtet që duhet të plotësoj OE i cili duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi të tipit C kriter i cili nuk është i argumentuar pasi konstatohet se INSTAT ka në pronësi 4 automjete për të cilat nuk është e domosdoshme pajisja me leje mjedisore tipi C bazuar në nenin 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet :-Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësitë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. ***Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.***

4. Për procedurën “Blerë goma dhe bateri për automjete ”

Me Urdhërin e Prokurimit nr.13, datë 05.07.2022 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **227,117 lekë pa TVSh** me objektin “*Blerë goma dhe bateri për automjete*”.

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (Z. A.B, Z. D.K, Z. E.T).

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentat e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se në dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit të anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes Përshkrimi i Ofertës i plotësuar, Deklarata mbi Përbushjen e Specifikimeve Teknike, Deklarata mbi Konfliktin e Interesit si dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik bazuar në pikën 16 të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimit nr. 745 datë 18.08.2022 në vlerën 43,200 lekë.

5. Për procedurën “Shërbim profilaktik dhe riparim automjete ”

Me Urdhërin e Prokurimit nr.12, datë 04.07.2022 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **243,567 lekë pa TVSh** me objektin “*Shërbim profilaktik dhe riparim automjete*”.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentat e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se në dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit të anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

- Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes Përshkrimi i Ofertës i plotësuar, Deklarata mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike, Deklarata mbi Konfliktin e Interesit si dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik bazuar në pikën 16 të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (Z. A.B, Z. D.K, Z. E.T).

Në kriteret e përgjithshme për kualifikim parashikohet se OE duhet të lëshojë deklaratë se pjesët e këmbimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve do të jenë të reja dhe origjinale sipas standardeve të CE si dhe deklaratë garancie për pjesët e këmbimit, jo më pak se një vit nga data e montimit. Të dyja deklaratat nuk janë pjesë e dosjes. Gjithashtu te kriteret parashikohet se OE duhet të ketë drejtues teknik të licencuar por ne dosje nuk ka kopje licence që e vërteton përmbushjen e kriterit të kërkuar.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimin nr. 744 datë 18.08.2022 në vlerën 204,000 lekë.

6. Për procedurën “Abonim në Programin Financiar në Web, platforma Cloud ”

Me Urdhërin e Prokurimit nr.11, datë 27.06.2022 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **98,204 lekë pa TVSh** me objektin “Abonim në Programin Financiar në Web,platforma Cloud”.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentat e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se ne dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit në kundërshtim me nenin 73, pika 4 VKM 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes Përshkrimi i Ofertës i plotësuar, Deklarata mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike, Deklarata mbi Konfliktin e Interesit si dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik bazuar në pikën 16 të Udhëzimit Nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (Z. A.B, Z. E.T, Z. D.K).

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimin nr. 640 datë 28.07.2022 në vlerën 117,840 lekë.

PËR VITIN 2023

1. Për procedurën “Shërbim larje automjete”

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 34, datë 16.03.2023 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **180.000 lekë pa TVSh** me objektin “Shërbim larje automjeti”

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Është konstatuar se dokumentat e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Është konstatuar se ne dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit.

Është konstatuar se te specifikimet teknike që duhet të plotësoj OE është përcaktuar se duhet të këtë Leje Mjedisi të tipit C, kriter i cili nuk është i argumentuar pasi konstatohet se INSTAT ka në pronësi 4 automjete për të cilat nuk është e domosdoshme pajisja me leje mjedisore tipi C bazuar ne nenin 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet :-Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësitë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. ***Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.***

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, , ka mbajtur procesverbalin e datës 24.03.2023 ku ka vlerësuar ofertat e paraqitura për këtë procedurë. Nga 13 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 6 OE për arsye se oferta e tyre ishte mbi fondin limit. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 176,000 lekë paraqitur nga subjekti “Xh.Gj”. Autoriteti Kontraktor (INSTAT) ka nënshkruar me OE fitues kontratën nr. 555/1 Prot., datë 13.04.2023 me vlerën 176,000 lekë pa tvsh.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimin nr. 851 datë 25.08.2023 në vlerën 49,440 lekë.

2. Për procedurën “Hostim i faqes së aplikacionit për Sistemin WebGis”

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 52, datë 23.05.2023 është miratuar procedura e prokurimit me fond limit **275,855.5 lekë pa TVSh** me objekt “*Hostimi i faqes së aplikacionit për Sistemin WebGis.*” *Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:*

- Dokumentet e procedurës së prokurimit nuk janë protokolluar sipas ligjit nr. 9154 ,datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- Në dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit te anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël. Mungesa e plotësimit të deklaratave nuk i jep siguri AK për personat e përfshirë në procedurën e prokurimit.

Nga verifikimi i procesverbalit të datës 16.05.2023, konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël ka reflektuar kryerjen e përlllogaritjes së fondit limit, pasi ka vendosur të bëjë studim tregu.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur nga Titullari i INSTAT me Urdhërin nr. 34, datë 16.03.2023 i përbërë nga Z. A.B, Z. B.K dhe Z. A.D, ka mbajtur procesverbalin e datës 16.05.2023 ku ka vlerësuar ofertat e paraqitura për këtë procedurë. Nga 9 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 7 OE për arsye se oferta e tyre ishte mbi fondin. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 249,000 lekë i cili është kualifikuar i 2-ti ndërkohë që OE i shpallur i pari me ofertën ekonomike 166,667 lekë , futet tek ofertat e refuzuara me arsyetimin se *oferta ekonomike ishte më e vogël se objekti i kontratës.* Eshtë bërë kalimi dhe nënshkrimi i kontratës me OE i shpallur i dyti pa paraqitur OE i shpallur i pari tërheqjen nga oferta në

kundërshtim me pikën 17. Të Udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018 ku përcaktohet se”Kur ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor të përcaktuar në “Ftesën për Ofertë”, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në “Ftesën për Ofertë”, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim”.Nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël nuk është dokumentuar asnjë veprim në lidhje me kalimin tek operatori ekonomik i radhës.

Faza e lidhjes së kontratës

Me anë të shkresës nr.795/2 Prot., datë 13.06.2023 është lidhur kontrata e shërbimit midis palëve kontraktuese INSTAT(autoriteti kontraktor) dhe A.A shpk. (kontraktuesi) për “*Hostimi i faqes së aplikacionit për sistemin WebGis*”.

Nga auditimi i dosjes së prokurimit u konstatua se në ftesën për ofertë, AK ka kërkuar kritere për operatorët ekonomikë, si vijon:

- Objekti i prokurimit , duhet të jetë i pasqyruar në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë , lëshuar nga QKB.
- Operatori ekonomik duhet të ketë kryer të paktën 1(një) shërbim të ngjashëm hostimi faqesh Web. Për të vërtetuar eksperiencën e ngjashme me institucionet publike duhet të paraqesi kontratën dhe vërtetimin e realizimit ose faturën tatimore. Për shërbimet e kryera në sektorin privat duhet të paraqesi vetëm faturat tatimore përkatëse.

-kontrata midis INSTAT si AK dhe kontraktorit është lidhur me datë 13.06.2023 .

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimit nr. 639, datë 14.07.2023 në vlerën 298,800 lekë.

Për procedurën” Shërbimi i monitorimit mediatik”

Bazuar në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve për vitin 2021 për INSTAT është parashikuar realizimi i procedurës së prokurimit për “Shërbimin e monitorimit mediatik”.

Më datë 10.02.2021(e paprotokolluar) është bërë kërkesa për Shërbimin e Monitorimit Mediatik me argumentimin :Për kryerjen e detyrave dhe përmbushjes së përshkrimit të punës për monitorimin e përditshëm mediatik. Kërkesa është bërë nga Sektori i Publikimeve dhe Marketingut -Përgjegjësi i Sektorit (Znj. J.R) dhe është aprovuar nga Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve Z. A.XH. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël i përbërë nga Z. A.B, Z. A.D dhe Z. K.M mbi bazën e kërkesës dhe specifikimeve teknike të paraqitur nga Sektori i Publikimeve ka bërë argumentimin e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit.

Pasi është bërë studimi i tregut , komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka propozuar që fondi limit për realizimin e kësaj procedure prokurimi të jetë 690,364 lekë pa TVSH. Kërkesa për miratimin e prokurimit me vlerë të vogël është miratuar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT. Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit Nr. 3, datë 17.02.2021 për realizimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël për Shërbimin e Monitorimit Mediatik për INSTAT , për vitin 2021. Në ftesën për ofertë të realizuar nga autoriteti kontraktor (INSTAT) është parashikuar zhvillimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbimin e monitorimit mediatik” në datë 18.02.2021. Operatori ekonomik i renditur i pari është “B.I.S.S” me ofertën 458.900 lekë pa TVSH. Me nr. 385 Prot. datë 10.03.2021 është nënshkruar kontrata për realizimin e këtij shërbimi midis INSTAT dhe B.I.S.S sh.p.k. Konstatohet se në dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Nëpërmjet komunikimeve elektronike midis Përgjegjësit të Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun , Znj. M.L dhe OE fitues konstatohet se sipas Instat, OE nuk po përmbush kushtet e kontratës. Me shkresën (fotokopje)Nr. 385/1 Prot., datë 19.07.2021 Instat ka njoftuar OE për zgjidhjen e kontratës bazuar në nenin 7”Zgjidhja e kontratës”, pika 7.2 ii) Kontraktuesi, në mënyrë të vazhdueshme, nuk kryen të gjitha shërbimet e kërkuara për të cilat është rënë dakord me Autoritetin Kontraktor, ose nuk i kryen shërbimet me cilësinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, bazuar në “Shtojcën 1” bashkëngjitur kësaj kontrate”.Konstatohet se në dosje kemi dublikatë dokumentacioni.

Bazuar në Regjistrin e Parashikimit të prokurimeve për vitin 2022 për INSTAT është parashikuar realizimi i procedurës së prokurimit për”Shërbimin e monitorimit mediatik”.

Më datën 24.01.2022 (mungon nr. i protokollit”) është bërë kërkesa për Shërbimin e Monitorimit Mediatik me argumentimin :Për kryerjen e detyrave dhe përmbushjes së përshkrimit të punës për monitorimin e përditshëm mediatik. Kërkesa është bërë nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun-Përgjegjësi i Sektorit (Znj. M.L) dhe është aprovuar nga Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve Z. A.XH. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël i përbërë nga Z. A.B, Z. A.D dhe Z. D.K mbi bazën e kërkesës dhe specifikimeve teknike të paraqitur nga Sektori i Publikimeve ka bërë argumentimin e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit.

Pasi është bërë studimi i tregut , komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka propozuar që fondi limit për realizimin e kësaj procedure prokurimi të jetë 736.000 lekë pa tvsh. Kërkesa për miratimin e prokurimit me vlerë të vogël është miratuar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT. Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit Nr. 1, datë 10.02.2022 për realizimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël për Shërbimin e Monitorimit Mediatik për INSTAT , për vitin 2022. Në ftesën për ofertë të realizuar nga autoriteti kontraktor (INSTAT) është parashikuar zhvillimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbimin e monitorimit mediatik” në datë 22.02.2022. Operatori ekonomik i renditur i pari është “M.P” me ofertën 727,000 lekë pa tvsh. Me nr. 418 datë 11.03.2022 është nënshkruar kontrata për realizimin e këtij shërbimi midis INSTAT dhe M.I sh.p.k.. Në dokumentacionin e venë në dispozicion nga INSTAT për realizimin e kësaj procedure rezulton se OE nuk ka paraqitur 2 dëshmi për shërbime të mëparshme të realizuar nga ana e tij(kërkesë kjo e parashikuar në kriteret e përgjithshme për kualifikim) bazuar Udhëzimit nr. 3 , datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 16 ku përcaktohet “Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues , në Zyrën e Protokollit të autoritetit kontraktor”. Gjithashtu konstatohet se nuk janë pjesë e dosjes Deklarata mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike, Deklarata mbi Konfliktin e Interesit si dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik. Nga auditimi i dosjes së prokurimit u konstatua se në ftesën për ofertë, AK ka kërkuar kritere për operatorët ekonomikë, si vijon:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë 2(dy) dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme , të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës, në vlerën 40 % të fondit limit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik do të pranohen vërtetime të lëshuara nga enti publik ose/edhe faturat tatimore të shitjes, ku t shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, si dhe demonstrimin e një programi për monitorimin e medias. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, si edhe demonstrimin e një programi për monitorimin e radhës.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur pranë AK vërtetim ose faturë tatimore shitjeje që të vërtetoje eksperiencat e mëparshme.

Gjatë vitit 2023 bazuar në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike , është kërkuar hapja e procedurave për Shërbimin e Monitorimit Mediatik, bazuar në buxhetin e miratuar të vitit 2023. Fondi total i aprovuar për këtë zë është 799.000 lekë me t.v.sh. Kërkesa me nr. 440 prot. e datës 06/03/2023 është bërë nga Specialisti i Marrëdhënieve me Publikun , Z. E.A si dhe është aprovuar nga Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve, nga drejtori Z. A.Xh. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël i përbërë nga Z. A.D, Z. A.B dhe Z. B.K pasi ka bërë studimin e tregut ka propozuar që fondi limit për realizimin e kësaj procedure të jetë 72,167 lekë në muaj, pa tvsh. Autoriteti Kontraktor, INSTAT ka publikuar ftesën për ofertë ku ka parashikuar se procedura e prokurimit do të realizohet në datë 06.04.2023. Në fund të procesit të vlerësimit të OE rezultoi fitues operatori M.I shpk me ofertën 600,000 lekë pa tvsh.

Gjithashtu konstatohet se Deklarata mbi Përmeshjen e Specifikimeve Teknike, Deklarata mbi Konfliktin e Interesit si dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik në dosje janë fotokopje. Nga auditimi i dosjes së prokurimit u konstatua se në ftesën për ofertë, AK ka kërkuar kriteret për operatorët ekonomikë, si vijon:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë 2(dy) dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme , të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës, në vlerën 40 % të fondit limit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik do të pranohen vërtetime të lëshuara nga enti publik ose/edhe faturat tatimore të shitjes, ku t shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, si dhe demonstrimin e një programi për monitorimin e medias. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, si edhe demonstrimin e një programi për monitorimin e radhës. Në dosje vërtetimet e lëshuara nga entet publike ku OE ka realizuar shërbimin konstatohet se janë fotokopje, edhe dokumentet e noterizuara janë fotokopje. Kontrata është nënshkruar në datë 07.04.2023.

Konstatohet se në strukturën e INSTAT kemi Drejtorinë e Komunikimit dhe Publikimeve e cila ka në varësi Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun ku kemi si pozicion pune Specialistin për Monitorimin dhe Raportimin Mediatik. Specialisti i monitorimit media sipas përshtimit të punës ka për detyrë të monitorojë përditë ose disa herë në ditë mediat e ndryshme të shkruara, audiovizive apo faqe interneti. Detyrat kryesore të tij janë :

- Të mbulojë procesin e raportimit mediatik.
- Të gjenerojë raporte ditore, 6- mujore dhe vjetore.
- Të analizojë publikimet dhe artikujt në median vizive dhe atë të shkruar.
- Të përgatisë raporte mediatike ditore për Drejtorinë e Përgjithshëm të INSTAT.
- Të menaxhojë adresën media@instat.gov.al dhe shpërndaj produktet statistikore tek grupet e përdoruesve.
- Është pikë kontakti për European Statistical System , për dërgimin e informacioneve dhe publikimeve më të fundit të INSTAT në këtë portal.

Është e specifikuar tek detyrat teknike të tij monitorimi i gazetave të përditshme, monitorimi i revistave të përjavshme si dhe monitorimi i faqeve kryesore të internetit.

Përgjegjësi i Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun ka për detyrë sipas përshtimit të pozicionit të punës të mbulojë procesin e raportimit mediatik, gjenerimin e raporteve ditore, 6-mujore dhe vjetore. Një ndër detyrat kryesore të tij është organizimi, drejtimi dhe kontrolli i të gjithë aktivitetit të Sektorit.

Nga ana e INSTAT është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël për “Shërbimin e monitorimit mediatik” për vitin 2021 me vlerën 458.900 lekë(anulluar) për vitin 2022 me vlerën 733,323 lekë me tvsh dhe 2023 me vlerën totale 720.000 lekë me tvsh i cili .Në bazë të kontratës së nënshkruar me OE rezultoi se ai do të marr përsipër të ndërtoj arkiven elektronike të çdo lajmi në mediat e monitoruara. Është nënshkruar kontrata për tre vite të njëpasnjëshme për realizimin e një shërbimi i cili në bazë të Rregullores së Brendshme të INSTAT dhe përshkrimeve të pozicioneve të punës ka një pozicion specifik të parashikuar në strukturën e institucionit Specialisti për Monitorimin dhe Raportimin Mediatik i cili ka detyrë funksionale realizimin e shërbimit për të cilin është pajtuar OE. Planifikimi dhe realizimi i këtyre shpenzimeve është bërë pa efektivitet.

Urdhër shpenzimet mbi blerjet nën 100 mijë lekë

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për vitin 2021; 2022 dhe 2023 në lidhje për blerjet e realizuara nën 100,000 lekë rezultoi se bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit nuk administrohet dokumentacioni vërtetues mbi realizimin e procedurës nga testimi i tregut për përcaktimin e vlerës deri në fazën e përzgjedhjes së OE, me të cilin është realizuar transaksioni, si dhe nuk janë të parashikuara në regjistrat e parashikimit të prokurimit. Sa më sipër veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 4, pika 26, “*Dokument financiar*” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin që rregullon dokumentin elektronik”; neni 12, pika 3, germa a); neni 12, pika 3, germa dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; Nenin 4, pika 19 “*Gjurma e auditimit*” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, si dhe të Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”. - Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde mbi zbatimin e buxhetit" pika 165 “Për të gjitha shpenzimet e kryera nëpunësi zbatues kryen kontrollin para pagesës, lidhur me mjaftueshmërinë e disponibiliteteve mujore të parashikuara në planin e arkës, kontrollojnë dokumentet origjinale të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit dhe kontrollin e tjera të nevojshme dokumentare”.

II. Auditimi i procedurave të prokurimit “Blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar”

Autoriteti Kontraktor, në fillim të vitit buxhetor, ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) për blerjen e biletave i përbërë prej 3 anëtarë, bazuar në Udhëzimin e APP nr. 4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” (për sa kohë ishte në fuqi) dhe në pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 18.06.2021. Pas nxjerrjes së autorizimit për pjesëmarrje nga titullari/ ministri, titullari i AK/ personi i autorizuar prej tij, referuar pikës 4 të Udhëzimit ka nxjerrë Urdhërat e Prokurimit përkatës.

Komisioni, në zbatim të pikës 5-6 të Udhëzimit, ka realizuar procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

Nga auditimi i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar është konstatuar se blerja e biletave është realizuar në kufijtë e datës së nisjes. Kjo ka ardhur si pasojë e miratimit me vonesë të autorizimeve, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të INSTAT në këto aktivitete. Një fenomen i tillë sjell si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë, kur prokurohet pak ditë para datës së nisjes, krahasuar me çmimet e tregut.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar.

Në të gjithë urdhër-shpenzimet e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të përzgjedhura për t’u audituar nga ana e Grupit të Auditimit, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua *mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve*. Me anë të këtij dokumentacioni, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE datë 10.07.2013 “ Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*”, pika 4 dhe me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “*Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative*”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik.*”

Për vitin 2022 u audituan urdhër-shpenzimet si më poshtë:

1- Urdhër-shpenzimi Nr. 637, paguar biletë avioni 1 copë për itinerarin Tiranë-Bruksel-Tiranë datë 22.07.2022 në vlerën 84,180. Konstatohet se kërkesa për blerje bilete avioni e drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Projekteve, nga ana e Sektorit të Prokurimeve është e datës 18.05.2022 ndërsa kërkesa për miratimin e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar me anë të sistemit dinamik nga ana e Komisionit të Sistemit Dinamik të biletave (Z. A.B, Z. D.K, Z. E.T) është dërguar për miratim tek Drejtori i Përgjithshme në datën 27.06.2022, ndërkohë që bileta është prerë për datën 28.06.2022 duke rritur rrezikun e blerjes me vlerë më të lartë.

Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

1. Urdhër-shpenzimi Nr. 1069 datë 23.11.2022, paguar biletë avioni 3 copë Tiranë-Luksemburg –Tiranë në vlerën 310,100 lekë . Konstatohet se kërkesa për blerje bilete avioni e drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Projekteve, nga ana e Sektorit të Prokurimeve është e datës 02.11.2022 ndërsa Kërkesa për miratimin e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar me anë të sistemit dinamik nga ana e Komisionit të Sistemit Dinamik të Biletave (Z. A.B, Z. D.K, Z. E.T) është dërguar për miratim tek Drejtoresha e Përgjithshme në datën 08.11.2022, ndërkohë që bileta është prerë për datën 15.11.2022 duke rritur rrezikun e blerjes me vlerë më të lartë. Është konstatuar se bileta është blerë tek OE i shpallur i 2-ti në renditje me një përshkrim në proces-verbal se OE i shpallur fitues nuk është paraqitur pranë AK për të dorëzuar dokumentacionin ndërkohë që duhej mbajtur proces-verbal i veçantë.

Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.’

2. Urdhër-shpenzimi Nr. 920, paguar biletë avioni 1 copë për itinerarin Tiranë-Bruksel-Tiranë datë 04.10.2022 në vlerën 66,900. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për Ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

3. Urdhër-shpenzimi Nr. 1052 datë 14.11.2022, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel – Tiranë në vlerën 58,655 lekë . Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për Ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

4. Urdhër-shpenzimi Nr. 1066 datë 23.11.2022, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel – Tiranë në vlerën 51,090 lekë . Konstatohet se kërkesa për blerje bilete avioni e drejtuar drejtorisë së financës dhe projekteve, sektorit të prokurimeve është e datës 05.10.2022 ndërsa kërkesa për miratimin e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar me anë të sistemit dinamik nga ana e komisionit të sistemit dinamik të biletave (Z. A.B, Z. D.K, Z. E.T) është dërguar për miratim tek Drejtoresha e Përgjithshme në datën 17.10.2022, ndërkohë që bileta është prerë për datën 20.10.2022 duke rritur rrezikun e blerjes me vlerë më të lartë. Është konstatuar se bileta është blerë

tek OE i shpallur i 2-ti në renditje me një përshkrim në procesverbal se OE i shpallur fitues ka njoftuar tërheqjen nëpërmjet SPE por kërkesa nuk gjendet e bashkangjitur në dosje. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

5. Urdhër-shpenzimi Nr. 1067 datë 23.11.2022, paguar biletë avioni 8 copë Tiranë-Luksemburg –Tiranë në vlerën 850,800 lekë . Është konstatuar se bileta është blerë tek OE i shpallur i 2-ti në renditje me një përshkrim në procesverbal se OE i shpallur fitues nuk është paraqitur pranë AK për të dorëzuar dokumentacionin pa mbajtur procesverbal të veçantë. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

6. Urdhër-shpenzimi Nr. 1068 datë 23.11.2022, paguar biletë avioni 6 copë Tiranë-Luksemburg –Tiranë në vlerën 599,000 lekë . Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

7. Urdhër-shpenzimi Nr. 1070 datë 23.11.2022, paguar biletë avioni 23 copë Tiranë-Luksemburg–Tiranë në vlerën 2,900,000 lekë. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

8. Urdhër-shpenzimi Nr. 872 datë 29.09.2022, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel –Tiranë në vlerën 57,600 lekë. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik .

Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për Ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

9. Urdhër-shpenzimi Nr. 1193 datë 21.12.2022, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel – Tiranë në vlerën 44,460 lekë . Konstatohet se kërkesa për blerje bilete avioni e drejtuar drejtorisë së financës dhe projekteve, sektorit të prokurimeve është e datës 22.11.2022 ndërsa kërkesa për miratimin e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar me anë të sistemit dinamik nga ana e komisionit të sistemit dinamik të biletave (Z. A.B, Z. D.K, Z. E.T) është dërguar për miratim tek Drejtoresha e Përgjithshme në datën 22.11.2022, ndërkohë që bileta është e datës 23.11.2022. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

10. Urdhër-shpenzimi Nr. 873 datë 29.09.2022, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Luksemburg–Bruksel-Tiranë në vlerën 69.600 lekë . Konstatohet se mungon ftesa nga organizatorët e eventit(Kap. 18 Statistikat)Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për Ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

11. Urdhër-shpenzimi Nr. 1175 datë 16.12.2022, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel –Tiranë në vlerën 36,700 lekë . Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

12. Urdhër-shpenzimi Nr. 936 datë 07.10.2022, paguar biletë avioni 19 copë Tiranë-Luksemburg –Tiranë në vlerën 2,222,222 lekë . është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori

ekonomik . Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

Për vitin 2023 u audituan urdhër-shpenzimet si më poshtë:

1. Urdhër-shpenzimi Nr. 210 datë 16.03.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-New York –Tiranë në vlerën 101,480 lekë . Komisioni Dinamik i Biletave ka pasur në përbërje të tij Znj. N.P, Z. A.B dhe Z. B.K .Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK por fotokopje të tij. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

2. Urdhër-shpenzimi Nr. 417 datë 24.05.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel – Tiranë në vlerën 50,850 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. A.D, Z. A.B dhe Z. B.K. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik por vetëm fotokopje të tyre. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

3. Urdhër-shpenzimi Nr. 1261 datë 26.10.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Lisbonë– Tiranë në vlerën 83,160 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. F.G, Z. A.B dhe Z. B.K. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje të tij, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

4. Urdhër-shpenzimi Nr. 387 datë 16.05.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel – Tiranë në vlerën 59,225 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. A.D, Z. A.B dhe Z. B.K. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik por vetëm fotokopje të tyre. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

5. Urdhër-shpenzimi Nr. 1107 datë 12.10.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel –Tiranë në vlerën 45,902 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. F.G, Z. A.B dhe Z. B.K Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK.OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.
6. Urdhër-shpenzimi Nr. 1472 datë 17.11.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel –Tiranë në vlerën 41,443 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. F.G, Z. A.B dhe Z. B.K Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje të tij , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022.Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.
7. Urdhër-shpenzimi Nr. 743 datë 03.08.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Otava –Tiranë në vlerën 225,000 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. F.G, Z. A.B dhe Z. B.K. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.
8. Urdhër-shpenzimi Nr. 1262 datë 26.10.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Gjenevë –Tiranë në vlerën 39,500 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. F.G, Z. A.B dhe Z. B.K. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.
9. Urdhër-shpenzimi Nr. 1471 datë 17.11.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Gjenevë –Tiranë në vlerën 61,632 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. F.G, Z. A.B dhe Z. B.K. Konstatohet se ftesa për ofertë nuk ka të bashkangjitur specifikimet teknike. Konstatohet se OE i renditur i pari është skualifikuar me shpjegimin se ka njoftuar tërheqjen nëpërmjet SPE por mungon kërkesa e tërheqjes në dosje. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.
10. Urdhër-shpenzimi Nr. 720 datë 27.07.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel –Tiranë në vlerën 58,900 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. A.D, Z. A.B dhe Z. B.K . Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi

gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik por vetëm fotokopje të tyre..Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

11. Urdhër-shpenzimi Nr. 1263 datë 26.10.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Bruksel –Tiranë në vlerën 40,399 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. F.G, Z. A.B dhe Z. B.K. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

12. Urdhër-shpenzimi Nr. 388 datë 16.05.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Shangai–Tiranë në vlerën 281,750 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. A.D, Z. A.B dhe Z. B.K. Konstatohet se kërkesa për blerje bilete avioni e drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Projekteve, Sektorit të Prokurimeve është e datës 04.04.2023 ndërsa Kërkesa për miratimin e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar me anë të sistemit dinamik nga ana e komisionit të sistemit dinamik të biletave është dërguar për miratim tek Drejtoresha e Përgjithshme në datën 18.04.2023, ndërkohë që bileta është e datës 22.04.2023 duke rritur riskun e blerjes së biletës me vlerë më të lartë. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik por vetëm fotokopje të tyre. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

13. Urdhër-shpenzimi Nr. 108 datë 23.02.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Gjenevë –Tiranë në vlerën 54,405 lekë. Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. D.K, Z. A.B dhe Z. B.K. Konstatohet se kërkesa për blerje bilete avioni e drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Projekteve,nga ana e Sektorit të Prokurimeve është e datës 13.01.2023 ndërsa kërkesa për miratimin e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar me anë të sistemit dinamik nga ana e komisionit të sistemit dinamik të biletave është dërguar për miratim tek Drejtoresha e Përgjithshme në datën 24.01.2023, ndërkohë që bileta është e datës 25.01.2023 duke rritur riskun e blerjes së biletës me vlerë më të lartë. Nuk është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave ku renditen OE të kualifikuar si dhe operatori i përzgjedhur fitues. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik .Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me

Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

14. Urdhër-shpenzimi Nr. 109 datë 23.02.2023, paguar biletë avioni 1 copë Tiranë-Paris – Tiranë në vlerën 113,000 lekë . Komisioni i Sistemit Dinamik i përbërë nga Z. D.K, Z. A.B dhe Z. B.K. Është konstatuar se nuk janë pjesë e dosjes përshkrimi i ofertës i plotësuar, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik. Konstatohet se OE i përzgjedhur fitues nuk kanë dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

III. Prokurimet publike

Grupi i auditimit, për të realizuar qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe çdo akti juridik që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje licenca”i ndarë në 6 lote, për nevoja të INSTAT”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje licenca”i ndarë në 6 lote, për nevoja të INSTAT			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” E ndarë në 6 lote Loti 1: Blerje licenca për sistemin online të aksesit në të dhënat mikro (CAL) Loti 2: Blerje licenca EOP “Exchange Online Protection” Loti 3: Blerje licenca “IBM SPSS Statistics Software” REF-61254-03-03-2023 Loti 4: Blerje licenca “Adobe Creative Cloud for Teams” Loti 5: Blerje licenca “Verising SSL Certificate Eildcard” Loti6:Blerjelicenca“Antiran somwarepërservera”	2.Hartimi i kërkesës të detajuar me specifikime z. I.D, specialist në sektorin e menaxhimit të rrjetet dhe serverave	3. Njësia e Prokurimit Znj.N.P përgjegjëse në sektorin e prokurimeve z. I.D, specialist në sektorin e menaxhimit të rrjetet dhe serverave z.A.D, specialist në sektorin e menaxhimit të rrjetet dhe serverave	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.141/2 datë 22.02.2023 z.A.B, z.G.K dhe z.A.E

5. Fondi Limit total (pa tvsh) 4,192,968 lekë pa tvsh FL Lot 1 286,325 lekë FL Lot 2 463,864 lekë FL Lot 3 2,402,400 lekë FL Lot 4 304,972 lekë FL Lot 5 85,407 lekë FL Lot 6 650,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) Lot 2 355,800 lekë Lot 3 2,342,278 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lot 2 108,064 lekë Lot 3 60,122 lekë
8.Data e hapjes së tenderit Lot 2 datë 17.03.2023 Lot 3 datë 14.04.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 për të dy lotet Kualifikuar 1 OE Lot 3 I.S shpk, me NUIS xxxxxxxx, me ofertën ekonomike prej 2.342.278 lekë pa tvsh. Lot 2 I.S shpk, me NUIS xxxxxxxx, me ofertën ekonomike prej 355,800 lekë pa tvsh
11.Kohëzgjatja e kontratës 14 ditë nga nënshkrimi i saj		14. Lidhja e kontratës Lot 3 kontrata me nr.141/10 prot., datë 05.05.2024 Lot 2 kontrata nr.141/12 prot., datë 12.06.2024
12. Ankimime S'ka	13. Përgjigje Ankesës	15. Zbatimi i kontratës: Me urdhër shpenzimin nr.651 datë 13.07.2023 është likuiduar vlera 2,810,7334 lekë Me urdhër shpenzimin nr.757 datë 03.08.2023 është likuiduar vlera 426,960 lekë

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit konstatohet:

Me shkresën nr. 141 prot., datë 31.01.2023 nga ‘‘Kërkesë për fillimin e procedurës blerje licenca’’ nga përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit dhe serverave të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm për zhvillimin e kësaj procedure.

Bashkëlidhur kërkesës është informacioni mbi specifikimet teknike dhe llojet e licencave.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr. 141/1, datë 22.02.2023, ‘‘Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit’’. Fondi është përlogaritur pas marrjes së ofertave nga tre OE për gjashtë lotet. Komisioni i përbërë i përbërë nga z.I.D, znj.A.D, z.A.B kanë mbajtur procesverbalin me datë 21.02.2023, ku është përlogaritur fondi limit për secilin lot.

- Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr. 141/2., datë 22.02.2023, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit total prej 4,192,968 lekë pa TVSH, me objekt ‘‘Blerje licenca’’, dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga Znj.N.P përgjegjëse në sektorin e prokurimeve, z.I.D, specialist në sektorin e menaxhimit të rrjetet dhe serverave, z.A.D, specialist në sektorin e menaxhimit të rrjetet dhe serverave.

Loti 1: Blerje licenca për sistemin online të aksesit në të dhënat mikro (CAL) *me fond limit 286,325 lekë pa tvsh.*

Loti 2: Blerje licenca EOP ‘‘Exchange Online Protection’’ *me fond limit 463,864 lekë pa tvsh.*

Loti 3: Blerje licenca ‘‘IBM SPSS Statistics Softëare’’ *me fond limit 2,402,400 lekë pa tvsh.*

Loti 4: Blerje licenca ‘‘Adobe Creative Cloud for Teams’’ *me fond limit 304,972 lekë pa tvsh.*

Loti 5: Blerje licenca ‘‘Verising SSL Certificate Card’’ *me fond limit 85,407 lekë pa tvsh.*

Loti 6 :Blerje licenca ‘‘Antiransomware për servera’’ *me fond limit 650,000 lekë pa tvsh.*

Me urdhrin nr.141/3 prot., datë 22.02.2023, është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar z.A.B, z.G.K dhe z.A.E në kundërshtim me VKM nr. 285 neni 75 pika 4 ku citohet “Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla” pasi z. A.B është njëkohësisht edhe anëtar në komisionin për argumentimin e fondit limit.

Nga auditimi i Dokumenteve të Procedurës nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Njoftimi i shkurtuar i kontratës nuk ka datë e numër protokollit si dhe firmë dhe vulë të titullarit të autorizuar në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Me datën 03.03.2023 është mbajtur procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit por nuk janë firmosur nga njësia e prokurimit duke krijuar pasiguri të audituesit, për kohën dhe mënyrën e hartimit të tyre.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur relacioni datë 21.03.2023 për të realizuar vlerësimin e ofertave, i firmosur vetëm nga dy anëtarë dhe anëtari i tretë ka konfirmuar me email, ku ndër të tjera citohet se “...gjatë punës për vlerësimin e ofertave komisioni ka vërejtur një problematikë në lidhje me përllogaritjen e sigurimit të ofertës të bërë nga njësia e prokurimit përsa i përket loteve 1,2,4,5,6dhe në këto kushte i kanë propozuar Titullarit të AK anulimin e procedurës dhe Drejtori i Përgjithshëm me urdhrin nr.141/5 prot., datë 21.03.2023.

Me datë 27.03.2023 janë përpiluar procesverbali për hartimin e dokumenteve standarde i firmosur vetëm nga dy anëtarë edhe DST, si dhe procesverbali mbi argumentimin e kritereve, por mungon urdhri i ri i prokurimit për vijimin e procedurës nga titullari i AK.

Me raportin përmbledhës nr.620 prot., datë 24.03.2023 KVO vlerëson procedurën për Lotin 3 “Blerje licenca IBM SPSS Statistics Software” me ofertues të vetëm I.S shpk, me NUIS xxxxxxxx, me ofertën ekonomike prej 2.342.278 lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit paraprak për Lotin 3, është firmosur nga Titullari i AK por nuk është i protokolluar.

Me raportin përmbledhës nr.620/1 prot., datë 05.04.2023 KVO vlerëson procedurën për Lotin 2 Blerje licenca EOP Exchange Online Protection me ofertues të vetëm I.S shpk, me NUIS xxxxxxxx, me ofertën ekonomike prej 355,800 lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit paraprak për Lotin 2, është firmosur nga Titullari i AK por nuk është i protokolluar.

- Grupi i auditimit konstatoi se nuk dokumentohet verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE para shpalljes së fituesit Lotin 2 dhe Lotin 3 sipas përcaktimeve në VKM nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 26 pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Është nënshkruar kontrata nr.141/10 prot., datë 05.05.2024 mes drejtorit të përgjithshëm dhe OE fitues për Lotin 3, I.S shpk me vlerën 2,342,278 lekë pa tvsh si dhe me urdhrin nr.53 datë 23.05.2023 është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen e kontratës z.G.K.

Është nënshkruar kontrata nr.141/12 prot., datë 12.06.2024 mes drejtorit të përgjithshëm dhe OE fitues për Lotin 2, I.S shpk me vlerën 355.800 lekë pa tvsh si dhe me urdhrin nr.77 datë 14.06.2023 është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen e kontratës z.G.K.

Formulari i njoftimit të fituesit përfundimtar, formulari i kontratës së nënshkruar si dhe botimet e njoftimeve nuk ndodhen në dosjen e arkivuar vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Me urdhër shpenzimin nr.651 datë 13.07.2023 është likuiduar vlera në masën 2,810,7334 lekë për faturën nr.1051/2023 dt.26.05.2023 për Lotin 3 dhe me urdhër shpenzimin nr.757 datë 03.08.2023 është likuiduar vlera 426,960 lekë për faturën nr.1211/2023 dt.13.06.2023 për Lotin 2. Grupi i auditimit konstatoi se likuidimi i faturave është realizuar pas afatit 30 ditor.

Nga relacioni me e-mail i datës 30.05.2024 nga znj. N.P dërguar grupit të auditimit në lidhje me 4 lotet e tjera mbetur pa realizuar ndër të tjera citohej*Në periudhën e rihapjes së procedurës për “Blerje Licensa” nga buxheti i shtetit, u konstatua se licencat e censit mund të përdoren edhe për të mbuluar procesin e prodhimit statistikor pa ndikuar në cilësinë e aktiviteteve statistike (konfirmuar edhe nga asistenca teknike). Pajisjet në të cilat do të instaloheshin licencat do të përdoren nga punonjësit e INSTAT si edhe nga ekspertët key apo nonkey të CENS”, veprim në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.9936 datë 26.06.2002 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4 ku përcaktohet se burimet financiare duhen të përdoren me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet në përputhje me objektivat strategjike të institucionit.*

Dokumentacioni i paprotokolluar në kundërshtim me Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 ‘Për arkivat’ i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ku citohet ‘Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemen e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilogruar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhërat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje tonera”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara” REF-73676-06-26-2023	2.Hartimi i kërkesës të detajuar me specifikime Shkresa nr. 394 prot., datë 23.02.2023 nga “Kërkesë për blerje tonera”	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 394/2., datë 22.02.2023 i përbërë nga: z.A.D specialist në sektorin e menaxhimit të rrjetet dhe serverave, z.A.D, specialist në sektorin e prokurimeve dhe znj. K.P, specialist në	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.394/3 prot., datë 29.05.2023 i përbërë nga: z.A.B, z.A.D dhe z. F.G

		sektorin e programeve kompjuterike	
5. Fondi Limit total (pa tvsh) 2,900,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) M.D me ofertën ekonomike prej 666,612 lekë pa tvsh E.C me ofertën ekonomike prej 871,000 lekë pa tvsh L.D me ofertën ekonomike prej 2,220,000 lekë pa tvsh I.S me ofertën ekonomike prej 2,290,000 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,233,388 lekë	
8.Data e hapjes së tenderit 07.07.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 7 (shtatë) 1. M.D me ofertën ek. 666,612 2. E.C me of.ek 871,000 3. A.K me ofertën ek. 944,000 (skualifikuar) 4. E.L me ofertën ek. 1,289,000 (skualifikuar) 5. L.D me of.ek. 2,220,000 6. I.O me of.ek. 2,290,000 7.I.G.J.K me of.ekon 2,399,681 (skualifikuar)	
11. Kohëzgjatja e kontratës 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës			
12. Ankimime S'ka	13. Përgjigje Ankesës	14. Lidhja e kontratës -Janë nënshkruar draft marrëveshjet kuadër respektive me 4 OE të kualifikuar, konkretisht nr.394/9, nr.394/10, nr.394/11 dhe nr.394/12 datë 06.09.2023. - Është nënshkruar kontrata nr.1900/6 prot., datë 24.10.2023 mes drejtorit të përgjithshëm dhe OE M.D në vlerën 490,040 lekë pa tvsh.	
15. Zbatimi i kontratës:	Me procesverbalin e datës 01.11.2023 është marrë në dorëzim malli sipas urdhrin për krijim komisioni marrjes në dorëzim.		

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit konstatohet:

Me shkresën nr. 394 prot., datë 23.02.2023 nga “Kërkesë për blerje tonera” nga specialisti i sektorit të administrimit të rrjetit dhe serverave të miratuar nga drejtori i drejtorisë së teknologjisë së informacionit dhe Drejtori i Përgjithshëm për zhvillimin e kësaj procedure.

Bashkëlidhur kërkesës është informacioni mbi llojet e tonerave dhe sasinë.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr. 26, datë 03.03.2023, "Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit". Fondi është përllogaritur pas marrjes së ofertave nga 3 (tre) OE. Komisioni i përbërë i përbërë nga znj. N.P, znj. A.D, z. A.B kanë mbajtur procesverbalin me datë 20.04.2023, ku është përllogaritur fondi limit në vlerën 4,635,204 lekë. Me procesverbalin e datës 10.05.2023 nga specialisti e përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit dhe serverave u hartua tabela me sasi të reja. Me procesverbalin e datës 16.05.2023 komisioni hartoi fondit limit.

Nga ana e këtij komisioni nuk janë mbajtur deklaratat e konfliktit të interesit në kundërshtim me nenin 13 pika 5 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit”.

- Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr. 394/2., datë 22.02.2023, ka urdhëruar të kryhet prokurimi i fondit total prej 2,900,000 lekë pa TVSH, me objekt “Blerje tonera”, dhe ngarkohet njësi e prokurimit e përbërë nga z. A.D specialist në sektorin e menaxhimit

të rrjetet dhe serverave, z. A.D, specialist në sektorin e prokurimeve dhe znj. K.P, specialist në sektorin e programeve kompjuterike.

Me urdhrin nr.394/3 prot., datë 29.05.2023, është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar z. A.B, z. A.B dhe z. F.G në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar **neni 75 pika 4 ku citohet ‘Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla’ pasi z. A.B është njëkohësisht edhe anëtar në komisionin për argumentimin e fondit limit.**

Nga auditimi i Dokumenteve të Procedurës nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Njoftimi i shkurtuar i kontratës nuk ka datë e numër protokoli si dhe firmë dhe vulë të titullarit të autorizuar, por veç firmën e njësisë së prokurimit ku ka përcaktuar si datë të zhvillimit të procedurës datë 03.07.2023.

Eshtë mbajtur procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit por nuk ka datë duke krijuar pasiguri të audituesit, për kohën e hartimit të tij.

Në dosje ndodhet një njoftim për ndryshimin e dokumenteve të tenderit, pa datë e pa numër protokoli “përsa i përket afatit të ri të dorëzimit të ofertave” i cili ndryshohet me datë 07.07.2023.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është dërguar email operatorit ekonomik për argumentimin e ofertës anomale.

OE M.D me shkresën nr.1398 prot., datë 17.07.2023 ka përcjellë argumentimet e tij. Me procesverbalin e datës 18.07.2023 (pa nr.protokoli) nuk dokumentohet shqyrtimi i bërë për ofertën anomalisht të ulët të paraqitur nga M.D shpk.

Deklaratat e konfliktit të interesit janë me datë të ndryshme nga data e hapjes së ofertës. Me procesverbalin e datës 02.08.2023 KVO kualifikoi 4 operatorët ekonomik pjesëmarrës konkretisht M.D me ofertën ekonomike prej 666,612 lekë pa tvsh;

E.C me ofertën ekonomike prej 871,000 lekë pa tvsh;

L.D me ofertën ekonomike prej 2,220,000 lekë pa tvsh;

I.O me ofertën ekonomike prej 2,290,000 lekë pa tvsh.

U skualifikuan OE si më poshtë për arsyet mosparaqitjes së dokumentacionit provues sipas përcaktimeve të nenit 26 pika 6 të VKM –së nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

A.K me ofertën ekonomike 944,000 lekë pa tvsh;

E.L me ofertën ekonomike prej 1,289,000 lekë pa tvsh;

GJ.K me ofertën ekonomike prej 2,399,681 lekë pa tvsh.

Me urdhrin nr.394/4 prot. dhe nr.394/5 prot., datë 03.08.2023 të drejtorit të përgjithshëm janë bërë korigjimet materiale në aktet administrativ përkatëse (UP,UKVO) nga “Ku të gjitha kushtet janë të paracaktuara” me “ku jo të gjitha kushtet janë të paracaktuara”.

Me urdhrin nr.100 datë 11.08.2023 ndryshohet anëtari i KVO nga z. A.B në z. A.D.

Me raportin përmbledhës nr.394/7 prot., datë 25.08.2023 KVO vlerëson procedurën dhe informon titullarin e AK për procedurën e ndjekur. Titullari i AK me shkresën nr.394/8 prot., datë 25.08.2023 procedurën e prokurimit, *procedurë e hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër.*

Në sistem janë ngarkuar 4 njoftim fituesi paraprak nga zyrtari i autorizuar z. A.D, të cilat konstatohet se nuk janë administruar në dosje.

- Nga grupi i auditimit konstatohet se nuk dokumentohet verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga 4 OE para shpalljes së fituesit bazuar në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nëni 26 pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Janë nënshkruar draft marrëveshjet kuadër respektive me 4 OE të kualifikuar, konkretisht nr.394/9, nr.394/10, nr.394/11 dhe nr.394/12 datë 06.09.2023.

Është hapur minikonkursi dhe me datë 10.10.2023 është shpallur fitues në marrëveshjen kuadër M.D, por pa numër protokollit.

Është nënshkruar kontrata nr.1900/6 prot., datë 24.10.2023 mes drejtorit të përgjithshëm dhe OE M.D në vlerën 490,040 lekë pa tvsh si dhe me urdhrin nr.149 datë 26.10.2023 është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen e kontratës. Me procesverbalin e datës 01.11.2023 është marrë në dorëzim malli sipas urdhrin për krijim komisioni marrjes në dorëzim, ky i fundit nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit dhe likuiduar me urdher shpenzimin nr.1829 datë 22.12.2023.

Botimet e njoftimeve nuk ndodhen në dosjen e arkivuar vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Në dosje nuk dokumentohet gjithashtu formulari për zbatimin dhe raportimin e zbatimit të kontratës në kundërshtim me nenin 124 pika 2 e 3 dhe nenin 125 të ligjit 162/2020 ‘Për prokurimin publik’.

Dokumentacioni i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 ‘Për arkivat’ i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ku citohet ‘Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemen e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrin të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhërat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizime me automjete me qira për CENS 2023”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Furnizime me automjete me qira për CENS 2023”,
--

1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” REF 72129-06-09-2023	2.Hartimi i kërkesës të detajuar me specifikime Me shkresën nr. 812 prot., datë 27.04.2023 nga “Kërkesë për sigurimin e bazës mbështetëse transport CENS” nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës	3.Njësia e Prokurimit Urdhri nr 812/2 prot., datë 29.05.2023 i përberë nga:znj.N.P, përgjegjës në sektorin e prokurimeve, z. A.E, specialist në sektorin e çështjeve ligjore/administrative, z. E.T, përgjegjës në sektorin e shërbimeve	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Me urdhrin nr.812/3 prot., datë 29.05.2023, i përberë: znj. E.K, z. A.H, z. E.Sh, z. A.D dhe z. E.Xh
5. Fondi Limit total (pa tvsh) 29,843,333 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese (pa tvsh) 28,880,000 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 963,333 lekë	
8.Data e hapjes së tenderit 07.07.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër BOE M.shpk dhe M.D	
11. Kohëzgjatja e kontratës Nga dt.11.08.2023-12.12.2023	12. Ankimime Po (në AK dhe KPP)	13. Përgjigje Ankesës Me shkresën nr.1423 prot., datë 21.07.2023 e SP njoftohet KPP mbi vendimin e AK	14. Përgjigje Vendimi i KPP-së nr.679/2023 datë 27.07.2023 duke pranuar ankesa e paraqitur
15. Lidhja e kontratës Nr.812/13 prot., datë 11.08.2023	16.Zbatimi i kontratës: Urdhri nr.109 datë 14.08.2023 i përberë z. E.T, z. M.H dhe z. F.S		

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit konstatohet:

Me shkresën nr. 812 prot., datë 27.04.2023 nga “Kërkesë për sigurimin e bazës mbështetëse transport CENS” nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës për zhvillimin e kësaj procedure. Bashkëlidhur kërkesës është informacioni mbi sasinë e nevojshme dhe specifikimet.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr. 49, datë 09.05.2023, “Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit”. Fondi është përlllogaritur pas marrjes së ofertave nga tre OE. Komisioni i përberë i përberë nga znj. N.P, z. A.H, z. A.B kanë mbajtur procesverbalin me datë 15.05.2023, ku është përlllogaritur fondit limit në vlerën 29,843,333 lekë. Nga ana e këtij komisioni nuk janë mbajtur deklaratat e konfliktit të interesit në kundërshtim me nenin 13 pika 5 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit”.

- Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr. 812/2., datë 29.05.2023, është urdhëruar të kryhet prokurimi i fondit total prej 29,843,333 lekë pa TVSH, me objekt “Kërkesë për sigurimin e bazës mbështetëse transport CENS”, dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përberë nga znj. N.P, përgjegjës në sektorin e prokurimeve, z. A.E, specialist në sektorin e çështjeve ligjore/administrative, z. E.T, përgjegjës në sektorin e shërbimeve.

Me urdhrin nr.812/3 prot., datë 29.05.2023, është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar z. E.K, z. A.H, znj. E.Sh, z.A.D dhe z. E.Xh në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar **neni 75 pika 4 ku citohet “Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla” pasi z. A.H është njëkohësisht edhe anëtar në komisionin për argumentimin e fondit limit.**

Nga auditimi i Dokumenteve të Procedurës nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Njoftimi i shkurtuar i kontratës nuk ka datë e numër protokoli si dhe firmë dhe vulë të titullarit të autorizuar por veç firmën e njësisë së prokurimit ku ka përcaktuar si datë të zhvillimit të procedurës datë 27.06.2023.

Është mbajtur procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit por ska datë duke krijuar pasiguri të audituesit, për kohën e hartimit të tij dhe nuk është firmosur anëtarët e njësisë.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin e datës 04.07.2023 KVO s'kualifikoi bashkimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës konkretisht M. shpk dhe M.D me ofertën 28,880,000 lekë pa tvsh.

U skualifikua BOE për mosplotësim sipas përcaktimeve të kritereve 1. Duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qiraje ose me marrëveshje/kontratë dhe 2. Duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jene të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme.

Argumentimi: Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nuk dëshmohet që OE ofertues ka një marrëveshje/kontratë bashkëpunimi, servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar. OE nuk ka paraqitur një pjesë ose e të gjithë informacionin ose dokumentet e kërkuara në DATË

Tre katalogët e paraqitur, dy nga të cilët janë të papërkthyer dhe të panoterizuara dhe në asnjërën prej tyre nuk janë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjeti të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

Me urdhrin nr.812/4 datë 14.07.2023 titullari i AK vendos anulimin e procedurës së prokurimit.

Me datë 17.07.2023 publikohet klasifikimi dhe me datë 18.07.2023 BOE paraqet ankesë në Autoritetin Kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik.

Me urdhrin nr.812/6 prot., datë 19.07.2023 të titullarit të AK znj. E.Dh "Për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurat e prokurimit publik".

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka hartuar relacionin për titullarin e AK, në përfundim i propozon të refuzojë ankesën, duke argumentuar mosplotësimin e kritereve të kërkuara nga AK.

Me shkresën nr.1423 prot., datë 21.07.2023 e SP njoftohet KPP mbi vendimin e AK.

Me shkresën nr.1728/5 prot., datë 27.07.2023 dërgohet vendimi nr.679/2023 datë 27.07.2023 ku KPP pranon ankesën e paraqitur nga BOE M. shpk dhe M.D, duke detyruar INSTAT të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin duke e kualifikuar atë.

Me urdhrin nr.812/7 prot., datë 31.07.2023 të titullarit të AK znj. E.Dh urdhëron zbatimin e vendimit të KPP nr.1728/4 datë 27.07.2023.

Raporti përmbledhës nr.812/11 prot., datë 04.08.2023, i drejtohet titullarit të AK mbi procedurën e ndjekur nga KVO-ja dhe me shkresën nr.812/12 prot., miratohet procedura e ndjekur.

Me njoftimin e fituesit (në përfundim të afateve të ankimit) datë 10.08.2023 të firmosur nga drejtori i përgjithshëm po i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin për arkivat.

Me datë 11.08.2023 është nënshkruar kontrata vetëm me njërin nga operatorët ekonomik të bashkimit, konkretisht M. shpk në kundërshtim me parashikimet ligjore që duhen të firmosin të dy anëtarët e bashkimit neni 88 pika 5 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku citohet "Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar datë 24.08.2023 ndodhet në dosje por pa firmë dhe pa një sigël, jashtë afateve ligjore për botim në kundërshtim me nenin 86 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ku citohet “Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar”.

Me urdhrin nr.106 datë 14.08.2023 është caktuar personi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt “Sigurimi i bazës mbështetëse transporti CENS 2023”.

Me urdhrin nr.109 datë 14.08.2023 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit të prokuruar për kontratën me objekt” Sigurimi i bazës mbështetëse transporti CENS 2023” të përbërë nga z. E.T, z. M.H dhe z. F.S. Komisioni ka mbajtur procesverbalet përkatëse dhe raportet mujore.

Nga grupi i auditimit konstatohet se botimet e njoftimeve nuk ndodhen në dosjen e arkivuar vënë në dispozicion. Në dosje nuk dokumentohet gjithashtu formulari për zbatimin dhe raportimin e zbatimit të kontratës në kundërshtim me nenin 124 pika 2 e 3 dhe nenin 125 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”. Dosja e prokurimit në SPE rezulton e paarkivuar në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, udhëzimi nr.2597 prot., dt.28.03.2024.

Dokumentacioni i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 ‘Për arkivat’i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ku citohet ‘Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemen e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohët edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhërat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Trajtimin e punonjësve me catering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS 2023”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Trajtimin e punonjësve me catering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS 2023”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur ” REF- 73430-06-22-2023	2.Hartimi i kërkesës të detajuar me specifikime Me shkresën nr. 962 prot., datë 25.05.2023 nga “Kërkesë për trajtimin e punonjësve me catering gjatë	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 962/2., datë 20.06.2023 i përbërë nga: znj. N.P, përgjegjës në sektorin e prokurimeve, z. A.E, specialist në sektorin e çështjeve ligjore/administrative, z.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.962/3 prot., datë 29.05.2023, i përbërë nga me anëtar z. A.D, z. E.Xh, znj. E.Sh, z. A.D dhe z. B.H

	realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës	M.H , përgjegjës në sektorin e planifikimit dhe monitorimit të mbledhjes së të dhënave	
5. Fondi Limit total (pa tvsh) 36,140,280 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE D.P.2, me NUIS xxxxxx me ofertën ekonomike 33,144,441 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,995,839 lekë	
8.Data e hapjes së tenderit 10.07.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	11. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 (dy) A.F.S shpk (skualifikuar) OE D.P.2 (kualifikuar)	
10. Kohëzgjatja e kontratës Fillon më 24/07/2023 mbaron më 08/09/2023			
12. Ankimime S'ka	13. Përgjigje Ankesës	14. Lidhja e kontratës Nr. 926/8 prot	
15.Zbatimi i kontratës:	Janë hartuar informacionet përmbledhës të personit ndjekës i zbatimit të kontratës, për ekzekutimin e kontratës për periudhën 24/07/2023 deri më 08/09/2023. Procesverbalet e hartuara (konkretisht i datë 31.08.2023 dhe një procesverbal pa datë por që i bashkëlidhet në urdhër-shpenzim faturës së datës 04.10.2023, për marrjen në dorëzim konstatohet se nuk janë të shoqëruara me listat emërore të pjesëmarrësve siç citohet në të.		

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit konstatohet:

Me shkresën nr. 962 prot., datë 25.05.2023 nga “Kërkesë për trajtimin e punonjësve me catering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS” nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës për zhvillimin e kësaj procedure. Bashkëlidhur kërkesës është informacioni mbi sasinë e nevojshme dhe specifikimet.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr. 56, datë nr.29.05.2023, “Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit”. Fondi është përlllogaritur pas marrjes së ofertave nga tre OE. Komisioni i përbërë i përbërë nga z. L.S, z. F.G, znj. M.P kanë mbajtur procesverbalin me datë 13.06.2023, ku është përlllogaritur fondi limit në vlerën 36,140,280 lekë. Ofertat e paraqitura, administruar në dosje, nuk janë të plota, pasi nuk kanë të shoqëruar specifikimet teknike të nevojshme duke moskrijuar siguri te audituesit për studimin real të tregut.

Nga ana e këtij komisioni nuk janë mbajtur deklaratat e konfliktit të interesit në kundërshtim me nenin 13 pika 5 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit”.

- Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr. 962/2., datë 20.06.2023, është urdhëruar të kryhet prokurimi i fondit total në vlerën 36,140,280 lekë pa tvsh për “Kërkesë për trajtimin e punonjësve me catering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS”, “Kërkesë për sigurimin e bazës mbështetëse transport CENS”, dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga znj. N.P, përgjegjës në sektorin e prokurimeve, z. A.E, specialist në sektorin e çështjeve ligjore/administrative, z. M.H, përgjegjës në sektorin e planifikimit dhe monitorimit të mbledhjes së të dhënave.

Me urdhrin nr.962/3 prot., datë 29.05.2023, ngrihet Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar znj. E.K, z. A.H, znj. E.Sh, z. A.D dhe z. B.H, i ndryshuar me urdhrin nr.962/4 prot., datë 04.07.2023 ku zëvendësohet z. A.H me z. E.Xh dhe me urdhrin nr.962/5 prot., datë 07.07.2023 ku zëvendësohet znj. E.K me z. A.D.

Nga auditimi i Dokumenteve të Procedurës nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Njoftimi i shkurtuar i kontratës nuk ka datë e numër protokoli si dhe firmë dhe vulë të titullarit të autorizuar por veç firmën e njësisë së prokurimit ku ka përcaktuar si datë të zhvillimit të procedurës datë 10.07.2023.

Eshtë mbajtur procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit datë 22.06.2023 dhe është firmosur nga dy anëtarët e njësisë.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin e datës 14.07.2023 KVO s'kualifikoi bashkimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës konkretisht A.F.S shpk me NUIS xxxxxxxx për mangësi kriteresh kualifikuese.

U kualifikua OE D.P.2, me NUIS xxxxxxxx me ofertën ekonomike 33,144,441 lekë pa tvsh. Është verifikuar dokumentacioni i paraqitur nga OE të kualifikuar me procesverbalin 18.07.2023.

Raporti përmbledhës nr.962/6 prot., datë 26.07.2023, i drejtohet titullarit të AK mbi procedurën e ndjekur nga KVO-ja dhe me shkresën nr.962/7 prot., miratohet procedura e ndjekur.

Me njoftimin e fituesit (në përfundim të afateve të ankimit) datë 26.07.2023 të firmosur nga drejtori i përgjithshëm po i paprotokolluar në kundërshtim me normat e arkivave.

Me datë 27.07.2023 është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik të kualifikuar në vlerën 39,773,329 lekë me tvsh dhe me afat lëvrimi nga 24/07/2023 deri më 08.09.2023, referuar njoftimit të kontratës së nënshkruar në sistem. Sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua se nuk është specifikuar në kontratë si do realizohej shërbim katering u parashikuar për datën 24, 25, dhe 26 korrik 2023, sipas termave të referencës në DT, nisur nga fakti se kontrata është nënshkruar me datë 27.07.2023. Nga grupi i auditimit konstatohet se njoftimi i kontratës së nënshkruar nuk ndodhet në dosje.

Me urdhrin nr.98 datë 01.08.2023 është caktuar personi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt *“Trajtimin e punonjësve me katering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS 2023”* dhe nga ana e titullarit nuk është ngritur një komision për marrjen në dorëzim të shërbimit. Procesverbalet e hartuara (konkretisht i datë 31.08.2023 dhe një procesverbal pa datë por që i bashkëlidhet në urdhër-shpenzim faturës së datës 04.10.2023, për marrjen në dorëzim konstatohet se nuk janë të shoqëruara me listat emërore të pjesëmarrësve siç citohet në të.

Me urdhër shpenzimin nr.1241 datë 24.10.2023 është likuiduar vlera prej 8,583,973 lekë dhe me urdhër shpenzimin nr. 1414 datë 08.11.2023 në vlerën 30,219,132 lekë.

Grupi i auditimit konstatoi se në dosje nuk dokumentohet formulari për zbatimin për zbatimin e kontratës në kundërshtim me nenin 124 pika 2 e 3 të ligjit 162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

Dokumentacioni i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 *“Për arkivat”* i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ku citohet *“Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemen e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohesh edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i*

daktilogruar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhërat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Dosja e prokurimit në SPE nuk ishte arkivuar në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, udhëzimi nr.2597 prot., dt.28.03.2024.

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Botime shtypshkronje”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Botime shtypshkronje”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” marrëveshje kuadër me disa operatorë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara REF-27055-04-28-2022	2.Hartimi i kërkesës të detajuar me specifikime Me shkresën nr. 566 prot., datë 05.04.2022 nga “Kërkesë” nga përgjegjësi i sektorit të publikimeve dhe marketingut të miratuar nga drejtori i drejtorisë së komunikimit e publikimeve	3.Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 566/1., datë 21.04.2022 i përbërë: z. A.Xh, drejtor i drejtorisë së komunikimeve dhe publikimeve, z. D.K, specialist në sektorin e prokurimeve dhe znj. J.R, përgjegjës në sektorin e publikimeve dhe marketingut.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.566/2 prot., datë 28.04.2022, i përbërë nga znj. L.D, z. A.B dhe znj. A.S
4. Fondi Limit total (pa tvsh) 4,999,833 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh)		6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)
7.Data e hapjes së tenderit	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 (katër)	
10. Kohëzgjatja e kontratës	11. Ankimime Po		13. Përgjigje Vendimi nr.505/2022 datë 27.05.2022
14. Lidhja e kontratës Eshhtë nënshkruar draft marrëveshje kuadër respektive me 3 OE të kualifikuar nr.566/7 datë 21.07.2022	15. Zbatimi i kontratës Me procesverbalin e datës 29.08.2022, datë 08.09.2022,datë 18.10.2022,datë 31.10.2022 janë marrë në dorëzim shtypshkrimet e kërkuara sipas urdhrin për komisionit të pritjes së mallit sipas urdhrin nr.13 datë 07.01.2022.		

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit konstatohet:

Me shkresën nr. 566 prot., datë 05.04.2022 nga “Kërkesë” nga përgjegjësi i sektorit të publikimeve dhe marketingut të miratuar nga drejtori i drejtorisë së komunikimit e publikimeve dhe Drejtori i Përgjithshëm për zhvillimin e kësaj procedure.

Bashkëlidhur kërkesës është informacioni mbi llojet e pyetësorëve, librat dhe sasinë.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr. 13, datë nr.22.02.2022, “Për ngritjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit”. Fondi është përlllogaritur pas marrjes së ofertave nga

tre OE. Komisioni i përbërë i përbërë nga z. A.Xh, drejtor i drejtorisë së komunikimeve dhe publikimeve, z. D.K, specialist në sektorin e prokurimeve dhe znj. J.R, përgjegjës në sektorin e publikimeve dhe marketingut kanë mbajtur procesverbalin me datë 11.03.2022, ku është përlogaritur fondi limit në vlerën 5,228,333 lekë si mesatare e ofertave të marra, konkretisht I. me ofertën 2,438,900 lekë, K.K me ofertën 7,207,900 lekë dhe A.C shpk me ofertën 6,038,200 lekë.

Me procesverbalin e datë 11.04.2022 u ritestua tregu dhe u përlogarit fondi limit në vlerën 4,999,833 lekë si mesatare e ofertave të marra.

- Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr. 566/1., datë 21.04.2022, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit total prej 4,999,833 lekë pa TVSH, me objekt “*Botime e shtypshkrime*”, dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga z. A.Xh, drejtor i drejtorisë së komunikimeve dhe publikimeve, z. D.K, specialist në sektorin e prokurimeve dhe znj. J.R, përgjegjës në sektorin e publikimeve dhe marketingut.

Me urdhrin nr.566/2 prot., datë 28.04.2022, është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar znj. L.D, z. A.B dhe znj. A.S.

Me urdhrin nr.566/3 prot., datë 09.05.2022 pezullohet procedura e ngarkohet komisioni për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: znj. E.K, znj. M.L dhe z. A.D.

Me urdhrin nr.566/4 prot., datë 07.06.2022 të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme znj. E.S, hiqet pezullimi i procedurës së prokurimit dhe ngarkohet Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për zbatimin e vendimit nr.505/2022 datë 27.05.2022. Ky urdhër është firmosur pa delegim zyrtar me shkrim nga ana drejtorit të përgjithshëm në kundërshtim me nenin 29 të K.Pr.Administrative.

Nga auditimi i Dokumenteve të Procedurës nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Njoftimi i shkurtuar i kontratës nuk ka datë e numër protokollit por veç firmën dhe vulën e titullarit ku ndër të tjera ka përcaktuar si datë të zhvillimit të procedurës datë 09.05.2022.

Në dosje ndodhet procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit i firmosur nga njësia e prokurimit, datë 28.04.2022.

Me datë 04.05.2022 është paraqitur ankesa nga OE I. për kriteret e kualifikimit

Procesverbali i datës 13.05.2022 nga komisioni për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga I. shpk, ku nuk i është pranuar ankimi.

Me kthimin nr.796/1 prot., datë 16.05.2022 të titullarit të AK, drejtorit të përgjithshëm ku citohet “*ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës*”.

Nga shkresa nr.1023/1 prot., datë 09.06.2022 e firmosur nga drejtori i drejtorisë së përgjithshme znj. E.S, firmosur pa delegim zyrtar me shkrim nga ana drejtorit të përgjithshëm në kundërshtim me përcaktimet e nenit 29 të Kodit të Procedurave Administrative, ku informohet Komisioni i Prokurimit Publik dhe OE ankues për vështirësinë e heqjes së pezullimit. Në këtë shkresë citohet një shtojcë e ndryshimit e cila nuk është bashkëlidhur shkresës. Njoftimi për ndryshim të dokumenteve të tenderit, i firmosur nga njësia e prokurimit nuk përmban datën e re të zhvillimit të procedurës. Data e re identifikohet vetëm nga SPE.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave janë hartuar procesverbalet për vlerësimin e mostrave të produkteve të botime e shtypshkrime për INSTAT për vitin 2022(për 4 nga OE pjesëmarrës)

Me procesverbalin e datës 01.07.2022 KVO (vetëm dy nga anëtarët e komisionit) kualifikuan 4 operatorët ekonomik pjesëmarrës konkretisht:

K.K me ofertën ekonomike prej 3,982,030 lekë pa tvsh;
A.C me ofertën ekonomike prej 4,270,828 lekë pa tvsh;
I. me ofertën ekonomike prej 4,345,205 lekë pa tvsh;
A.P me ofertën ekonomike prej 4,799,310 lekë pa tvsh.

Me raportin përmbledhës nr.566/5 prot., datë 21.07.2022 KVO vlerëson procedurën dhe informon titullarin e AK për procedurën e ndjekur. Titullari i AK me shkresën nr.566/6 prot., datë 21.07.2022 procedurën e prokurimit, procedurë e hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër.

- Nuk dokumentohet verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE para shpalljes së fituesit bazuar në VKM nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar neni 26 pika 6 "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Eshtë nënshkruar draft marrëveshje kuadër respektive me 3 OE të kualifikuar nr.566/7 datë 21.07.2022.

Janë nënshkruar kontratat: nr.566/11 prot., datë 26.08.2022 mes drejtorit të përgjithshëm dhe K.K shpk, nr.566/12 prot., datë 02.09.2022, nr.566/19 prot., datë 17.10.2022, nr.566/21 prot., datë 24.10.2022, nr.566/25 prot., datë 22.12.2022, nr.566/26 prot., datë 22.12.2022, nr.566/30 prot., datë 09.02.2023, nr.566/31 prot., datë 09.02.2023, nr.566/36 prot., datë 08.03.2023, nr.566/41 prot., datë 23.03.2023, nr.566/42 prot., datë 30.03.2023, nr.566/44 prot., datë 03.04.2023, nr.566/51 prot., datë 18.04.2023, nr.566/52 prot., datë 20.04.2023, nr.566/54 prot., datë 05.05.2023.

Formulari i njoftimit të fituesit datë 16.12.2022 i firmosur dhe vulosur nga titullari i AK, drejtori i përgjithshëm, por i paprotokolluar.

Me procesverbalin e datës datës 29.08.2022, datë 08.09.2022, datë 18.10.2022, datë 31.10.2022 janë marrë në dorëzim shtypshkrimet e kërkuara sipas urdhrin për komisionit të pritjes së mallit sipas urdhrin nr.13 datë 07.01.2022 (cituar në procesverbal).

Botimet e njoftimeve nuk ndodhen në dosjen e arkivuar vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Dosja e arkivuar nuk është administruar me rend kronologjik (shih fletën e inventarit).

Në dosje nuk dokumentohet gjithashtu formulari për zbatimin dhe raportimin e zbatimit të kontratës në kundërshtim me nenin 124 pika 2 e 3 dhe nenin 125 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik".

Në sistem procedura ndodhet e paarkivuar në kundërshtim me udhëzimet e APP-së.

Dokumentacioni i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ku citohet "Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemen e Republikës, intestimin "Republika e Shqipërisë", emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrin të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën "në përgjigje" ose "vijim të shkresës" (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi

i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhërat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje pajisje kompjuterike”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje pajisje kompjuterike”		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” REF-34953-06.30-2022 “Shërbim mirëmbajtje pajisje kompjuterike”e ndarë në lote -Lot 1 shërbim mirëmbajtje, fotokopje, printera dhe -Lot 2 shërbim mirëmbajtje servera -Lot 3 shërbim riparim/mirëmbajtje bateri qendrore për serverat	2.Hartimi i kërkesës të detajuar me specifikime Me shkresën nr. 161 prot., datë 02.02.2022 nga “Kërkesë për shërbim mirëmbajtje pajisje kompjuterike” nga përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit dhe serverave.	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 161/2., datë 11.04.2022 i përbërë nga z. A.D, specialist në sektorin e cilësisë dhe metadatave, z. I.D, përgjegjës në sektorin e menaxhimit të rrjetit dhe serverave dhe znj. L.D, përgjegjës në sektorin e prokurimeve
4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.161/3 prot., datë 09.05.2022 i përbërë nga: z. K.A, z. A.B dhe z. D.K	5. Fondi Limit total (pa tvsh) 2,971,333.3 lekë -Lot 1 shërbim mirëmbajtje, fotokopje, printera dhe plotera në vlerën 579,500 lekë pa tvsh -Lot 2 shërbim mirëmbajtje servera në vlerën 1,812,000 lekë -Lot 3 shërbim riparim/mirëmbajtje bateri qendrore	6. Oferta fituese (pa tvsh) Lot 1 “Shërbim mirëmbajtje fotokopje, printera dhe plotera në vlerën 536,000 lekë pa tvsh, Lot 2 “Shërbim mirëmbajtje servera në vlerën 1,548,000 lekë pa tvsh
7.Data e hapjes së tenderit 12.07.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lot 1 43,500 lekë Lot 2 264,000 lekë
10.Kohëzgjatja e kontratës Afati i shërbimit për tre Lotet referuar DT do jetë për një periudhë 1 vjeçare.	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër Për secilin Lot nga 1(një) operator Lot 1 P.S Lot 2 S.C	11. Ankimime Jo
11. Ankimime Jo	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje
14. Lidhja e kontratës Eshhtë nënshkruar kontrata nr.161/7prot., datë 22.09.2022 për lotin 1 “Shërbim mirëmbajtje fotokopje, printera	15.Zbatimi i kontratës Me procesverbalet e datës 02.11.2022 për faturimet nr.3392/2022 datë 02.11.2022, nr.3726/2022 datë 02.12.2022 dhe procesverbalin e datës 30.12.2022 për faturimin nr.4035/2022 janë marrë në dorëzim shërbimi për Lotin 2 nga zyrtari i ngarkuar për ndjekjen e kontratës z. A.D.	

dhe plotera në vlerën 536,000 lekë pa tvsh, me P.S shpk. Eshtë nënshkruar kontrata nr.161/8prot., datë 22.09.2022 për lotin 2 “Shërbim mirëmbajtje servera në vlerën 387,000 lekë pa tvsh, me S.C shpk.	
--	--

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit konstatohet:

Me shkresën nr. 161 prot., datë 02.02.2022 nga “Kërkesë për shërbim mirëmbajtje pajisje kompjuterike” nga përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit dhe serverave të miratuar nga drejtori i drejtorisë së teknologjisë së informacionit dhe Drejtori i Përgjithshëm për zhvillimin e kësaj procedure.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr. 11, datë nr.09.02.2022, “Për ngritjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit”. Fondi është përlllogaritur pas marrjes së ofertave nga tre OE. Komisioni i përbërë i përbërë nga z. I.D, përgjegjës në sektorin e administrimit të rrjetit dhe serverave, z. D.K, specialist në sektorin e prokurimeve dhe znj. A.D, përgjegjës në sektorin zhvillimit të programeve kompjuterike kanë mbajtur procesverbalin me datë 17.03.2022, ku është përlllogaritur fondi limit të ndarë në lote”:

-Lot 1 shërbim mirëmbajtje, fotokopje, printera dhe plotera në vlerën 579,500 lekë pa tvsh;

-Lot 2 shërbim mirëmbajtje servera në vlerën 1,812,000 lekë;

-Lot 3 shërbim riparim/mirëmbajtje bateri qendrore për serverat në vlerën 579,833.3 lekë pa tvsh. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga ana e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve nuk del qartë afati i shërbimit për Lotin 2 dhe Lotin 3.

- Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr. 161/2., datë 11.04.2022, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit limit total prej 2,971,333.3 lekë pa TVSH, procedurë e hapur e thjeshtuar me objekt “Shërbim mirëmbajtje pajisje kompjuterike”,e ndarë në lote dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga z. A.D, specialist në sektorin e cilësisë dhe metadatave, z. I.D, përgjegjës në sektorin e menaxhimit të rrjetit dhe serverave dhe znj. L.D, përgjegjës në sektorin e prokurimeve.

Me urdhrin nr.161/3 prot., datë 09.05.2022, është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar znj. M.A, z. A.B dhe z. D.K në kundërshtim me VKM nr. 285 neni 75 pika 4 ku citohet “Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla” pasi z. D.K është njëkohësisht edhe anëtar në komisionin e përlllogaritjes së fondit limit.

Me urdhrin nr.161/4 prot datë 04.07.2022 zëvendësohet znj. M.A me z. K.A.

Nga auditimi i Dokumenteve të Procedurës nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Njoftimi i shkurtuar i kontratës nuk ka datë e numër protokolli por veç firmën dhe vulën e titullarit ku ndër të tjera ka përcaktuar si datë të zhvillimit të procedurës.

Në dosje ndodhet procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit i firmosur nga njësia e prokurimit, datë 30.06.2022.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin e datës 26.07.2022 KVO u kualifikuan operatorët ekonomik pjesëmarrës konkretisht:

Për Lotin 1 Shërbim mirëmbajtje fotokopje, printera dhe plotera, oferta e P.S me vlerë 536,000 lekë pa tvsh.

Për Lotin 2 Shërbim mirëmbajtje servera , oferta e OE fitues S.C me vlerë 1,548,000 lekë pa tvsh. Me raportin përmbledhës nr.161/5 prot., datë 15.08.2022 KVO vlerëson procedurën dhe informon titullarin e AK për procedurën e ndjekur. Titullari i AK me shkresën nr.161/6 prot., datë 15.08.2022 procedurën e prokurimit, procedurë e hapur e thjeshtuar për dy lotet.

Për Lotin 1 Shërbim mirëmbajtje fotokopje, printera dhe plotera, oferta e P.S me vlerë 536,000 lekë pa tvsh.

Për Lotin 2 Shërbim mirëmbajtje servera , oferta e OE fitues S.C me vlerë 1,548,000 lekë pa tvsh.

- Nuk dokumentohet verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE para shpalljes së fituesit bazuar në VKM nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar neni 26 pika 6 *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”*. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Është nënshkruar kontrata nr.161/7 prot., datë 22.09.2022 për lotin 1 *“Shërbim mirëmbajtje fotokopje, printera dhe plotera”* në vlerën 536,000 lekë pa tvsh, me P.S shpk. Ky shërbim rezulton i faturuar me nr.11305/2022 dt.20.12.2022 në vlerën 643,200 lekë, por në dosjen e vënë në dispozicion nuk ka asnjë dokumentacion mbi marrjen në dorëzim të shërbimit.

Është nënshkruar kontrata nr.161/8 prot., datë 22.09.2022 për lotin 2 *“Shërbim mirëmbajtje servera”* në vlerën 387,000 lekë pa tvsh, me S.C shpk.

Formulari i njoftimit të fituesit dhe nënshkrimi të kontratës nuk ndodhen në dosjen e vënë në dispozicion.

Me procesverbalet e datës 02.11.2022 për faturimet nr.3392/2022 datë 02.11.2022, nr.3726/2022 datë 02.12.2022 dhe procesverbalin e datës 30.12.2022 për faturimin nr.4035/2022 janë marrë në dorëzim shërbimi për Lotin 2 nga zyrtari i ngarkuar për ndjekjen e kontratës z. A.D (likuiduar me urdhër shpenzimet respektive nr.1124 datë 06.12.2022, nr. 1125 datë 06.12.2022 dhe nr.1275 datë 30.12.2022). Likuidimi i faturimit nr.3392/2022 datë 02.11.2022 është bërë pas afatit 30 ditore.

Botimet e njoftimeve nuk ndodhen në dosjen e arkivuar vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Dosja e arkivuar nuk është administruar me rend kronologjik.(shih fletën e inventarit)

Dokumentacioni i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 *“Për arkivat”* i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ku citohet *“Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.*

Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhërat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje/rinovim licencash”, e ndarë në lote konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje/rinovim licencash”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” -Lot 1 shërbim mirëmbajtje, rinovim SAS në vlerën 3,900,000 lekë pa tvsh, REF-72230-06-12-2023 -Lot 2 shërbim mirëmbajtje rinovim Fortinet në vlerën 433,000 lekë pa tvsh REF-72232-06-12-2023 -Lot 3 rinovim ESRI në vlerën 3,783,333 lekë pa tvsh REF 75433-07-18-2023	2.Hartimi i kërkesës të detajuar me specifikime Me shkresën nr. 312 prot., datë 13.02.2023 nga “Kërkesë për shërbim mirëmbajtje/rinovim licencash”nga përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit dhe serverave	3.Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 312/2 prot., datë 31.03.2023 i përbërë nga: znj. N.P, përgjegjës në sektorin e prokurimeve, z. A.D, specialist në sektorin e administrimit të rrjetit dhe serverave dhe z. A.E, specialist në sektorin e çështjeve ligjore.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 312/3 prot., datë 31.03.2023 (i ndryshuar) i përbërë nga: znj. E.K, znj. L.G dhe z. A.D i ndryshuar me urdhrin nr.312/6 prot., datë 15.06.2023 ku zëvendësohet znj. L.G me znj. M.S.
5. Fondi Limit total (pa tvsh) 6,578,000 lekë 8,116,333 lekë (i rishikuar)	6. Oferta fituese (pa tvsh) Lot 1 I.S shpk me ofertën ekonomike 3,778,845 lekë pa tvsh Lot 2 C.P shpk me ofertën 400,070 lekë pa tvsh Lot 3 G. shpk me ofertën 3,760,000 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lot 1 121,155 lekë Lot 2 32,930 lekë Lot 3 23,333 lekë	
8.Data e hapjes së tenderit Për Lot 1 dhe 2 datë 23.06.2023 Për Lot 3 datë 31.07.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 (një) për secilin nga lotet	
11. Kohëzgjatja e kontratës Vlefshmëria e licencave 1 vit	13. Përgjigje Ankesës		14. Lidhja e kontratës Është nënshkruar kontrata nr.312/8 prot., datë 01.08.2023 për lotin 1 I.S shpk me vlerën 3,778,845 lekë pa tvsh. Është nënshkruar kontrata nr.1276/4 prot., datë 26.07.2023 për lotin 2 C.P shpk me vlerën 400,070 lekë pa tvsh. Është nënshkruar kontrata mes AK dhe G. shpk me nr.1276/8 prot., datë 22.08.2023 në vlerën 3,760,000 lekë pa tvsh
12. Ankimime Jo	15.Zbatimi i kontratës Me urdhër shpenzimet nr.844 datë 25.08.2023 është likuiduar shpenzimi i mirëmbajtjes /rinovim licence Lot 1 në vlerën 3,886,812 lekë dhe me urdhër shpenzimin nr.1745 datë		

	<p>12.12.2023 është likuiduar në vlerën 647,802 lekë. Me urdhër shpenzimet nr.845, datë 25.08.2023 është likuiduar shpenzimi i mirëmbajtjes /rinovim licence Lot 2 në vlerën 240,042 lekë dhe me urdhër shpenzimin nr.1530 datë 23.11.2023 është likuiduar në vlerën 240,042 lekë. Me urdhër shpenzimin nr.965 datë 20.09.2023 likuidohet marrja në dorëzim e licencave ekzistuese ESRI sipas procesverbalit datë 29.08.2023 në masën 4,512,000 lekë</p>
--	--

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit konstatohet:

Me shkresën nr. 312 prot., datë 13.02.2023 nga “Kërkesë për shërbim mirëmbajtje/rinovim licencash” nga përgjegjësi i sektorit të administrimit të rrjetit dhe serverave të miratuar nga drejtori i drejtorisë së teknologjisë së informacionit dhe Sekretari i Përgjithshëm për zhvillimin e kësaj procedure.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr. 20, datë nr.16.02.2023, "Për ngritjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit". Fondi është përlllogaritur pas marrjes së ofertave nga tre OE. Komisioni i përbërë nga z. I.D, përgjegjës në sektorin e administrimit të rrjetit dhe serverave, z. G.K, specialist në sektorin e administrimit të rrjetit dhe serverave dhe z. A.B, përgjegjës në sektorin e financës kanë mbajtur procesverbalin me datë 24.03.2023, ku është përlllogaritur fondi limit të ndarë në lote”:

- Lot 1 shërbim mirëmbajtje, rinovim SAS në vlerën 3,900,000 lekë pa tvsh;
- Lot 2 shërbim mirëmbajtje rinovim Fortinet në vlerën 433,000 lekë pa tvsh;
- Lot 3 rinovim ESRI në vlerën 2,245,000 lekë pa tvsh.

Nga ana e këtij komisioni nuk janë mbajtur deklaratat e konfliktit të interesit në kundërshtim me nenin 13 pika 5 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit”.

- Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr. 312/2 prot., datë 31.03.2023, është urdhëruar të kryhet prokurimi i fondit limit total prej 6,578,000 lekë pa TVSH, procedurë e hapur e thjeshtuar me objekt “Shërbim mirëmbajtje/rinovim licencash”, e ndarë në 3 lote dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga znj. N.P, përgjegjës në sektorin e prokurimeve, z. A.D, specialist në sektorin e administrimit të rrjetit dhe serverave dhe z. A.E, specialist në sektorin e çështjeve ligjore.

Me urdhrin nr.312/3 prot., datë 31.03.2023, është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga me anëtar znj. E.K, z. L.G dhe z. A.D i ndryshuar me urdhrin nr.312/6 prot., datë 15.06.2023 ku zëvendësohet znj. L.G me znj. M.S.

Nga auditimi i Dokumenteve të Procedurës nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Njoftimi i shkurtuar i kontratës nuk ka datë e numër protokoli e as firmë dhe vulë e titullarit ku ndër të tjera ka përcaktuar si datë të zhvillimit të procedurës datën 22.05.2023.

Në dosje ndodhet procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të procedurës i firmosur nga njësia e prokurimit, datë 04.05.2023, ndërsa DST janë të firmosura, vetëm nga dy anëtarët, i cili përmban kritere në mospërputhje me parashikimet ligjore.

Nga rekomandimet e APP-së u hartua një memo nr.312/4 prot., datë 17.05.2023 “Për saktësimin e kritereve të cilat ishin hartuar në kundërshtim me parashikimet ligjore”.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin e datës 26.05.2023 KVO arriti në përfundimin që ndodhet në kushtet e pamundësisë së kryerjes së procesit të vlerësimit të ofertave, pasi DST nuk janë hartuar në përputhje me parashikimet ligjore.

Me urdhrin nr.312/5 prot., datë 29.05.2023 titullari i AK, drejtori i përgjithshëm miraton anulimin e procedurës së prokurimit. Njoftimi i anulimit nuk ka numër protokollë por veç firmën dhe vulën e titullarit në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Një procesverbal vlerësimi fotokopje, i mbajtur me datë 27.06.2023 nga KVO-ja dhe raporti përmbledhës po me datë 27.06.2023 fotokopje ku kualifikohen operatorët për dy lotet.

Vijohet me prokurimin dhe me shkresën nr.312/7 prot., datë 04.07.2023 miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm fituesi për Lotin 1 I.S shpk me ofertën ekonomike 3,778,845 lekë pa tvsh dhe për Lotin 2 C.P shpk me ofertën 400,070 lekë pa tvsh.

- Nga grupi i auditimit konstatohet se nuk dokumentohet verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE para shpalljes së fituesit bazuar në VKM nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar neni 26 pika 6 "*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike*". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Formularët e njoftimit të fituesit paraprak datë 10.07.2023 ndodhen në dosje nuk kanë numër protokollë e as firmën dhe vulën e titullarit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Formularët e njoftimit të fituesit pas ankimit nuk kanë numër protokollë por veç firmën dhe vulën e titullarit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Është nënshkruar kontrata nr.1276/4 prot., datë 26.07.2023 për lotin 2 C.P shpk me vlerën 400,070 lekë pa tvsh.

Formulari i kontratës së nënshkruar për Lotin 2 ka datë 31.07.2023 por nuk ka numër dhe datë dhe firmë të titullarit të AK.

Është nënshkruar kontrata nr.312/8 prot., datë 01.08.2023 për Lotin 1 I.S shpk me vlerën 3,778,845 lekë pa tvsh.

Formulari i kontratës së nënshkruar për Lotin 2 ka datë 04.08.2023 por nuk ka numër dhe datë dhe firmë të titullarit të AK.

Me urdhrin nr.99 datë 01.08.2023 është caktuar zyrtari i ngarkuar për ndjekjen e kontratës për Lotin 2 z. G.K.

Me urdhër shpenzimet nr.844 datë 25.08.2023 është likuiduar shpenzimi i mirëmbajtjes /rinovim licence Lot 1 në vlerën 3,886,812 lekë dhe me urdhër shpenzimin nr.1745 datë 12.12.2023 është likuiduar në vlerën 647,802 lekë.

Me urdhër shpenzimet nr.845, datë 25.08.2023 është likuiduar shpenzimi i mirëmbajtjes /rinovim licence Lot 2 në vlerën 240,042 lekë dhe me urdhër shpenzimin nr.1530 datë 23.11.2023 është likuiduar në vlerën 240,042 lekë.

Për Lotin 3 në dosjen e vënë në dispozicion ndodhet një njoftim anulimi i cili nuk ka numër protokollë por veç firmën dhe vulën e titullarit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Botimet e njoftimeve nuk ndodhen në dosjen e arkivuar vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Me urdhër nr.90 datë 06.07.2023 nga titullari i AK ' *Për ngritjen e komisionit të përllogaritjes e FL*', i përbërë nga z. I.D, znj. N.P, z. A.B. Ky komision hartoi një përllogaritje të re, me datë 13.07.2023 në masën 3,783,333 lekë pa tvsh.

Nga ana e këtij komisioni nuk janë mbajtur deklaratat e konfliktit të interesit në kundërshtim me nenin 13 pika 5 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit”.

Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr. 1276/2 prot., datë 14.07.2023, është urdhëruar të kryhet prokurimi i fondit limit total prej 3,783,333 lekë pa TVSH, procedurë e hapur e thjeshtuar me objekt “Rinovim licencash”, ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga znj. N.P, përgjegjës në sektorin e prokurimeve, z. A.D, specialist në sektorin e administrimit të rrjetit dhe serverave dhe z. A.D, specialist në sektorin e prokurimeve.

Me urdhrin nr.1276/3 prot., datë 14.07.2023, është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë me anëtar z. A.D, znj. M.S dhe z. A.E.

Me shkresën nr.1276/7 prot., datë 10.08.2023 është miratuar nga titullari i AK fituesi me vlerën 3,760,000 lekë pa tvsh, sipas raportit përmbledhës nr.1276/6 prot., datë 10.08.2023 për procedurën e Lot 3, i cili është zhvilluar me datë 31.07.2023. Me njoftimin e datës 10.08.2023 pa numër protokollit është miratuar njoftimi i fituesit pas përfundimit të afatit të ankimit.

Kontrata mes AK dhe G. shpk është nënshkruar me nr.1276/8 prot., datë 22.08.2023.

Me urdhrin nr.1276/9 prot, datë 28.08.2023 ‘Për përcaktimin e personit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt rinovim i licencave ekzistuese ESRI’ është caktuar zyrtari i ngarkuar për ndjekjen e kontratës për Lotin 3 z. L.S.

Me urdhër shpenzimin nr.965 datë 20.09.2023 likuidohet marrja në dorëzim e licencave ekzistuese ESRI sipas procesverbalit datë 29.08.2023 në masën 4,512,000 lekë.

Dosja e arkivuar nuk është administruar me rend kronologjik.(shih fletën e inventarit).

Dokumentacioni i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 ‘Për arkivat’ i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ku citohet ‘Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemen e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhërat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Dosja e prokurimit në SPE për Lot 1, Lot 2, Lot 3 rezultojnë të paarkivuara në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, udhëzimi nr.2597 prot., dt.28.03.2024.

8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje printera”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje printera”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim REF-98674-06-21-2021	2.Hartimi i kërkesës të detajuar me specifikime Urdhër për komisionin të përlogaritjes së fondit limit nr.29 dt.29.04.2021	3. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 741/1., datë 28.05.2021 i përbërë nga: Znj. A.K z. R.P z. K.M	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.741/2 prot., datë 28.05.2021 i përbërë nga: z. I.D , z. L.L dhe z. A.D
5. Fondi Limit total (pa tvsh) 1,750,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 1,695,000 lekë		7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 55,000 lekë
8.Data e hapjes së tenderit 02.07.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit		10. Operatorët Ekonomike <i>P.S shpk</i>
11. Kohëzgjatja e kontratës 14 ditë nga nënshkrimi i kontratës			
12. Ankimime S'ka	13. Përgjigje Ankesës		14. Lidhja e kontratës - Është nënshkruar kontrata nr.741/5prot., datë 30.09.2021 mes drejtorit të përgjithshëm dhe OE P.S në vlerën 1,695,000 lekë pa tvsh.
15. Zbatimi i kontratës:	Me procesverbalin e datës 12.10.2021 është marrë në dorëzim malli sipas urdhrin për krijim komisioni marrjes në dorëzim dhe likuiduar me urdhër shpenzimin nr.1175 dt.02.12.2021		

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit konstatohet:

Me shkresën e datës 22.04.2021 nga “Kërkesë për blerje printera” nga specialisti i sektorit të administrimit të rjetit dhe serverave të miratuar nga drejtori i drejtorisë së teknologjisë së informacionit dhe Drejtori i Përgjithshëm për zhvillimin e kësaj procedure.

Bashkëlidhur kërkesës është informacioni mbi llojet e tonerave dhe sasinë.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr.29 dt.29.04.2021, "Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit". Fondi është përlogaritur pas marrjes së ofertave nga 3 (tre) OE.

- Me urdhrin e prokurimit të znj. E.Dh, Drejtor i Përgjithshëm, nr.741/1, datë 28.05.2021, ka urdhëruar të kryhet prokurimi i fondit total prej 1,750,000 lekë pa TVSH, me objekt “Blerje printera”, dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga Znj. A.K, drejtor I drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit, z. R.P, specialist në sektorin e menaxhimit të bazave të të dhënave, z. K.M, specialist në sektorin e prokurimeve.

Me urdhrin nr.741/2 prot., datë 28.05.2023, është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar z. I.D, z. L.L dhe z. A.D.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës nuk ka datë e numër protokolli por veç firmë dhe vulë të titullarit të autorizuar, nuk ka përcaktuar datë e zhvillimit të procedurës datë 02.07.2021.

Eshtë mbajtur procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit firmosur vetëm nga një anëtar.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me raportin përmbledhës nr.741/3 prot., datë 26.07.2021 KVO vlerëson procedurën dhe informon titullarin e AK për procedurën e ndjekur. Titullari i AK me shkresën nr.741/4 prot., datë 26.07.2021 miraton procedurën e prokurimit, *procedurë e hapur e thjeshtuar*.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar ofertat me dt.08.07.2021 dhe nuk ka nënshkruar më parë deklaratën e konfliktit të interesit në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve.

Njoftimi i fituesit nuk ka datë e numër protokollit por veç firmë dhe vulë të titullarit të AK.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar si dhe botimet e njoftimeve nuk ndodhen në dosjen e arkivuar vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Në dosje nuk dokumentohet gjithashtu formulari për zbatimin dhe raportimin e zbatimit të kontratës në kundërshtim me nenin 124 pika 2 e 3 dhe nenin 125 të ligjit 162/2020 ‘Për prokurimin publik’.

Kontrata nr.741/5 prot., dt.30.09.2021 është nënshkruar mes operatorit fitues dhe titullarit të AK-së në vlerën 1,695,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin e datës 12.10.2021 është marrë në dorëzim malli sipas urdhrit për krijim komisioni marrjes në dorëzim, faturës nr.3779/2021 dt.12.10.2021 dhe likuiduar me urdhër shpenzimin nr.1175 dt.02.12.2021.

Në SPE kjo procedurë rezulton e papërfunduar në kundërshtim me udhëzimet e APP-së.

Dokumentacioni i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 ‘Për arkivat’ i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ku citohet ‘Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin ‘Republika e Shqipërisë’, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën ‘në përgjigje’ ose ‘vijim të shkresës’ (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhërat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës ‘në përgjigje’ ose ‘në vijim të shkresës’. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.654/19 prot., datë 02.09.2024, protokolluar në KLSH me nr. 505/5, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:--Sa i takon procedurës ‘Shërbimi i monitorimit mediatik’, citohet se është i domosdoshëm pasi specialisti i monitorimit të mediave nuk ka vetëm detyrë monitorimin e mediave por dhe detyra të tjera funksionale si raportimi i tyre. Specialisti i monitorimit të shtypit është përgjegjës për përdorimin e sistemit për të mbledhur dhe analizuar informacionin nga mediat në mënyrë që të krijojë raportet e kërkuara. Ky proces përfshin filtrimin dhe interpretimin e të dhënave. -Referuar rekomandimit të KLSH-së me nr.19.1, nr.19.1 dhe 19.3 strukturat përgjegjëse do të ndërmarrin masat e nevojshme për dokumentimin, zyrtarizimin, protokollimin dhe arkivimin e çdo dokumenti që lidhet me procedurat e prokurimit. - Referuar rekomandimit nr. 20.1 titullari i INSTAT do të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune për verifikimin, analizimin dhe dokumentimin e zbatimit të kontratës. Referuar rekomandimit nr. 21.1 titullari i INSTAT do të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune për verifikimin, analizimin dhe dokumentimin e zbatimit të kontratës. - Referuar rekomandimit nr. 22.1 dhe 22.2 strukturat përgjegjëse do të marrin masat e nevojshme të menjëhershme për përgatitjen

e dokumentacionit ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative dhe plotësimi i praktikave për pagesë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:- -Në lidhje me komentit tuaj mbi procedurën “Shërbimi i monitorimit mediatic”, citohet se është i domosdoshëm pasi bazuar në përshkrimet e punës, specialisti i monitorimit të mediave nuk ka vetëm detyrë monitorimin e mediave por dhe detyra të tjera funksionale si raportimi i tyre. Specialisti i monitorimit të shtypit është përgjegjës për përdorimin e sistemit për të mbledhur dhe analizuar informacionin nga mediat në mënyrë që të krijojë raportet e kërkuara. Ky proces përfshin filtrimin dhe interpretimin e të dhënave .Për rrjedhojë, observacioni nuk merret në konsideratë.

-Sa më sipër, nga subjekti i audituar janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna, të cilat janë pranuar dhe nga institucioni i INSTAT do të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre.

2.5 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Institutin e Statistikave (në vijim INSTAT) u realizua bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Në kuptimin e ligjit të sipërcituar, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Referuar Manualit të MFK, në nenin 19, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit” citohet se: *“Titullarët e njësisë të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:*

- 1. Mjedisi i kontrollit.*
- 2. Menaxhimi i riskut.*
- 3. Veprimtaritë e kontrollit.*
- 4. Informacioni dhe komunikimi.*
- 5. Monitorimi.”*

1. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se,

institucioni ka hartuar dhe zbaton një kod etike, miratuar me vendimin nr. 4, datë 24.05.2019 “Për miratimin e Kodit të Etikës të Institucionit të INSTAT”.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

INSTAT është person juridik i pavarur në varësi të Kuvendit të Shqipërisë i cili siguron që statistikat janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas Programit të Statistikave Zyrtare si dhe jep ndihmën profesionale për interpretimin e drejtë të tyre, me seli qendrore në Tiranë, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij, si dhe është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare dhe koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor. Organika dhe struktura e INSTAT përcaktohet me vendim të Kuvendit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, për institucionet e pavarura.

Struktura e INSTAT e planifikuar dhe realizuar për periudhën objekt auditimi është si më poshtë vijon:

Për vitin 2021 Plani për punonjës në organikë ka qenë 236, ndërsa fakti në Dhjetor ka qenë 226;

Për vitin 2022 Plani për punonjës në organikë ka qenë 236, ndërsa fakti në Dhjetor ka qenë 218;

Për vitin 2023 Plani për punonjës në organikë ka qenë 236, ndërsa fakti në Dhjetor ka qenë 219.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

INSTAT deri më 28.12.2023, për vitet 2021, 2022 dhe 2023 ka kryer funksionet e saj me 236 punonjës, duke u bazuar në organigramën e miratuar me vendim të Kuvendit Nr. 127, datë 29.12.2018, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave (INSTAT)”. Sipas kësaj strukture, INSTAT është e organizuar mbi bazën e 13 drejtorive si Drejtoria Komunikimit dhe Publikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, Drejtoria e Llogarive Kombëtare, Drejtoria e Statistikave Ekonomike, Drejtoria e Statistikave Sociale, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Statistikave të sektorit real, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe mbledhjes së të dhënave, Drejtoria e Statistikave rajonale dhe Gjeoinformacionit, Drejtoria e Përgjithshme e shërbimeve mbështetëse dhe koordinimit, Drejtoria e Financës dhe Projekteve, Drejtoria Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore. Referuar statistikave, vihet re se në katërmujorin e tretë të vitit 2021 organika e institucionit nuk është plotësuar me 10 punonjës, në katërmujorin e tretë të vitit 2022 me 18 punonjës, dhe në katërmujorin e tretë të vitit 2023 me 17 punonjës, kjo për faktin se ka pasur largime nëpërmjet procedurës së dorëheqjes, pezullimit të statusit si dhe emërimesh në institucione të tjera, për të cilët është raportuar në Regjistrin Qendror të Personelit (HRMIS), dhe ka filluar procedura e rekrutimit për punonjës të rinj nga DAP.

Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna

INSTAT ka të implementuar Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) i cili i ndërtuar për të ndihmuar institucionet shtetërore në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Sistemi përmban të dhëna dhe informacion të zgjeruar për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet. Në dosjet personale të të punësuarve reflektohen të dhëna për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, pagat dhe sigurimet. HRMIS përmban informacion për strukturën dhe organikën e institucioneve. Strukturat e hedhura në sistem plotësohen nga personi përgjegjës i institucionit, bazuar në VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve

të personelit e të regjistrit qendror të personelit” parashikojnë se sistemi HRMIS duhet të ndërveprojë me bazat e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Sistemit të Thesarit në Ministrinë e Financave etj. HRMIS shërben si burim planifikimi dhe informacioni për pagat dhe pagesat e nëpunësve publikë, nëpërmjet ndërveprimit me Sistemin e Thesarit.

Gjatë periudhës objekt auditimi ka pasur disa procedura rekrutimi dhe disa procedura largimi. Lidhur me aktivitetin e aparatit për këto procedura paraqiten në pjesën e mëposhtme:

Emërimet

Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e INSTAT, drejtues dhe specialistë rregullohen në bazë të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, marrëdhëniet e punës për punonjësit e tjerë që nuk janë nëpunës civil rregullohen në bazë të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, në INSTAT janë emëruar gjithsej 28 punonjës.

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, në INSTAT janë emëruar gjithsej 39 punonjës.

Për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, në INSTAT janë emëruar gjithsej 42 punonjës.

Largimet

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në INSTAT i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 16 punonjësve, për arsyet e mëposhtme: Dorëheqje 5, Lëvizje paralele/Ngritje ne detyrë ne tjetër institucion 4, dalje në pension 2, kërkesë pezullim statusi 4, ndërrim jete 1.

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në INSTAT i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 37 punonjësve, për arsyet e mëposhtme: Dorëheqje 14, dalje në pension 7, kërkesë pezullim statusi 13, transferim i përkohshëm 3

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në INSTAT i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 24 punonjësve, për arsyet e mëposhtme: Dorëheqje 13, Lëvizje në tjetër institucion 1, dalje në pension 6, kërkesë pezullim statusi 2

Vendimet gjyqësore

Sa i takon marrëdhënieve të punës, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 – 31.12.2023 ka 1 çështje gjyqësore ne Gjykatën Administrative te Apelit, e cila ka vendim të formës së prerë rikthim ne detyrë më datë 03.07.2023. Grupi i Auditimit Shqyrtoi shpenzimet për ekzekutim te vendimeve gjyqësore për largim nga puna, te cilat janë në total 3,913,763 lekë.

Procedura e rekrutimit të punonjësve me kontratë

Gjatë planifikimit të PBA, INSTAT parashikon anketat të cilat do të zhvillohen në vitet në vijim. Rrjedhimisht duhet të planifikojë dhe numrin e punonjësve që do të angazhohen për mbarëvajtjen e këtij procesi. Për çdo anketë afatshkurtër dhe afatgjatë (1-vjeçare) që INSTAT zhvillon, kontraktin të njëjtët punonjës, të cilët kategorizohen si “anketues”, “teknik të specialiteteve të ndryshëm”, “kontroll terreni”, “operatorë” etj. Instat rekruton këto punonjës nga një databazë që administron ndër vite për mbarëvajtjen e procesit.

Nga grupi auditimit u konstatua se INSTAT nuk ka publikuar në faqen zyrtare shpalljet për vende vakante në kuadër të realizimit të këtyre anketave, në kundërshtim me Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe manualin e MFK-së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm” ku përcakton qartë se: Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;

- Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;

Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;

- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për:

- Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune;

- Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës;

- Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta etj.

Dosjet e personelit

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore duke u bazuar në VKM nr.117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, e cila përcakton se:

1. *Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.*

2. *Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrive, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.*

Sa i përket dokumenteve që duhet të jenë në dosjet e të punësuarve, baza ligjore në fuqi përcakton se:

Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

-Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar.

-Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes.

-Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë);certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse “nota mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i diplomimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfutuar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës;

akti i dhënies së masës disiplinore; librezat e punës; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 11 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi.

Gjatë auditimit të dosjeve të kampionuara të personelit, janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në dokumentacion, si nga mungesa e dokumenteve plotësisht ose mungesa e noterizimit, të paraqitura si më poshtë:

- Në të gjitha dosjet ka fletë inventari të dosjes së të punësuarit, por nuk janë të firmosura nga nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore

- Në disa dosje mungon Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (Dëshmia e Penalitetit), në kundërshtim me Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreu IV, neni 21, pika d.

- Bazuar në VKM Nr. 124, datë 17.02.2016 (i ndryshuar me VKM nr 747, datë 19.12.2018) “ Për pezullimin dhe lirim nga Shërbimi Civil” kreu III, pika 23, paragrafi 2 “Nëpunësi civil paraqet pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentin e shëndetit në punë, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda datës 10 janar të çdo viti”. Nga auditimi i kampionuar rezulton që raportet mjeko-ligjor nuk janë të përditësuar.

Në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit , VKM nr 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, dokumentacioni në dosjet e personelit nuk është i plotë.

Veprimtaria e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues është organ i cili vepron brenda INSTAT-it dhe ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit, të propozojë planet për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave të tij, si dhe t’i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT udhëzime e standarde, të cilat sigurojnë zbatimin e parimeve statistikore nga Sistemi Kombëtar Statistikor. Detyrat specifike të bordit përcaktohen në nenin 20 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”.

Bordi Drejtues përbëhet nga nëpunësit civilë të INSTAT-it, të cilët janë të paktën të nivelit të mesëm drejtues, duke iu referuar strukturës organizative të miratuar me vendimin e Kuvendit. Në interes të transparencës me publikun si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Peer Review, veprimtaria e Bordit Drejtues është publikuar në faqen zyrtare të internetit të INSTAT.

Marrëdhëniet e pagave

Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e INSTAT, drejtues dhe specialistë rregullohen në bazë të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Procedura e rekrutimit të stafit mbështetës në INSTAT është realizuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve Prill, Nëntor, Dhjetor të vitit 2021, Qershor, Nëntor, Dhjetor të vitit 2022 dhe Gusht, Nëntor, Dhjetor të vitit 2023. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se përlllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listëprezencat në punë, të përgatitura nga Drejtorët e çdo Drejtorie dhe përgjegjësit respektiv, si dhe janë nënshkruar dhe nga Sekretari i Përgjithshëm. Urdhër shpenzimet për pagesat e

anketuesve, paguar me kapitullin 6, konstatohet se nuk janë bashkëlidhur dokumentet e cituara ne urdhër-shpenzim, si borderotë, listëprezencat, veprime ne kundërshtim me udhëzimin 30.

Në Sektorin e Financës, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Nga ana e Grupit të Auditimit është konstatuar se në INSTAT ka një rregullore të brendshme të përditësuar, ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre veprime këto në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në INSTAT, burimet njerëzore menaxhohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer dhe janë përfshirë në dosje vlerësimet e punonjësve për vitet 2021-2023.

e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimi, u konstatua se nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore në INSTAT janë paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, veprim në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”. Punonjësit e institucionit kanë kryer trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, kryesisht të organizuara nga ASPA, për të cilat është siguruar informacion mbi trajnimet dhe ndjekjen e tyre nga ana e stafit të INSTAT.

2. MENAXHIMI I RISKUT

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Nga auditimi u konstatua se janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut. INSTAT ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, veprim në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2, neni 21 “Menaxhimi i Riskut”, ku citohet:...“*Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të risku. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*”, si dhe me udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3.2.1 ku citohet:... “*Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe strategjisë. Kjo përfshin: Menaxhimin efektiv të riskut*”.3.2.2 “*Nëpunësi*

autorizues/koordinatori i riskut ka përgjegjësi për: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut; Vlerësimin e sistemit të MR (...)”.

Mbështetur në nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me shkresën nr. 2267/1 prot., datë 23.02.2024 INSTAT ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE, Pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së nëpërmjet të cilit synohet ndërgjegjësim i mëtëjshëm mbi rëndësinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm; Planin e veprimit; si dhe Regjistrin e riskut për vitin 2023.

Nga auditimi i regjistrit të riskut për vitin 2021, 2022 dhe 2023, i cili përmbledh regjistrat e risqeve dhe planet e veprimit së të gjithë strukturave të INSTAT, u konstatua se janë përgatitur dhe dërguar te NA, regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse, veprim ky në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar pika neni 11, ku citohet... “Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:

2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2023, 2022 dhe 2021 rezultoi se INSTAT ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS-së, i cili duhet të mblihdet të paktën 4 herë në vit, veprime këto në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika nr. 1, e nenit 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, si dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, së, e cila përcakton se: “GMS duhet të mblihdet të paktën katër herë në vit. Vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren si grup, (...).Vendimet e GMS duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.”

Me anë të Urdhrit të DP nr.21 datë 10.03.2021 “Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik në INSTAT”, u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe anëtarët janë caktuar sipas funksioneve si vijon: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive të Përgjithshme të Prodhimit Statistikor, DP i TI dhe Mbledhjes së të Dhënave si dhe DP i Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit. Nga auditimi u konstatua se ky urdhër nuk është rishikuar për çdo vit për të përcaktuar personat përgjegjës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, ku përcakton se “GMS është përgjegjës të sigurojë se regjistri i riskut për programe/objektiva specifik rishikohet jo më pak se dy herë në vit”.

3. VEPRIMTARITË E KONTROLLIT

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve si dhe mos zbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti.

Ndarja e detyrave në INSTAT rregullohet me anë të Rregullores së Brendshme, miratuar nga Bordi Drejtues me vendim nr. 5, datë 09.07.2019, përditësuar me vendimin nr. 7 datë 04.07.2022. INSTAT nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e saj, në kundërshtim me përcaktimet e pikave nr. 2 dhe 3, të nenit 16, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin

Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet... “2. *Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.* 3. *Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi*”

Grupi i auditimit ka audituar magazinën kryesore të INSTAT, duke konstatuar se:

-Procesi i hyrje-daljeve nga magazina mbahet me libër magazine manualisht, dhe jo me sistemin Alpha Web, të cilin INSTAT përdor për mbajtjet e kontabilitetit të njësisë;

- Dalja e inventarit nga magazina bëhet në fund të muajit, dhe jo për çdo kërkesë për tërheqje malli;

-Çdo vit bëhet mbartje e gjendjes së vitit paraardhës të inventarit qarkullues, duke hapur një libër të ri magazine, dhe rrjedhimisht sjell vështirësi në identifikimin e vjetërsisë së artikullit në magazinë, me qëllim menaxhimin më efektiv të magazinës;

- Artikuj të njëjtë të inventarit janë mbajtur në kartela të ndryshme, duke sjellë vështirësi në menaxhimin me efektivitet të magazinës.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 37 ku citohet: “Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)”.

4. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë. Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Drejtuesit e programeve kanë raportuar tek nëpunësi autorizues për ecurinë e veprimtarisë, planeve të punës dhe objektivave të vendosur për realizimin e politikave, duke hartuar raporte monitorimi periodike në varësi të punës. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet e tjera, pa përrjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. INSTAT ka faqen e saj zyrtare në internet dhe nëpërmjet kësaj të fundit të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth veprimtarisë së institucionit. Punonjësit e INSTAT janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij (@*instat.gov.al*).

5. MONITORIMI

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës.

INSTAT për vitin 2021, ka caktuar znj. K.H (Sekretar i Përgjithshëm) si Nëpunës Autorizues, me anë të shkresës nr. 606/1 prot., datë 25.01.2021, për vitin 2022 dhe në vazhdim ka caktuar z. A.Ç (Sekretar i Përgjithshëm), dhe z. K.Sh (Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse dhe

Koordinimit) si Nëpunës Zbatues me anë të shkresës nr.1469/1 prot., datë 08.02.2022. Sa më sipër, në përmbushje të kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”.

Grupit të auditimit nuk i është vënë ne dispozicion botimi në fletoren zyrtare i delegimit të kompetencave për Autoritetin Kontraktor për vitin 2021, në kundërshtim me ligjin nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” kreu II, neni 29.

INSTAT, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar dhe dërguar pyetëtorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2021 me shkresën nr. 2063/1 prot., datë 28.02.2022, për vitin 2022 me shkresën nr. 2156/1 prot., datë 22.02.2023, për vitin 2023 me shkresën nr. 2267/1 prot., datë 23.02.2024, drejtuar strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me anë të shkresave të cituara, INSTAT ka dërguar deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportet për funksionimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Struktura e raportimit respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”

Sa i takon raporteve të monitorimit, konstatohet se INSTAT ka hartuar raportet e monitorimit 4 mujore të konsoliduara, por nga ana institucioneve të varësisë (Zyrat Rajonale Statistike), si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raporte monitorimi 4 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22 të MFE, datë 17.11.2016 dhe nr.14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, shtojca nr.3 dhe kapitulli 4, pika 49 dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit”, kapitulli VI, pika 271.

6.2. Mbi Vlerësimin e Auditimit të Brendshëm

6.2.1. Vlerësimi i auditimit të brendshëm

Nga auditimi i kryer në Sektorin e Auditimit të Brendshëm (SAB), të Institutit të Statistikave (INSTAT), rezultoi se:

6.2.1.1. Planifikimi dhe miratimi i Programit Vjetor dhe Planit Strategjik

Sa i takon Planit Strategjik dhe Vjetor të përgatitur nga njësia e AB, paraqitet si vijon:

Viti 2021

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NJQH/AB.

Plani strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor 2021 janë miratuar nga Zëvendës Kryetari i Bordit Drejtues të INSTAT me shkresën nr. 1414/1 prot., datë 08.10.2020.

Me anë të shkresës nr. 1414/2 prot., datë 09.10.2020, INSTAT ,ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Plani Strategjik për periudhën 2021 – 2023, përbëhet nga :

- Vlerësimi i nivelit të riskut për njësitë për vitin 2021 – 2023;
- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2021 – 2023;
- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2021;
- Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2021;
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2021.

Bazuar në Planin Strategjik 2021-2023 janë parashikuar gjithsej 22 angazhime auditimi në drejtoritë përkatëse dhe zyrat rajonale. Në planin vjetor 2021, DAB ka parashikuar gjithsej 7 angazhime auditimi, nga të cilat 5 auditime përputhshmërie dhe 2 auditime performance.

Plani Vjetor i vitit 2021 është ndryshuar si rrjedhojë e pandemisë Covid-19 me shkresën nr. 1414/3 prot., datë 31.03.2021 miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT. Me anë të shkresës nr. 1414/4 prot., datë 31.03.2021, INSTAT ka dërguar shkresën për ndryshimin e Planit Vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Në ndryshimin e Planit Vjetor 2021, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka planifikuar 5 angazhime auditimi, nga të cilët 1 auditim përputhshmërie, 3 auditime performance dhe 1 auditim të kombinuar:

- Auditimet e performancës janë programuar në Drejtorinë e Statistikave të Sektorit Rural, Sektori i Projekteve(Njësia IPA) si dhe auditimi me temë “Ndikimi i forcave madhore dhe rasti faktor (Covid-19) në INSTAT”
- Auditimi i përputhshmërisë në Drejtorinë e Financës dhe Projekteve (Prokurime);
- Auditimi i kombinuar në strukturat e audituara gjatë vitit 2021 në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

Sa më sipër, nga ana e Sektorit të Auditimit të Brendshëm janë planifikuar dhe realizuar auditimet si vijon:

- 1: Drejtoria e Statistikave të Sektorit Rural
- 2: Drejtoria e Financës dhe Projekteve(Prokurime)
- 3: Sektori i Projekteve (Njësia IPA)
- 4: Ndikimi i Forcave Madhore dhe Rasti Fator(Covid-19) në INSTAT
- 5: Angazhimi i zbatimit të rekomandimeve

Nga 5 auditime të planifikuara janë realizuar 5 prej tyre.

Viti 2022

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjQH/AB.

Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor 2022 janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 1639 prot., datë 18.10.2021.

Me anë të shkresës nr. 1639/1 prot., datë 18.10.2021, INSTAT, ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

-Plani Strategjik për periudhën 2022 – 2024, përbëhet nga :

- Vlerësimi i nivelit të riskut për njësitë për vitin 2022 – 2024;
- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2022 – 2024;
- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2022;
- Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2022;
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2022.

Bazuar në Planin Strategjik 2022-2024 janë parashikuar gjithsej 21 angazhime auditimi në drejtoritë përkatëse dhe zyrat rajonale. Në planin vjetor 2022, DAB ka parashikuar gjithsej 6 angazhime auditimi, nga të cilat 6 auditime të kombinuara, 1 auditim të teknologjisë së informacionit, 3 auditime performance dhe 1 auditim përputhshmërie, si vijon:

- Auditimi i performancës në Drejtorinë e Statistikave Ekonomike, Njësinë e Fondeve IPA dhe në Drejtorinë e Komunikimit dhe Publikimeve.
- Auditimi i teknologjisë së informacionit në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.
- Auditimi i përputhshmërisë në Zyrën Rajonale Dibër.
- Auditimi i kombinuar në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga AB.

Sa më sipër, nga ana Sektorit të Auditimit të Brendshëm janë planifikuar dhe realizuar auditimet si vijon:

- 1: Drejtoria e Statistikave Ekonomike
- 2: Njësia e Fondeve IPA
- 3: Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
- 4: Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve
- 5: Zyra rajonale Dibër
- 6: Zbatimi i rekomandimeve

Nga Sektori i Auditimit të Brendshëm, për vitin 2022 janë planifikuar 6 auditime, të cilat janë realizuar 100%.

Viti 2023

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjQH/AB.

Plani strategjik 2023-2025 dhe plani vjetor 2023 janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT me shkresën nr. 1668/1 prot., datë 14.10.2022.

Me anë të shkresës nr. 1668/2 prot., datë 14.10.2022, INSTAT, ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë së Financave dhe Ekonomisë. Me anë të shkresës nr. 1668/4 prot., datë 22.02.2023, INSTAT ka dërguar shkresën për ndryshimin e Planit Vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Në ndryshimin e Planit Vjetor 2021, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka planifikuar 5 angazhime auditimi, nga të cilët 1 auditim përputhshmërie, 3 auditime performance dhe 1 auditim të kombinuar.

Plani Strategjik për periudhën 2023 – 2025, përbëhet nga :

- Vlerësimi i nivelit të riskut për njësitë për vitin 2023 – 2025;
- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2023 – 2025;
- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2023;
- Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2023;
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2023.

Bazuar në Planin Strategjik 2023 – 2025 janë parashikuar gjithsej 20 angazhime auditimi në drejtoritë përkatëse dhe zyrat rajonale. Në Planin Vjetor 2023, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka parashikuar gjithsej 5 angazhime auditimi, nga të cilat 1 auditim përputhshmërie, 3 auditime performance dhe një auditim të kombinuar.

Sa më sipër, nga ana e INSTAT janë planifikuar dhe realizuar auditimet si vijon:

- 1: Drejtoria e Financës dhe Projekteve (Sektori i Prokurimeve)

- 2: Zyra rajonale statistikore Korçë
- 3: Zyra rajonale statistikore Durrës
- 4: Zyra rajonale statistikore Tiranë
- 5: Zbatimi i rekomandimeve

Burimi: INSTAT

Nga DAB për vitin 2023 janë planifikuar 5 auditime, të cilat janë realizuar 100%.

6.2.1.2. Kapacitetet audituese të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm

Struktura e Auditimit të Brendshëm në INSTAT është e organizuar në rang Sektori dhe përmban në organikën e saj një përgjegjës sektori dhe 2 auditues .

Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2021, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka funksionuar me strukturë të paplotësuar, duke pasur 1 vend vakant në pozicionin e audituesit. Gjatë vitit 2022 dhe vitit 2023 SAB ka funksionuar me strukturë të plotë.

Punonjësit e DAB kanë arsim bazë: përgjegjësi i sektorit është i diplomuar në kontabilitet të integruar të nivelit II në Universitetin e Kajros ,Egjypt dhe 2 audituesit janë diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Drejtësisë, dhe të gjithë punonjësit janë të pajisur me certifikatën “Auditues i Brendshëm në sektorin publik”. Pra, punësimi i tyre është bërë në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Njësia e auditimit funksionon në mënyrë të pavarur dhe raporton drejtpërdrejtë tek titullari i institucionit (INSTAT) dhe tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Karta e Auditimit.

Në vlerësim me përputhshmërinë e zbatimit të nenit 14, “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm”, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, nga auditimi u konstatua se Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm ka hartuar “Kartën e Auditimit” dhe është miratuar me urdhrin nr. 743/5, datë 29.06.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT.

Zbatimi i procedurave në dokumentimin e punës, evadimi, ruajtja dhe arkivimi i tyre.

Grupi i auditimit shqyrtoi për vlerësim, 4 dosje me zgjedhje të rastësishme të angazhimeve të kryera nga SAB për periudhën objekt auditimi. Dosje të subjekteve:

- Sektori i Prokurimeve;
- Drejtoria e Komunikimit dhe e Publikimeve;
- Njësia e Fondeve IPA;
- Zyra Rajonale Statistikore, Tiranë.

Nga auditimi u konstatua se për çdo angazhim, grupet e punës kanë krijuar një dosje të veçantë, kanë grumbulluar informacionet e nevojshme për përgatitjen e Raporteve të Auditimit. Audituesit i kanë analizuar informacionet e grumbulluara nëpërmjet metodave dhe teknikave të përdorura të auditimit, që janë gjykuar më të përshtatshme dhe të besueshme për subjektin. Në dosjet e auditimit u gjenden të administruara e të firmosura, të gjitha dokumentet sipas modelit të Formatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, janë kryer vlerësimet e riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, janë organizuar takimet fillestare me subjektet, janë bërë ndarjet e detyrave për çdo auditues, si dhe pyetësorët e dhënë nga grupet e auditimeve, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit të miratuar. Gjithashtu, u konstatua se janë respektuar afatet për dërgimin e projektraportit dhe raportit përfundimtar të auditimit, në përputhje me kërkesat e Manualit për Auditin e Brendshëm,

i ndryshuar; si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Grupet e auditimit pas angazhimeve në terren, në zbatim të pikës 4.1.12. Hapi 11: “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”, Kapitulli IV, i Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar; kanë përcjellë në subjektet e audituara, së bashku me raportin përfundimtar edhe plan veprimin e sugjeruar për realizimin e rekomandimeve. Në zbatim të standardeve të Kapitullit VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm”, 4.1.10. Hapi 9: “Rishikimi i punës së Auditimit” në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar; i cili citon: Sigurimi i cilësisë ka rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet rishikimit duhet të sigurohet nëse puna e AB është kryer në përputhje me Standarde. Në vlerësim të përputhshmërisë me këtë standard, nga auditimi u konstatua se dokumenti “Rishikimi i Cilësisë së Punës” për dosjet e përzgjedhura, ishte në përputhshmëri të plotë. Në përfundim të çdo angazhimi auditues, përgjegjësi i SAB ka përcjellë tek Titullari i Institucionit, Memo të nënshkruar (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar). Në zbatim të kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të), duhet të protokollohen e të dorëzohen në arkivën e Institucionit. Në vlerësim me përputhshmërinë e zbatimit të këtij ligji, nga auditimi u konstatua se dosjet e angazhimeve për vitin 2021,2022 dhe 2023, janë protokolluar e arkivuar.

2.6 Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

2.6.1. Mbi auditimin e inventarizimit të pajisjeve elektronike (tableta) në kuadër të Projektit të Cens-it 2023, përzgjedhjen e magazinimit të tyre, dokumentimit të gjurmës, kushteve dhe mbrojtjen e të dhënave sensitive që mbartin

Në zbatim të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni, që prej fazës parapërgatitore të Projektit të Cens-it për vitin 2023, duke nisur me blerjet e pajisjeve elektronike të llojit (tableta), hyrjen e tyre në magazinë, organizimin e nevojshëm për sigurimin e ambienteve ku do të qëndrojnë këto pajisje fizikisht, shpërndarjen e tyre në kuadër të projektit, kushtet e përshtatshme fizike gjatë procesit të magazinimit të tyre si edhe mbrojtjen e të dhënave sensitive që ato mbartin.

Projekti i Cens-it, viti 2023

Veprimtaria e Institucionit të INSTAT, rregullohet me Ligjin nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, ku përcaktohen objektivat, funksionet dhe detyrimet që ka si një Institucion Kushtetues i R.SH. Në lidhje me Cens-in i cili, duhet të kryhet çdo 10 (dhjetë) vjet nga INSTAT, në referencë të Ligjit nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, neni 3 ku përcaktohet: “Censet” ku citohet se: “Çdo cens përfshihet në program, por realizimi i tij rregullohet me ligj të veçantë.”

Për sa cituar më sipër në lidhje me Cens-in e vitit 2023, bazuar në Ligjin nr.140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe të Banesave”, i cili rregullon organizimin dhe realizimin e censit të popullsisë dhe të banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë, në nenin 3 të këtij Ligji “Përkufizime”, gërma “h” përcakton se: “INSTAT është Instituti i Statistikave të Shqipërisë, që është Autoritet Ekzekutiv përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe menaxhimin e censit.”

Për vitin 2023, nga ana e INSTAT është hartuar dhe miratuar Planin Vjetor për Statistikat Zyrtare 2023, i cili është përgatitur në zbatim të nenit 9 dhe nenit 10 të Ligjit nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”.

Dokumenti i Planit Vjetor shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore në përmbushje të

objektivave strategjike dhe rezultateve të pritshme të parashikuara në Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”.

Në Planin Vjetor 2023 është parashikuar Projekti i Cens-it 2023, që do të zhvillohet së bashku me procedurat përkatëse sipas kërkesave të Ligjit nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT me nr. 131, datë 11.09.2023 protokolluar me nr. 1792 Prot., datë 11.09.2023 “Për ngritjen e njësisë së Censit në kuadër të zbatimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave”, është ngritur njësia e Censit për proceset e përgatitjes, zbatimit dhe publikimit të të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave.

A-Faza parapërgatitore e Projektit të Cens-it 2023, blerja e pajisjeve elektronike (tableta) si dhe sigurimi i ambientit për magazinimin e tyre.

Gjatë fazës parapërgatitore të Projektit të Cens-it 2023, nga ana e INSTAT është proceduar me blerjen e pajisjeve elektronike (tableta) të cilat do të shërbejnë për grumbullimin e të dhënave nga ana e anketuesve, numërimin e popullsisë dhe banesave, më pas me përpunimin e të dhënave të grumbulluara dhe në fund me publikimin e rezultateve të Cens-it.

Nga informacioni i kërkuar nga ana e Grupit të Auditimit në lidhje me blerjen e pajisjeve dhe magazinimit të tyre në kuadër të Projektit të Cens-it 2023, nga ana e Strukturave të INSTAT është përcaktuar, se për proceset e punës të planifikuara në planin e aktiviteteve në kuadër të magazinimit dhe parapërgatitjes së bazës materiale për punonjësit e terrenit është propozuar sigurimi i një ambienti (magazinë), i cili do të mundësonte realizimin e proceseve:

- *Magazinimi paraprak i bazës materiale për punonjësit e terrenit;*
- *Parapërgatitja nga Ekipi i Teknologjisë së Informacionit;*
- *Parapërgatitja dhe paketimi sipas destinacionit nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës;*
- *Realizimi i procesit të shpërndarjes;*
- *Realizimi i grumbullimit;*
- *Magazinimi i tabletave me të dhënat e grumbulluara në hapësirën e përcaktuar, për periudhën të cilën duhet të ruhen;*
- *Magazinimi i materialeve të tjera (Tableta, kover tableta, laptopë, video-projektorë, çanta me logo, badge, stilolapsa, kuti plastike për paketim, blloqe me logo, printera etj);*
- *Vijimi i proceseve nga Ekipi i Teknologjisë së Informacionit.*

A.1.-Sipas përlloraritjeve të realizuara nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës së Bazës Materiale në INSTAT, për materialet (tableta, cover, laptop, video-projektorë, çanta me logo, badge, kutia etj) është konkluduar se për magazinimin e tyre kërkohet një volum i përafërt me sipërfaqe 310 (m³), volum të cilin INSTAT nuk e disponon.

Sa më sipër, nga INSTAT, gjatë fazës së planifikimit për sigurimin e një ambienti, ku do të mundësohej magazinimi i sigurtë i materialeve dhe realizimi i proceseve të punës, kanë proceduar nëpërmjet 2 (dy) fazave:

- *Faza e Parë, sigurimi nëpërmjet bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes për t’u mundësuar nga ana e tyre sigurimi i një ambienti i cili do të përdorej si magazinë.*
- *Faza e Dytë, sigurimi i një ambienti nëpërmjet kontratës së qirasë.*

Në fazën e parë, INSTAT i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën nr.685 prot, datë 22.04.2022 për sigurimin e një ambienti si magazinë me sipërfaqe totale të paktën 650 (m²), mundësisht i organizuar në 3 (tre) ambiente të veçuara me njëra-tjetrën dhe të sigurta me qëllim

magazinimin e materialeve të Cens-it, parapërgatitjen nga specialistët e TI dhe të përgatitje së kutive nga ana e logjistikës, për shpërndarje, sipas destinacioneve në çdo Bashki. Periudha e përdorimit të ambientit është kërkuar nga INSTAT të jetë për 24 muaj duke filluar nga data 01.06.2022. Gjithashtu INSTAT, i bën me dije Ministrisë së Mbrojtjes se materialet që do të magazinohen do të jenë kryesisht pajisje elektronike, kancelari dhe materiale të tjera ndihmëse për stafin në terren. ***Materialet është shumë e rëndësishme që të ruhen në kushte të përshtatshme larg lagështirës, dëmtimit dhe aksesit të pa autorizuar.***

Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr.2140/3, datë 03.06.2022, i është drejtuar INSTAT-it se në përgjigje të shkresës nr.685, datë 03.06.2022, pas shqyrtimit të mundësive për dhënien e magazinës sipas kërkesave specifike të dërguara nga ju me *Aneksin nr.1 "Specifikimet e Magazinës Qendrore Tiranë"*, ju bën me dije se strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes nuk disponojnë ambiente të lira që plotësojnë kriteret e kërkuara.

Për këtë arsye sipas informacionit të vënë në dispozicion, Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës ka proceduar me *fazën e dytë*, ku me shkresën nr.861, datë 09.05.2023 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në INSTAT, i është kërkuar "sigurimi i një ambienti për magazinë në kuadër të Cens 2023" së bashku me specifikimet përkatëse. Nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është miratuar kërkesa e cituar më sipër dhe është vendosur sigurimi i një ambienti (magazinë) sipas specifikimeve përkatëse.

Në vijim të këtij miratimi nga ana e INSTAT është ngritur komisioni për përzgjedhjen e një ambienti (magazinë), i cili ka lidhur kontratë qiraje me shoqërinë tregtare "N.H" (*kontratë e cila në mënyrë detajuar përshkruhet në pikën D*).

A.2.-Nga ana e Grupit të Auditimit konsatohet se në referencë të Ligjit nr. 140/2020 "Për censin e popullsisë dhe banesave", konkretisht neni 9 "Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti" pika 4 përcaktohet se: "INSTAT-i merr të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurisë për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në instalimet ku të dhënat personale të censit mbahen, përpunohen ose ruhen, dhe për t'i mbrojtur ato nga shkatërrimet e paligjshme, aksidentale, humbjet aksidentale, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. 5. INSTAT-i duhet t'i trajtojë të dhënat e mbledhura, të përpunuara e të ruajtura të censit si rreptësisht konfidenciale duke mos lejuar individët dhe njësitë e tjera statistikore të identifikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.", është miratuar kërkesa e Ekipit të Organizimit dhe Logjistikës për sigurimin e një ambienti (magazinë) "**privat**" (me kontratë qiraje), për vendosjen e pajisjeve elektronike të cilat shërbejnë për grumbullimin e të dhënave të popullsisë dhe banesave, në kuadër të organizimit të të gjithë procesit të Cens-it 2023 (grumbullim të dhënash të popullsisë, përpunim të dhënash popullsisë), por referuar Ligjit nr. 140/2020 "Për censin e popullsisë dhe banesave", pikat 4 dhe 5 marrja e një ambienti privat çënon konceptet e parashikuara duke rrezikuar në mënyrë të ndjeshme parimet e "sigurisë" së të dhënave sensitive si edhe "konfidencialitetin" e tyre.

Gjithashtu, për mbarëvajtjen e procesit të Cens 2023, është ngritur edhe struktura e Komisionit Qendror të Censit, ku bazuar në përcaktimet e nenit 11 të Ligjit nr.140/2020 "Për censin e popullsisë dhe banesave", përcaktohet se kjo strukturë ngrihet me qëllim mbështetjen e INSTAT-it në përgatitjen dhe zbatimin e censit të popullsisë dhe banesave, ngrihet Komisioni Qendror i Censit, si dhe kryesohet nga zëvendëskryeministri e në përbërje të tij janë anëtarët si vijon: a) ministri përgjegjës për financat; b) ministri përgjegjës për ekonominë; c) ministri përgjegjës për punët e brendshme; ç) ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe energjinë; d) ministri përgjegjës

për integrimin evropian dhe punët e jashtme; dh) ministri përgjegjës për drejtësinë; e) ministri përgjegjës për mbrojtjen; ë) ministri përgjegjës për arsimin, sportin dhe rininë; f) ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale; g) ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural; gj) ministri përgjegjës për turizmin dhe mjedisin; h) ministri përgjegjës për kulturën; i) ministri përgjegjës për diasporën; j) ministri përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes; k) Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it; l) dy përfaqësues të tjerë të nivelit të lartë të INSTAT-it, të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it; ll) kryetari i Akademisë së Shkencave; m) rektori i Universitetit të Tiranës; n) titullari më i lartë i strukturës përgjegjëse, që mbulon çështjet e zhvillimit dhe mirëqeverisjes në Kryeministri; nj) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.”. Në nenin 12 të ligjit të sipërcituar përcaktohet: “Komisioni Qendror i Censit ka këto përgjegjësi: a) harton dhe miraton rregulloren e Komisionit Qendror të Censit; b) ndjek përgatitjen dhe zbatimin e censit dhe mbështet INSTAT-in për të siguruar të dhënat statistikore që priten të jepen nga institucionet publike, rrethet shkencore dhe shoqëria civile; c) lehtëson bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive dhe institucioneve qendrore e shkencore për mbështetjen e censit; ç) miraton kalendarin e veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censit, në përputhje me planin vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare; d) shqyrton çdo kërkesë të paraqitur dhe lëshon autorizim të veçantë në lidhje me miratimin për mbledhjen e informacionit nga publiku gjatë periudhës prej 6 javësh, përpara ditës së censit, dhe gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave të censit, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji”.

Komisioni Qendror i Censit është një organ, i cili ndjek përgatitjen dhe zbatimin e Cens-it si edhe mbështet INSTAT-in për çdo problematikë që mund të dalë gjatë projektit të Cens-it duke bashkërenduar punën me të gjitha Institucionet Publike dhe Ministrinë e Linjës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, KQC është mbledhur gjithsej 2 (dy) herë, sipas procesverbalit nr. 89 prot., datë 22.01.2021 dhe sipas procesverbalit të datës 26.05.2022. Përgjatë periudhës 2021-2023 veprimtaria e këtij komisioni është mjaftuar me informacionet periodike të hartuara nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Cens-it të dorëzuara tek KQC nëpërmjet postës elektronike, përkatësisht 6 informacione gjatë vitit 2021, 6 informacione gjatë vitit 2022 dhe 12 informacione periodike gjatë vitit 2023. Nga auditimi i raporteve periodike të dërguara nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Cens-it, drejtuar Komisionit Qendror të Cens-it u konstatua se: KQC nuk është vënë në dijeni nga ana e INSTAT-it në lidhje me sigurimit të një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për pajisjet elektronike (tableta).

A.3.-Nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se, nisur nga përcaktimet e Ligjit nr.140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”, konkretisht neni 14 “Përgjegjësia e Institutit të Statistikave”, ku përcaktohet se: “gj) i raporton Komisionit Qendror të Censit ecurinë e aktiviteteve të censit; h) INSTAT-i mbulon detyrën e sekretariatit të Komisionit Qendror të Censit dhe ka këto detyra: i. njofton anëtarët e Komisionit për mbledhjen e radhës; ii. mban procesverbalin e mbledhjes; iii. përgatit dokumentacionin bazë të mbledhjes, të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes.”, në lidhje me problematikën e sigurimit të një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për mbrojtjen e të dhënave, nga ana e INSTAT-it u konstatua se nuk është raportuar pranë Komisionit Qendror të Censit mbi ecurinë e aktiviteteve të Cens-it, si edhe pas kërkesës ku INSTAT i ka kërkuar mundësinë e sigurimit të një ambienti që do të shërbente si magazinë për pajisjet elektronike Ministrisë së Mbrojtjes e cila e informon se nuk disponon një ambient të tillë, të procedohej me informimin e Komisionit Qendror të Censit për këtë situatë.

B.-Korrespondenca e INSTAT-it me Komisionerin Për Të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Të Dhënave Personale, në kuadër të Projektit të Cens-it 2023.

Nga ana e INSTAT-it, me shkresën nr.1765 prot, datë 06.09.2023, i është drejtuar Komisionerit Për Të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Të Dhënave Personale (këtu në vijim KDIMDP), ku e informon se në kuadër të Projektit të Cens-it, si ushtrimi më kompleks dhe masiv që ndërmerr INSTAT-i, si edhe një projekt prioritar, thelbësor për krijimin e një sistemi statistikor të qëndrueshëm dhe efikas, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, neni 21 dhe 22, INSTAT-i në cilësinë e kontrollorit i lind detyrimi për njoftimin e Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, duke dhënë informacionet e nevojshme si: a) emrin dhe adresën e kontrolluesit; b) qëllimin e përpunimit të të dhënave personale; c) kategoritë e subjekteve të të dhënave dhe kategoritë e të dhënave personale; ç) marrësit dhe kategoritë e marrësve të të dhënave personale; d) propozimin për transferimet ndërkombëtare që kontrolluesi synon të kryejë; dh) një përshkrim të përgjithshëm të masave për sigurinë e të dhënave personale.

Nga ana e KDIMDP-së, me shkresën nr.1459/1 prot, datë 14.09.2023, pasi është njohur me deklaratën mbi ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit (*shkresa e cituar më sipër nr.1765, datë 06.09.2023*), i ka shprehur vlerësimet mbi proceset përpunuese bazuar në parashikimet e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ku specifikon se: “Për garantimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale që do të jenë objekt i zbatimit të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave, INSTAT-i në cilësinë e kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale për këtë qëllim duhet të ketë parasysh respektimin dhe garantimin e parimeve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit, të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.”

Gjithashtu, *INSTAT-i në cilësinë e kontrolluesit dhe përpunuesit, duhet të zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel të lartë sigurie ndaj rrezikut të mundshëm, në lidhje me përpunimin/përhapjen e pa autorizuar të të dhënave personale dhe veçanërisht ato sensitive*. Në këtë kuadër një detyrim i rëndësishëm që lind në zbatim të nenit 27 të Ligjit, është hartimi i rregullave dhe procedurave, organizative specifike (mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit, etj.), si edhe është përgjegjësi e kontrolluesit (INSTAT-it) për të verifikuar masat për sigurinë e të dhënave personale nëse janë përmbushur sipas pikës 1 të nenit 27 ku citohet se: “*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të pa autorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*”. INSTAT duhet të sigurojë që të dhënat personale të mbledhura gjatë Cens-it të Popullsisë dhe Banesave të mbahen konfidenciale dhe të mbrohen nga aksesit i paligjshëm, për këtë qëllim është e nevojshme që të hartohen dhe nënshkruhen deklaratat e konfidencialitetit nga çdo punonjës që ka akses në të dhënat personale gjatë realizimit të këtij procesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit. Grupit të Auditimit i janë vënë në dispozicion disa deklarata konfidencialiteti të nënshkruara nga punonjësit e INSTAT, veprim i kryer në përputhje me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

C. – Analizë mbi përcaktimet e specifikimeve të sigurimit të ambientit (magazinë)

Nëpërmjet shkresës nr.685 prot., datë 22.04.2022, ku INSTAT i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes për sigurimin e një ambienti të përshtatshëm (magazinë) në kuadër të Projektit të Censit 2023 (e trajtuar hollësisht në pikën A.1), në Aneksin nr.1 ka përcaktuar specifikimet përkatëse si vijon: “Një magazinë me 3 (tre) volume/hapësira të ndryshme në territorin e Bashkisë Tiranë, me sipërfaqe totale 650 m2 (minimumi), me afat disponibiliteti nga data 01.06.2022 – 31.05.2024 (24 muaj). Gjithashtu specifikimet për sigurinë janë:

- 1.Sistem kamerash në të 3 (tre) volumet;
- 2.Të 3 (tre) volumet me dritare dhe dyer të sigurta;**
- 3.Ruajtje fizike 24 orë;**
- 4.Siguri ndaj kushteve atmosferike (lagështia);**
- 5.Sistem sigurie ndaj zjarrit;
- 6.Hyrje e aksesueshme për mjete të mëdha transporti;
- 7.Aksesimi në magazinë vetëm nga një hapësirë hyrje/dalje;**
- 8.Sistem i qëndrueshëm elektrik;
- 9.Dalje emergjence.

Nga ana tjetër me kërkesën e Ekipit të Organizimit dhe Logjistikës nr. 861, datë 09.05.2023 (të trajtuar më hollësisht në pikën A.1) drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në INSTAT, i ka kërkuar sigurimin e një ambienti (magazinë) në kuadër të Projektit Cens 2023. Në Aneks ka përcaktuar specifikimet përkatëse si vijon: “Një magazinë me 3 (tre) volume/hapësira të ndryshme në territorin e Bashkisë Tiranë në brëndësi të unazës së vogël e aksesueshme me linjë transporti publike, me sipërfaqe totale 580 m2 (minimumi), me afat disponibiliteti nga data 05.06.2023 – 31.01.2025 (20 muaj). Gjithashtu specifikimet për sigurinë janë:

- 1.Sistem kamerash në të 3 (tre) volumet me sistem sigurie;
- 2.Të 3 (tre) volumet me dritare dhe dyer të sigurta;
- 3.Siguri ndaj kushteve atmosferike (lagështia);
- 4.Sistem sigurie ndaj zjarrit;
- 5.Të ofrojë shërbim tualet;
- 6.Hyrje e aksesueshme për mjete të mëdha transporti;
- 7.Aksesimi në magazinë vetëm nga një hapësirë hyrje/dalje;
- 8.Sistem i qëndrueshëm elektrik/ linjë 3 fazore;
- 9.Dalje emergjence;
- 10.Poste parkimi për punonjësit.

Sa më sipër nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se ka një mospërputhje të specifikimeve të kërkuara nga kërkesa nr.685 prot., datë 22.04.2022 me kërkesën nr. 861, datë 09.05.2023 për ambientin (magazinë) të cilat janë të paargumentuara.

Në kërkesën drejtuar MM-së, është specifikuar se ambienti duhet të jetë minimalisht 650 m2 ndërkohë që në kërkesën e EOL në INSTAT është specifikuar se ambienti duhet të jetë minimalisht 580 m2, për rrjedhojë me një diferencë prej 70 m2.

Gjithashtu konstatohet se në kërkesën fillestare drejt MM është specifikuar se vendndodhja të jetë brenda territorit Bashkisë Tiranë, ndërkohë që në kërkesën e EOL në INSTAT është specifikuar se ambienti të jetë në territorin e Bashkisë Tiranë në brëndësi të unazës së vogël e aksesueshme me linjë transporti publike, duke vijuar me kërkimin edhe të posteve të parkimit për punonjësit.

Në lidhje me specifikimet e sigurisë për ambientin, Grupi i Auditimit konstaton se ka mos përputhje midis kërkesës fillestar drejt MM në të cilën është kërkuar ruajtje fizike 24 orë, ndërkohë që në kërkesën e EOL në INSTAT, aspekti i ruajtjes fizike 24 orë nuk është i përfshirë.

C.1-Sa i takon shërbimit të ruajtjes fizike të ambientit (magazinë), Grupi i Auditimit ka verifikuar Kontratën midis INSTAT-it dhe I.G SHA, me nr.1149/4 prot, datë 29.12.2022 me objekt “Shërbimi dhe ruajtjen e sigurisë fizike të Ambienteve të INSTAT” i shoqëruar edhe me amendimin e kontratës me nr.1149/6 prot, datë 08.08.2023 me objekt “Ndryshimi i nenit 3 çmimi dhe vlera e kontratës” dhe Aneksit nr.1 duke shtuar objektin e ruajtjes së Magazinës me kohë ruajtje fizike 8 (tetë) orë (duke filluar nga ora 22:00 deri 06:00) nga e hëna në të dielë, me një turn, koeficient 1.66, numër rojesh 1.66 me vlerë totale mujore pa TVSH 177,618 lekë. Në këtë amendim kontrate nuk specifikohet sesi do të bëhej ruajtja e magazinës Cens. Nga ana tjetër, grupit të auditimit i është vënë në dispozicion një procesverbal nga përfaqësuesi i I.G sh.a.(pa datë), ku citohet se shërbimi është kryer me roje fizike për turnin e tretë, ndërsa turni i parë dhe i dytë me grupin e verifikimit të sinjaleve. Sa më sipër, ka një kontradiktë midis Aneksit nr.1 të amendimit të kontratës dhe informacionit të vënë në dispozicion nga shoqëria I.G sha.

D. – Mbi auditimin e përzgjedhjes së ambientit (magazinë)

Në vijim të kërkesës së EOL, me Urdhrin nr.76 datë 13.06.2023 Titullari i Institucionit ka ngritur komisionin e përzgjedhjes së ambientit (magazinë) për marrjen me qira në kuadër të Projektit të Cens 2023, për magazinën qendrore Tiranë, me përbërje znj. V.L, (kryetar) dhe z. E.T, z. F.G, z. A.D, z. E.Xh (anëtar), i cili kishte për detyrë të realizonte analizën e tregut për të parë çmimet referencë bazuar në specifikimet teknike të paracaktuara në shkresën me nr. 861 prot., datë 09.05.2023. Nga komisioni është është mbajtur një procesverbal për realizimin për analizimin e çmimeve pa numër dhe pa datë.

Në procesverbalin nr. 861/1 prot., datë 25.07.2023, komisioni informon Drejtorin e Përgjithshëm mbi ofertat e marra, konkretisht 4 (katër) oferta nga të cilat vetëm njëra prej tyre rezultoi sipas specifikimeve të kërkuara, veprim në kundërshtim me pikën 6 të Urdhrit të sipërcituar ku komisioni duhet të përgatiste propozimin për klasifikimin e ofertave të qirasë, të cilat përmbushin kushtet dhe kriteret e paracaktuara (minimalisht 3 oferta).Në procesverbal gjithashtu citohet që operatori merr përsipër të realizojë çdo modifikim ose rregullim të mundshëm sipas nevojave të institucionit. Nuk specifikohet se cilat pika/kërkesa kanë nevojë për modifikime. Grupit të Auditimit nuk i është vënë në dispozicion draftimi i kontratës.

Me Urdhrin nr.1104/1 prot., datë 25.07.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm, është miratuar oferta e paraqitur nga shoqëria tregtare “N.H” në vlerën 420,000 lekë në muaj dhe me afat nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri më 31.01.2025.

Kontrata me nr.repertori 2404, nr. koleksioni 1327, datë 11.08.2023, nënshkruar midis INSTAT (Qiramarrës) dhe shoqërisë tregtare “N.H” shpk me NIPT “xxxxxxxxxxx” (Qiradhënës), në prani të noterit, kanë lidhur kontratë qiraje për marrjen e ambientit tip magazinë me sipërfaqe totale prej 588.86 m2, me afat nga data 07.08.2023 deri 06.08.2024 (1 vit), me qira mujore në vlerën 420,000 lekë në muaj.

Me kontratën nr. repertori 3993, nr. koleksioni 2202, datë 26.12.2023, është amenduar kontrata e sipërcituar, duke ndryshuar afatin e marrjes me qira nga data 07.08.2023 deri në datë 06.08.2025, pra (2) vite. Vlera e qirasë mujore nuk ka ndryshuar. Sa më sipër, Grupit të Auditimit nuk i është vënë në dispozicion argumentimi i këtij ndryshimi me amendim të kontratës, dhe pse afati i kontratës mbaron në datë 06.08.2024 (8 muaj përpara mbarimit të afatit fillestar). Nga auditimi i amendimit të saj, konstatohet se shoqëria tregtare “N.H”, si qiradhënës ka si seli qendrore njërin nga ambientet që është dhënë me qira për të magazinuar pajisjet elektronike, edhe pse nga ana e shoqërisë tregtare “N.H” është ndryshuar adresa e selisë qendrore verifikuar në ekstraktin historik

në QKB. Sa më sipër, nga strukturat përkatëse nuk u dokumentua verifikimi i shqyrtimit të amendimit të kontratës.

▪ **Verifikimi në terren i ambienteve të marra me qira dhe ruajtja e materialeve**

D.1.-Nga ana e Grupit të Auditimit, gjatë fazës së auditimit ka verifikuar në terren ambientin (magazinë) e marrë me qira sipas kontratës të sipër cituar nga ku ka rezultuar se hapësira e marrë me qira përdorej e ndarë sipas funksioneve si vijon:

- 1- Ambienti i logjistikës, për përgatitjen e tabletave e për shpërndarjen e tyre;
- 2- Ambienti i magazinës, ku bëhej magazinimi dhe ruajtja e tabletave;
- 3- Ambienti i informatikës, ku bëhej përgatitja softuerike.

Ambienti i logjistikës dhe magazinës kishte hyrje të veçantë nga ambienti i informatikës.

Në ambientin e magazinës ruheshin dhe magazinoheshin pajisjet elektronike - tabletat. Njësia ku magazinoheshin tabletat, paraqitej me derë të blinduar, por ambienti nuk ishte i pajisur me sistem kondicionimi, si dhe kishte lagështirë në një pjesë të saj. Gjithashtu, grupi i auditimit nga verifikimi i kryer konstatoi se objekti i marrë me qira aksesohet nga disa hyrje.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me specifikimet e kërkuara (*trajtuar më hollësisht në pikën C.*)

Nga verifikimi i kryer në terren nga Grupi i Auditimit në datën 04.06.2024, mbajtur me Akt Verifikimin nr.2, rezultoi se, njësia “*Garazh*” është përdorur si parkim gjatë dorëzimit të materialeve për procesin e Cens, si dhe marrjes në dorëzim pas mbylljes së procesit. Aktualisht, kjo njësi nuk ka asnjë material brenda.

D.2.-Në lidhje me pajisjet elektronike (tableta), bazuar në procesverbalet e vëna në dispozicion nga Ekipi i Teknologjisë së Informacionit dhe Ekipi të Logjistikës, rezultoi se një sasi prej 525 tabletash janë përdorur më parë për trajnimet e stafit në kuadër të Censit, të cilat ruheshin po aty në magazinë por nuk mbartnin të dhëna sensitive.

Referuar procesverbaleve të vëna në dispozicion në magazinë ndodhen 6,438 tableta të ndara në kutitë përkatëse. (*5,032 copë të vulosura me kod sigurie dhe 1406 copë të sinkronizuara*)

Me shkresën nr.103/1 Prot., datë 19.01.2024, me lëndë “*Kërkesë për aksesim tabletësh në magazinë*”, Drejtuesi i TI dhe Cilësisë, z. D.K ka kërkuar Sinkronizimin për të kryer inventarin e të gjithë të dhënave fizike në tabletë, duke kërkuar aksesimin e pajisjeve tablet në Magazinën e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, nga 15 specialistët e IT, kërkesë e konfirmuar nga Njësia e Koordinimit të Censit, z. A.Ç, znj. H.M, z. K.Sh dhe znj. E.S, dhe e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, znj. E.Dh.

D.3.-Sa më sipër, referuar procesverbaleve të vëna në dispozicion grupit të auditimit, të mbajtura nga tre persona, 1406 copë tableta ishin sinkronizuar. Sinkronizimi i të dhënave, sipas shpjegimeve të Drejtorit të IT, z. K, nuk bëhej tek kjo hapësirë ku ndodheshin tabletat (magazina), por tek ambienti i informatikës, për shkak të mungesës së shërbimit të internetit në ambientin e magazinës. Për rrjedhojë veprimet e mësipërme kanë cënuar parimet e sigurisë së të dhënave sensitive dhe kofidencialitetit, të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 140/2020 “*Për censin e popullsisë dhe banesave*”, konkretisht neni 9 “*Mbrojtja e të dhënave dhe kofidencialiteti*”, si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, neni 27 dhe 28.

Pjesa tjetër prej 5,032 copë, paraqiten në kuti të mbyllura dhe vulosura e cila faktori se edhe pse kërkesa me nr.103/1 Prot., datë 19.01.2024 është bërë për sinkronizimin e të gjitha pajisjeve elektronike (tableta) për 6,438 copë, rezultoi se vetëm për 1,406 tableta është kryer ky proces.

D.4.-Referuar kontratës së blerjeve të pajisjeve elektronike – tableta, në kuadër të Projektit të Censurit, si dhe Fletë Hyrjeve përkatëse në magazinën qendrore të INSTAT-it, numri total i këtyre pajisjeve rezulton 7,700 copë. Nga verifikimi i procesverbaleve të sipërcituara dhe shpjegimeve të personave prezent përgjegjës nga INSTAT, rezulton se në magazinën e Cens-it janë në total 6,963 copë. Diferenca prej 737 tableta (7,700 – 6,963), sipas shpjegimeve të dhëna nga personat përgjegjës dhe procesverbale e vëna në dispozicion, vazhdojnë të jenë në përdorim nga stafi monitorues i Cens në INSTAT, por që aktualisht përdoren për projekte dhe anketa të ndryshme, që nuk kanë të bëjnë me Cens-in. Sa më sipër, nga ana e personave përgjegjës për ruajtjen dhe magazinimin e tabletëve, nuk janë dokumentuar të gjitha proceset e marrjes, dorëzimit dhe rimarrjes të këtyre tabletave për përdorim për qëllime të tjera jashtë projektit të Cens-it. Për rrjedhojë nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se nuk janë të dokumentuara të gjitha proceset e cituara më sipër, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 19 “Gjurma e Auditimit”, si dhe neni 12, pika 3 gërma “dh”. (Shënim: Tabletat nuk janë numëruar nga ana e grupit të auditimit gjatë verifikimit në terren, numri i tyre u vendos referuar procesverbaleve dhe shpjegimeve të dhëna nga personat përgjegjës.*)**

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.654/19 prot., datë 02.09.2024, protokolluar në KLSH me nr. 505/5, datë 03.09.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit: -Në zbatim të rekomandimeve tuaj, Titullari i Institucionit do të marrë masa për hartimin e urdhrat për ngritjen e grupit të punës me qëllim verifikimin dhe analizimin mangësive të evidentuara.

- Në zbatim të rekomandimit tuaj, ju bëjmë me dije se Strukturat Përgjegjëse do të marrin masat e nevojshme për finalizimin e procesit të mbledhjes së tabletëve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Sa më sipër, nga subjekti i audituar janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna, të cilat janë pranuar dhe nga institucioni i INSTAT do të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026 të përgatitura konstatohet se në institucionin e INSTAT nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-ve, si dhe nuk ka dokumentim të mbledhjeve të EMP- së. Në përgatitjen e PBA-së janë konsideruar kërkesat e paraqitura nga drejtoritë e institucionit dhe janë përpunuar nga Drejtoria e Financës dhe Projekteve, veprime në kundërshtim me udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së” paragrafi 2.5 pika 1/a, paragrafi 2.5 pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet nr. 17-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të INSTAT të marrë masa për krijimin Ekipit të Menaxhimit të Programit çdo vit për përgatitjen e PBA-së, si detyrim për të garantuar një proces planifikimi sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për vitet 2021-2023 nga INSTAT janë kryer rishikimet buxhetore si vijon: në vitin 2021 janë kryer 5 rishikime buxhetore,

për vitin 2022 9 rishikime buxhetore dhe për vitin 2023, 16 rishikime buxhetore, të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së INSTAT. Nga auditimi i rishikimeve të kërkuara, u konstatua se nga institucioni nuk ka argumentim si: a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 71. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet nr. 17-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Instituti i Statistikave, në bashkëpunim me njësitë shpenzuese në varësi të saj dhe ekipet për menaxhimin e programeve buxhetore, të marrin masat e nevojshme për rritjen e bashkëpunimit me tyre dhe kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucional, me qëllim shmangien e ndryshimeve të paargumentuara të fondeve në buxhet.

Menjëherë e në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se INSTAT ka hartuar raportet e monitorimit 4 mujore të konsoliduara, por nga ana institucioneve të varësisë (*Zyrat Rajonale Statistikore*), si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raporte monitorimi 4 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik.

Nga ana e grupit të auditimit u konstatua se në relacionin shpjegues përmbledhës, analiza sipas zërave buxhetorë është kryer vetëm pas planit të rishikuar të buxhetit, e jo planit fillestar në PBA, duke sjellë mungesën e një analize të qartë në lidhje me ndryshimet dhe devijimet e planit të rishikuar në krahasim me planin fillestar. Nga auditimi u konstatua se nuk janë analizuar dhe argumentuar në mënyrë shteruese shpenzimet operative, projektet dhe investimet të realizuara, si dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e punës në INSTAT, si dhe sa i takon kërkesave për ndryshime buxhetore të ndodhura gjatë vitit, nuk ka argumentim të plotë për të cilat janë realizuar këto ndryshime. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22 të MFE, datë 17.11.2016 dhe nr.14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, shtojca nr.3 dhe kapitulli 4, pika 49 dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit”, kapitulli VI, pika 271. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet nr. 17-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Titullari i INSTAT të marrë masat e nevojshme, për hartimin e raporteve periodike të detajuara të monitorimit të buxhetit 4 mujore për aparatit e INSTAT dhe njësitë të varësisë si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e tyre, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të trashëguara nga donatorët ndër vite, konstatohet se INSTAT ka të ardhura të trashëguara nga donatorët për projekte të huaja, të cilat janë ekzekutuar ndër vite, në vijim.

4.1 INSTAT nuk ka relacione/sqarime për realizimin dhe rakordimin financiar të tyre nga fillimi i projektit, transfertat dhe gjendjet. Bazuar në llogaritë analitike të vëna në dispozicion për vitet

2021, 2022 dhe 2023, konstatohet se mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin të ardhurave të trashëguara nga donacionet në buxhet, nga ana e INSTAT nuk ka një vendimmarrje nga organet përkatëse për detajimin dhe përdorimin e tyre. Sektori i Financës dhe Projekteve në INSTAT ka rakorduar me thesarin për shumën totale të projekteve, e cila nuk paraqitet me evidencë të detajuar për secilin nga projektet e financuara.

4.2 Në zërin “*GOPA PPP*” për të tre vitet objekt auditimi, janë përfshirë disa projekte me financim nga donatorë të ndryshëm, për të cilat gjendja fillestare, hyrjet, daljet dhe gjendja në fund janë mbajtur në total, duke bërë të pamundur identifikimin e vlerave përkatëse për secilin projekt/marrëveshje/kontratë, si dhe mënyrën e përdorimit të buxhetit të tyre. Nga vënia në dispozicion e disa nga projektet e përfshira në zërin *GOPA PPP (sipas marrëveshjeve IPA 2015 dhe IPA 2017)* kanë përfunduar, por nga ana e INSTAT këto të ardhura vazhdojnë të mbarten nga viti në vit, dhe të përdoren për aktivitete të ndryshme të INSTAT të paplanifikuara për vitet buxhetore respektive. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.17/2018 “*Për statistikat zyrtare*”, Neni 18 pika 1, Neni 20 pika dh), Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 4 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” pika 204. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet nr. 17-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Projekteve të marrë masat e nevojshme për dokumentimin e procesit që nga regjistrimi, përdorimi, rakordimi dhe raportimin financiar të secilit projekt në kapitullin 6 “*Të ardhura të trashëguara nga donatorët*” që nga origjina/fillimi i projektit, hyrjet, daljet dhe gjendja në fund me qëllim identifikimin e shpenzimeve dhe realizimin e projektit.

Menjëherë e në vijimësi

4.2 Rekomandim: Nga ana e strukturave drejtuese përkatëse në INSTAT të merren masat për planifikimin sa më real dhe të besueshëm të buxhetit, ku gjatë fazës së planifikimit të tij të përfshihen të ardhurat e mbartura nga donacionet nga vitet e kaluara me qëllim dhënien e destinacionit të përdorimit të tyre gjatë fazës së realizimit të buxhetit me kod projekti specifik, sipas nevojave të argumentuara dhe parashikuara nga ana e Institucionit, duke rritur efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomikitetin e përdorimit të burimeve.

Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të projektit Cens-it u konstatua se:

5.1 INSTAT nuk ka zbatuar afatet e vendosura nga vete ky institucion në planin vjetor 2022, për projektin CENS/faza e grumbullimit të të dhënave e parashikuar për të filluar në 01.01.2022 dhe e pa kryer si procedurë në vitin 2022. Për të vazhduar me tej me një vonese tjetër të shkaktuar po nga INSTAT, e cila ka sjelle dështimin e vijimit të Cens-it dhe shtyrjen e realizimit të tij, si rezultat i anulimit të procedurës së prokurimit, nga KPP, me objekt “*Blerje pajisje Tableta dhe Power Banks për CENS*” me fond limit 233,584 mijë lekë, pa TVSH, për arsye të *mospërputhjeve midis kërkesave të parashikuara nga AK në specifikimet teknike dhe specifikimeve teknike kombëtare të miratuara nga AKSHI, duke ndikuar drejtpërdrejt në hartimin e ofertës ekonomike të OE, si dhe vlerësimin e ofertave nga KVO, në mospërputhje me LPP-në, për trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë OE, e bazuar në vendimin nr. 703/2022 datë 22.07.2022 të KPP-së.*

5.2 Për projektin Pilot Cens-it, u konstatua se në vitin 2021 nëpërmjet bankës nga kapitulli 6 – *Të ardhura të trashëguara nga donacionet* janë likuiduar shpenzime për qira ambientesh, automjete

me qira, blerje karburant si dhe blerje materiale promocionale, të cilat nuk janë planifikuar dhe raportuar në buxhetin e projektit Cens.

Sa më sipër, rezulton se nga ana e INSTAT kemi një planifikim të dobët sa i përket projektit CENS. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 4, Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, pika 2.3.3, 2.7.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet nr. 17-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e INSTAT të merren masa konkrete për një planifikim/programim sa më real dhe të besueshëm të buxhetit për projektet e financuara me buxhetin e shtetit, me qëllim përmbushjen e objektivave të Institucionit si dhe argumentimin e tyre.

Menjëherë e në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimin e investimeve dhe nga analiza dhe kryqëzimi i të dhënave sa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit në raport me projektet e planifikuara në PBA-të respektive si vijon:

- projektet e investimeve të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024, ku për tre projektet në shumën 11,718 mijë lekë, janë realizuar gjatë vitit 2022, kanë qenë të planifikuara në PBA 2022-2024, me vlera më të larta në shumën 15,600 mijë lekë, me një diferencë prej 3,882 mijë lekë, duke sjellë mungesë analize në planifikimin e investimeve;

- projektet e investimeve të realizuara gjatë vitit 2023 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2023-2025, analizuar për tre projektet (në shumën 296,350 mijë lekë, janë realizuar gjatë vitit 2023, por kanë qenë të planifikuara në PBA 2023-2025, me vlera më të vogla në shumën 15,600 mijë lekë, me një diferencë prej 280,750 mijë lekë, duke sjellë mungesë analize në planifikimin e investimeve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7 dhe Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1, ku përcakton se “Të gjitha projektet e investimeve të reja duhet të përgatiten përmes formatit të propozimit të politikave të reja dhe të ndjekin procedurat e përgjithshme të shqyrtimit dhe miratimit të tyre”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet nr. 17-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme për planifikimin sa më real të projekteve të investimit me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

Menjëherë e në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, u konstatuan se 46 urdhër shpenzime të vitit 2022 dhe 96 urdhër shpenzime të vitit 2023, janë likuiduar mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 52 dhe Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 28-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me drejtoritë e varësisë, pjesë e strukturës së INSTAT, të marrin masa për të paraqitur në afat në Sektorin e Financës, kërkesat për shpenzime si dhe dokumentacionin justifikues mbështetës, brenda afatit 15 ditor nga data e faturës

originale të operatorit ekonomik, me qëllim shmangien e detyrimeve dhe kamatëvonesave që mund të gjenerohen me kosto në buxhetin e shtetit.

Menjëherë e në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi likuidimin e urdhër shpenzimeve për Cens-in u evidentua se:

8.1. Gjatë vitit 2023, INSTAT ka likuiduar 7,267,550 lekë për shpenzimet e qirasë, nga të cilat 300,232 lekë janë likuiduar në muajin Janar, por për llogari të buxhetit të vitit 2023 sipas përcaktimeve të udhëzimit e MF nr.31 datë 13.12.2023 *“Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023”*. Nga ky total likuidimesh të muajit Janar, rezulton pagesa për llogari të muajve tetor-nëntor, jashtë afatit 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore, si dhe parashikimit në nenin 4 të kontratës ku citohet *“Pagesa do të behet brenda datës 5 të çdo muaji pasardhës”*. Gjithashtu, nga verifikimi i të dhënave të raportuara në Ministrinë e Financave me likuidimet konkrete të kryera, rezulton se INSTAT ka raportuar për shpenzimet e qirasë në Ministrinë e Financave në masën 56,877 Euro (6,967,318 lekë), ndërsa në fakt janë realizuar 7,267,550 lekë, duke krijuar pasiguri për raportimet e kryera.

8.2. Në rastet kur INSTAT ka lidhur kontratë qiraje me persona fizikë dhe likuidimi i kreditorëve është kryer duke prekur llogarinë 421 *“Detyrime ndaj personelit”*, dhe jo llogarinë 467 *“Kreditorë të ndryshëm”*. Kjo ka ardhur si shkak i mbajtjes së tatimit në burim, dhe për këtë qëllim, shlyerja e këtyre detyrimeve është kryer duke përdorur listëpagesat e duke i trajtuar dhe qiratë si kontratë shërbimi, e jo si Kontratë Qiraje. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 28-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga INSTAT të merren masat për kryerjen e sistemeve të nevojshme kontabël, si dhe klasifikimin e tatimit në burim në llogarinë e kreditorëve dhe jo si llogari të detyrimeve ndaj personelit, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit, duke iu përmbajtur parimeve të kontabilitetit si dhe pohimit të klasifikimit dhe identifikimit të transaksionit.

Menjëherë e në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore, u konstatua se për një punonjës, është marrë Vendim i Formës së Prerë nga Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 563 datë 21.02.2019 ku përcaktohet: *“... lënia në fuqi të Vendimit 41/89(80-2016-4215) datë 19.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku në dispozitivin e të këtij të fundit ndër të tjera citohet ... pala e paditur ka detyrim pagesën e paditësit me pagën nga data 23.05.2016 deri në kthimin në Punë”*, pra Gjykata ka vendosur përfitimin e pagës deri në momentin e kthimit në punë.

Nga auditimi u konstatua se nga momenti i lindjes së detyrimit e deri në momentin e rikthimit të punonjësit në Pozicionin përkatës, ky shpenzim është njohur dhe paguar në llogarinë nr. 6027 *“Shpenzime për detyrime për kompensime legale”*, dhe jo në llogarinë 600 *“Shpenzime për pagën”* dhe 601 *“Shpenzime për sigurime”* dhe punonjësiti i është paguar paga bruto, duke u tatuar vetëm në normën 15% (si tatim në burim). Nga auditimi rezulton se në pagën bruto nuk janë mbajtur ndalesat që lindin nga përfitimet e pagës për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Për rrjedhojë, nga ana tjetër shpenzimet për pagesën e këtij punonjësi, nuk janë njohur në listëpagesat mujore të INSTAT, si dhe nuk janë mbajtur ndalesat përkatëse, deri në momentin e rikthimit në

pozicionin e punës. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”, i ndryshuar, VKM nr. 187, datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 28-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga INSTAT të merren masat në vijimësi për përlllogaritjen e saktë të detyrimeve tatimore për punonjësit me rikthim në punë bazuar në Vendimet e Gjykatës sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Auditimi mbi likuidimin e TVSH-së për projektet me bashkëfinancim me donatorët e huaj, evidentoi se, se bashkëlidhur urdhër shpenzimeve janë shkresa për pagesën e TVSH-së dhe fatura tatimore nga OE për pjesën e TVSH-së. Nga ana e Sektorit të Financës, mungon dokumentacioni i domosdoshëm justifikues për likuidimin dhe autorizimin e pagesës, si kontrata e lidhur me OE, grant kontrata apo marrëveshjen me donatorin, procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”, pika 35 sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.

-Me urdhër shpenzimit nr. 568 datë 12.07.2021 me objekt “Paguat staf (pastrim dhe imputimi i database të anketës EHIS)” me vlerë 124,644 lekë është likuiduar pagesa për 2 (dy) punonjës të INSTAT me nga 120 orw shtesë për të cilët është mbajtur vetëm tatim në burim bazuar në urdhrin e DP me nr. 1094 datë 01.07.2021. Nga Sektori i Financës, për pagesën është mbajtur tatim në burim në vlerën 15% dhe nuk është trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e punonjësve. Sa më sipër veprime në kundërshtim me neni 8 dhe neni 9 pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe shfuqizuar me ligjin me nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” neni 12, i cili shtrin efektet nga data 1 janar 2024 dhe Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar paragrafi 2.3, pika 2.3.1, i shfuqizuar me Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” paragrafi 12, i cili ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2024.

-Mangësi në dokumentacionin bashkëlidhur si kontrata/marrëveshja përkatëse mbi të cilën janë likuiduar urdhërshërbimet, dokumentacioni justifikues për kryerjen e udhëtimit si boarding pass, urdhërshërbimet për dieta jashtë vendit, autorizime pa nr. protokollit/datë, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur i fotokopjuar. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, nenin 2, pika 16 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”, pika 35, germa b.

Ne lidhje me auditimin e marrëveshjeve dhe kontratave të lidhura me donatorët përkatës si SIDA, Salstat, IPA 2019, konstatohet se i gjithë dokumentacioni është përpiluar në gjuhën angleze, por nuk rezultoi të jetë nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKLA Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”, Neni 4, pika 9. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 28-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga INSTAT të merren masat në vijimësi për plotësimin e urdhërshpenzimeve me dokumentacionin e plotë justifikues, si dhe për të gjithë dokumentacionin në gjuhë të huaj që INSTAT ka me donatorët, të merren masat për nënshkrimin e një kopje të dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës të protokollohet.

Menjëherë e në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktiveve afatgjata rezulton:

- për llogarinë 203 “*Koncesione, patenta, licenca të ngjashme*” norma e amortizimit e përdorur për të llogaritur amortizimin e kësaj klase është 25%. Metoda për përlllogaritjen e amortizimit është përdorur metoda me “*Vlerë të mbetur*”;
- për llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” norma e amortizimit e përdorur për përlllogaritjen e amortizimit është e ndryshme për asete të ndryshme. Normat e amortizimit që janë përdorur janë 5% për një pjesë të këtyre pajisjeve dhe 25% për një pjesë tjetër;
- për llogarisë 215 “*Mjete transporti*” u konstatua se norma e amortizimit e përdorur për përlllogaritjen e amortizimit është 5%;
- për llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*” u konstatua se një pjesë e aseteve të kontabilizuara në këtë llogari siç janë “Laptop 131156.8 KE”, “Kompjuter Workstation sida” duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”. Një pjesë tjetër siç janë “firewall sida”, “Firewall UTM” duhet të ishin kontabilizuar në llogarinë 203 “*Koncesione, patenta, licenca të ngjashme*”. Nisur nga analiza e zërave të aktiveve dhe amortizimit të tyre zë për zë u konstatua se disa artikuj janë amortizuar me normën 20% që nuk i përket grupit të cilit ato bëjnë pjesë, një pjesë tjetër janë amortizuar me norme 25%, një pjesë tjetër janë amortizuar me norme 5%. Sa më sipër veprime në kundërshtim të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektori të Financës në INSTAT të merren masa të menjëhershme për riklasifikimin e aseteve sipas klasave përkatëse, rillogaritjet e vlerave të amortizimeve sipas normave të klasave përkatëse të konstatuara si dhe të behet korrigjimi i të dhënave në programin financiar me të cilin operon INSTAT, duke bërë që llogaritjet e aktiveve afatgjata materiale të paraqiten në vlera të drejtë dhe të rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël.

Në vijimësi

12.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 42 “*Detyrime ndaj personelit*” konstatohet kontabilizimi i detyrimeve për qira ambientesh duke sjellë paraqitje jo të saktë të llogarive përkatëse të detyrimeve ndaj personelit dhe ndaj të tretëve;

- Nga auditimi i llogarive 435 “*Sigurime shoqërore*” dhe 436 “*Sigurime shëndetësore*” në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohet se tepricat e tyre paraqesin vlerën kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 të cilat nuk rakordojnë me vlerën totale të listepagesës E-sig025 të deklaruar në sistemin e tatimeve C@ts. Shumat sipas deklarimeve janë 13,055,393 lekë dhe 1,893,610 lekë, duke sjellë paraqitje jo të saktë të detyrimeve afatshkurtra.

- Nga auditimi i llogarisë 437, 438 “*Organizma të tjerë shtetërore*” konstatohet se teprica e saj në shumën 6,442,766 lekë përfaqëson kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 për punonjësit me kontratë, Teprica e kësaj llogarie duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 435, “*Sigurime shoqërore*” dhe llogarinë 436 “*Sigurime shëndetësore*”.

- Nga auditimi i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” konstatohet kontabilizimi i detyrimeve për paga, dieta, kompensime dhe shpërblime si dhe kreditore të ndryshëm.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 të MFE datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Aneksi 1, Klasa 4 Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve, detyrimet afatshkurtra. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektori të Financës në INSTAT të merren masa të menjëhershme për sistemimin e veprimeve kontabël sipas llogarive përkatëse me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të detyrimeve afatshkurtra që i perkasin njërive për periudhën ushtrimore sipas kërkesave të teknikave kontabël.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së aktiveve neto konstatohet se llogaria 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në shumën 296,350,065 lekë e cila përfaqëson investimet nga buxheti për vitin 2023 dhe llogaria 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja”, e cila përfaqëson investimet nga organizatat e huaja, dhe pse janë investime të cilat janë përfunduar brenda vitit 2023, rezulton se nuk janë kapitalizuar brenda periudhës ushtrimore të vitit 2023, por janë paraqitur në bilanc me tepricë të gjendjes së tyre. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me ne kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” aneksi 1, pika 1.1.2.c (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për kryerjen e sistemeve dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës konstatohet se:

14.1. Në lidhje me vlerësimet e kryera për rakordimin e të ardhurave konstatohet se kemi mospërputhje midis pasqyrës së performancës me rakordimin e thesarit, konkretisht në rakordim “Te ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve” paraqiten në shumën 48,486,700 lekë, ndërsa në pasqyrën e performancës paraqiten në shumën 37,704,000, pra me një diferencë prej 10,782,700 lekë, të pajustificuara. Gjithashtu, sa i takon njohjes së granteve të huaja, evidentohet që grantet e huaja në INSTAT, nuk janë njohur në pasqyrat financiare në total, por paraqiten vetëm në vlerën e cila është përdorur gjatë vitit ushtrimor. Mos njohja e shumës totale të granteve dhe sponsorizimeve në pasqyrat financiare sjell një pasqyrim jo të drejtë të këtyre fondeve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me UMF nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMF nr. 8 date 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njërive e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3 dhe pika 37.

4.2. Nga auditimi i shpenzimeve dhe rakordimit me thesarin, konstatohet se sa i takon llogarisë së shpenzimeve për blerje mallra dhe shërbime janë kontabilizuar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Nga auditimi i llogarisë analitike 602, konstatohet klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve në nënlllogaritë e saj, e cila ka sjellë denatyrimin e shpenzimit e kryer Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 09/03/2018 “Për procedurat

e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, seksioni 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës të merren masat e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve kontabël dhe rakordimit të të ardhurave me qëllim pasqyrimin sa më të saktë në pasqyrat financiare.

Në vijimësi

14.2. Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës të merren masat në vijimësi për të kryer dhe pasqyruar sakte shpenzimet e kryera sipas rregullave kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë në pasqyrat financiare.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura dhe njohjes së tyre në pasqyrat financiare të INSTAT u konstatua se:

1. detyrimet e prapambetura të regjistruara mbi sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si edhe tatimit nga të ardhurat personale paraqiten në shumën 0 (zero) lekë në pasqyrat financiare në datën 31.12.2023, ndërsa nga të dhënat e raportuara nga sistemi C@ts konstatohet se INSTAT ka gjendjen e detyrimeve në shumën 1,633,319 lekë, të cilat përfaqësojnë 995,000 lekë gjoba për deklarime të vonuara të deklaratave tatimore dhe 638,319 lekë interesa të përlllogaritura nga sistemi C@ts. Periudha e lindjes së këtyre detyrimeve fillon që nga viti 2014. Institucioni nuk ka marrë asnjë masë për evidentimin dhe pasqyrimin e këtyre detyrimeve në pasqyrat financiare apo shlyerjen e tyre. Detyrimet e lindura gjoba për “*Deklarime të vonuara*” në shumën 995,000 lekë janë lehtësisht të evitueshme duke bërë deklaratimet në kohë. Sa më sipër, diferenca prej 1,633,319 lekë nuk është njohur dhe regjistruar në pasqyrat financiare të institucionit;

2. Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore, njohjen e tyre në kontabilitet dhe likuidimin e tyre nëpërmjet bankës rezultoi se në vitin 2023 janë likuiduar në shumën totale vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë në shumën prej 818,960 lekë.

Këto vendime gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer.

- Si pasojë, llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të viteve 2022 dhe 2023. Në këtë zë nuk janë reflektuar detyrimet sa i takon shpenzimeve të periudhave të ardhshme për vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të vitit ushtrimor.

- Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 34 dhe 42. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas lindjes së detyrimit të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

15.2 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi për të rakorduar me Sektorin e Çështjeve Ligjore dhe Administrative, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës

të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

Në vijimësi

15.3 Rekomandimi: Sektori i Çështjeve Ligjore dhe Administrative, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i “*Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto*” konstatohet se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë me të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C. Aktivet neto rakordojnë me fondet neto, por për disa zëra nuk ka informacion sesi sektori i financës ka arritur në rezultatet e pasqyruara. Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura në burimet e brendshme. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MF nr.5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u konstatua se:

- Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 janë ngritur komisionet përkatëse të inventarizimit, por rezultoni se Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe anëtarë janë specialistët e Sektorit të Financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se “*Komisioni nuk duhet te jete me pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet te kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi ...*” si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 22 “*veprimtaria e kontrollit*” pika 3.b “*ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin*”;

- Nga auditimi i dosjes së inventarizimit u konstatua se materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi që nga momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë. Po ashtu nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive;

- Gjate procedurës së inventarizimit të aktiveve afatshkurtra “*Inventar qarkullues*” dhe “*Inventar i imët*” komisioni i inventarizimit dhe komisioni i vlerësimit nuk është shprehur lidhur me mallrat gjendje të cilët kanë një kohë të gjatë në magazinë në zbatim të paragrafit 103 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Duke mos u realizuar kjo detyrë nuk na jepet një pasqyre e sakte vlerës se magazinës

rrjedhimisht te fondeve neto te INSTAT Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 96. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vazhdimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat mund ta vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

Në vijimësi

17.2 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vazhdimësi për ndjekjen e procedurave për aktivet e dala jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit të atyre aktiveve që nuk kanë destinacion tjetër, me qëllim finalizimin e procesit të inventarizimit.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i magazinës u konstatua se:

- Procesi i hyrje-daljeve nga magazina mbahet me libër magazine manualisht, dhe jo me sistemin Alpha Web, të cilin INSTAT përdor për mbajtjet e kontabilitetit të njësisë;
- Dalja e inventarit nga magazina bëhet në fund të muajit, dhe jo për çdo kërkesë për tërheqje malli;
- Çdo vit bëhet mbartje e gjendjes së vitit paraardhës të inventarit qarkullues, duke hapur një libër të ri magazine, dhe rrjedhimisht sjell vështirësi në identifikimin e vjetërsisë së artikullit në magazinë, me qëllim menaxhimin më efektiv të magazinës;
- Artikuj të njëjtë të inventarit janë mbajtur në kartela të ndryshme, duke sjellë vështirësi në menaxhimin me efektivitet të magazinës.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 37. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat në vijimësi që për çdo hyrje/dalje nga magazina, të dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen/fletëdaljen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitet 2021-2023 u konstatua se:

- Në 8 dosje prokurimi dokumentacioni justifikues i procedurës nuk ishte i protokolluar.
- Në të gjithë procedurat e prokurimit fizike të arkivuara mungonte dokumentacioni i nevojshëm për gjurmë auditimi.
- Në 4 raste procedurat e prokurimit nuk ishin të arkivuara në SPE.
- Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për vitin 2021; 2022 dhe 2023 në lidhje për blerjet e realizuara nën 100,000 lekë rezultoi se bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit nuk administrohet dokumentacioni vërtetues mbi realizimin e procedurës nga testimi i tregut për përcaktimin e vlerës deri në fazën e përzgjedhjes së OE, me të cilin është realizuar transaksioni, si dhe nuk janë të parashikuara në regjistrat e parashikimit të prokurimit. Sa më sipër veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 4, pika 26

Sa më sipër veprime në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë; VKM-në nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 26 pika 6, si dhe udhëzimi i APP-së nr.2597 prot., datë 28.03.2024. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet nr. 51-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të INSTAT të marrë masa në vijimësi, që çdo dokument i krijuar nga vetë Institucioni, si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, të evidentohen në regjistrin e protokollit të institucionit, si dhe të jenë pjesë e dosjeve të arkivuara.

Menjëherë

19.2 Rekomandimi: Nga personat përgjegjës për prokurimet në INSTAT të merren masat e arkivimit të procedurave të prokurimit në SPE, si dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit sipas afateve ligjore në fuqi dhe përditësimin e regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit me të gjithë elementet e parashikuara.

Menjëherë

19.3 Rekomandimi: Zyrtarët e angazhuar në procedura prokurimi të marrin masat në vijimësi për dokumentimin me procesverbale përkatës të verifikimit të dokumentacionit provues të dorëzuar para shpalljes së fituesit nga operatorit ekonomik renditur i pari.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.962/8, datë 27.07.2023 me objekt “Trajtimin e punonjësve me catering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS 2023” me vlerë u konstatua se:

Me urdhrin nr.98, datë 01.08.2023 të titullarit të AK është caktuar një punonjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, dhe nuk është ngritur një komision për marrjen në dorëzim të shërbimit, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 42-43.

Nga auditimi i praktikës së bashkëlidhur urdhër shpenzimit, procesverbalet e hartuara, konkretisht i datë 31.08.2023 dhe një procesverbal pa datë por që i bashkëlidhet faturës të datës 04.10.2023, për marrjen në dorëzim nuk janë të shoqëruara me listat emërore të pjesëmarrësve siç citohet në procesverbal nga personi i ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35 dhe 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet nr. 51-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Titullarit i INSTAT të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune për verifikimin, analizimin dhe dokumentimin e zbatimit të kontratës, pasi ndjekja e zbatimit të saj nga një person nuk ofron siguri të arsyeshme të përdorimit të fondeve të shpenzuara për këtë shërbim.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të realizuara nga INSTAT për vitin 2023 me objekt: “Blerje licenca” i ndarë në 6 lote, “Blerje tonera”, “Furnizime me automjete me qira për CENS 2023”, “Shërbim mirëmbajtje pajisje kompjuterike” i ndarë në lote, “Trajtimin e punonjësve me catering gjatë realizimit të trajnimeve në kuadër të aktiviteteve CENS 2023”, “Shërbim mirëmbajtje/rinovim licencash”; “Shërbim mirëmbajtje/rinovim licencash” u konstatua se:

-Urdhri i titullarit të AK për ngritjen e komisionit të vlerësimit për procedurat prokurim; “Blerje licenca”, “Blerje tonera”, “Furnizime me automjete me qira për CENS) ka përfshirë të njëjtët punonjës që janë angazhuar në procese të tjera, siç është përlllogaritja e fondit limit.

-Në procedurat e prokurimit Anëtarët e grupit të përlllogaritjes së fondit limit nuk kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit;

- Në dosjet nuk dokumentohej formulari për zbatimin dhe raportimin e zbatimit të kontratës.

-Nga auditimi u konstatua se komisioni i blerjeve të vogla në INSTAT për dy procedura prokurime me objekt “Shërbim larje automjetesh” të realizuara për vitin 2022 dhe 2023 ka hartuar kritere teknike të kualifikimit, për OE pjesëmarrës, duke mos i argumentuar. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 124, pika 2, 3, dhe neni 125; VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 75 pika 4, si dhe nenin 13 pika 5, neni 77 pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet nr. 51-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të INSTAT të marrë masa në vijimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në të njëjtat procese pune, për të shmangur konfliktin e interesit, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se blerja e biletave është realizuar në kufijtë e datës së nisjes megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/ aktivitetit është dërguar disa javë para kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave. Kjo ka ardhur si pasojë e miratimit me vonesë të autorizimeve, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të INSTAT në këto aktivitete. Një fenomen i tillë sjell si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë, kur prokurohet pak ditë para datës së nisjes, krahasuar me çmimet e tregut. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet nr. 51-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet jo në datë të përafërt (apo brenda ditës) me datën e nisjes;

Në vijimësi

22.2 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa që në të gjitha praktikat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave t’i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rekrutimet e stafit të përkohshëm për realizimin e anketave afatshkurtra dhe afatgjata që INSTAT realizon çdo vit në kuadër të misionit të institucionit konstatohet se pozicionet e punës për këta punonjës nuk janë shpallur në faqen zyrtare, por për rekrutimin e tyre nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore kontraktohen të njëjtët punonjës, të cilët përzgjidhen sipas një databazë që administrohet ndër vite nga ana tyre për mbarëvajtjen e procesit. Në Rregulloren e Brendshme të Institucionit nuk parashikohet një metodologji për rekrutimin e punonjësve “anketues”, “teknik të specialiteteve të ndryshëm”, “kontroll terreni”, “operatorë” etj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me

Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe manualin e MFK-së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, kapitulli 3.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 95-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Nga ana e strukturave drejtuese në INSTAT, të merren masat e nevojshme për hartimin e një metodologjie në lidhje me punësimin e punonjësve me kontrata pune për anketat që zhvillohen, si dhe publikimin e shpalljeve për vendet vakante në faqen zyrtare me qëllim realizimin e një procedure transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në INSTAT, u konstatua se:

- parregullsi dhe mangësi në dokumentacionin e dosjeve të personelit, si fletat e Inventarit të firmosura nga nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore, Vërtetimi i Gjendjes Gjyqësore, Raporte Mjekoligjor të përditësuar.

- nga ana e institucioneve të varësisë (Zyrat Rajonale Statistikore), si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raporte monitorimi 4 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik;

- urdhër shpenzimet për pagesat e anketuesve, paguar me kapitullin 6, konstatohet se nuk janë bashkëlidhur dokumentet e cituara ne urdhër-shpenzim, si borderotë, Listëprezencat;

- urdhri për ngritjen e GMS-së nuk është rishikuar për çdo vit për të përcaktuar personat përgjegjës;

- INSTAT nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e saj;

- nuk është botuar në fletoren zyrtare delegimi i kompetencave për Autoritetin Kontraktor për vitin 2021,

- mungesë e gjurmës së auditimit sa i takon procesit të hyrje-daljeve në magazinë

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 16; Ligjin nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” kreu II, neni 29; Ligji Nr.152/2023 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; VKM Nr. 124, datë 17.02.2016 (i ndryshuar me VKM nr 747, datë 19.12.2018) “Për pezullimin dhe lirin nga Shërbimi Civil” kreu III, pika 23, paragrafi 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 95-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të INSTAT, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

Brenda vitit 2024 e në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i fazës parapërgatitore e Projektit të Cens-it 2023 u konstatua se:

1. Nga Strukturat Drejtuese të INSTAT është miratuar kërkesa e Ekipit të Organizimit dhe Logjistikës për sigurimin e një ambienti (magazinë) “*privat*” (me kontratë qiraje), për vendosjen e pajisjeve elektronike të cilat shërbejnë për grumbullimin e të dhënave të popullsisë dhe banesave, në kuadër të organizimit të të gjithë procesit të Cens-it 2023 (grumbullim të dhënash të popullsisë, përpunim të dhënash popullsisë). veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 140/2020 “*Për censin e popullsisë dhe banesave*”, pikat 4 dhe 5, duke cenuar parimet e “sigurisë” së të dhënave sensitive si edhe “*konfidencialitetin*” e tyre.

2. Nga auditimi i raporteve periodike të dërguara nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Cens-it, drejtuar Komisionit Qendror të Cens-it u konstatua se, nuk është njoftuar dhe vënë në dijeni në lidhje me nevojën për sigurimin e një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për pajisjet elektronike (tableta), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 140/2020 “*Për censin e popullsisë dhe banesave*”, pikat 11 dhe 12.

3. Nga kërkesa me nr. 861 prot., datë 09.05.2023 e bërë nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës për tenderimin e marrjes me qira të ambienteve u konstatua se ka një mospërputhje të specifikimeve të kërkuara për ambientin (magazinë), me kërkesën fillestare të dërguar në Ministrinë e Mbrojtjes me shkresën nr.685 prot., datë 22.04.2022 ndryshime të cilat janë të paargumentuara, ku përkatësisht:

Në kërkesën drejtuar MM-së, është specifikuar se ambienti duhet të jetë minimalisht 650 m2 ndërkohë që në kërkesën e EOL në INSTAT është specifikuar se ambienti duhet të jetë minimalisht 580 m2, për rrjedhojë me një diferencë prej 70 m2.

Gjithashtu konstatohet se në kërkesën fillestare drejt MM është specifikuar se vendndodhja të jetë brenda territorit Bashkisë Tiranë, ndërkohë që në kërkesën e EOL në INSTAT është specifikuar se ambienti të jetë në territorin e Bashkisë Tiranë në brendësi të Unazës së Vogël e aksesueshme me linjë transporti publike, duke vijuar me kërkimin edhe të posteve të parkimit për punonjësit. Në lidhje me specifikimet e sigurisë për ambientin, Grupi i Auditimit konstaton se ka mospërputhje midis kërkesës fillestar drejt MM në të cilën është kërkuar ruajtje fizike 24 orë, ndërkohë që në kërkesën e EOL në INSTAT, aspekti i ruajtjes fizike 24 orë nuk është i përfshirë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet nr. 107-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.1 Rekomandimi Nga ana e Titullarit të Institucionit në bashkëpunim me strukturat drejtuese në INSTAT, të merren masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin e mangësive të evidentuara gjatë fazës së planifikimit të kryerjes së Projektit të Cens-it, mbi procedurat e magazinimit të pajisjeve elektronike në një ambient privat, duke sjellë risk të lartë mbi sigurinë e të dhënave, si dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse mbi mospërputhjen e specifikimeve teknike midis kërkesës drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe kërkesave të parashikuara nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës (EOL).

Menjëherë e në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përzgjedhjes së ambienteve me qira u konstatua se:

-Komisioni i i përzgjedhjes për marrjen me qira të ambientit magazinë ka analizuar tregun me qëllim përcaktimin çmimit referencë bazuar në specifikimet teknike të vendosura, ku ka rezultuar se vetëm njëra prej ofertave ishte sipas specifikimeve të kërkuara nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës, e cila më pas është miratuar nga Titullari i Institucionit. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Urdhrin nr. 76 datë 13.06.2023 “*Për ngritjen e grupit të punës për përzgjedhjen e ambienteve me qira*”, pika 5 dhe 6.

- Sa i takon procesit të sigurimit të një ambienti për magazinim të pajisjeve, INSTAT nuk i është përmbajtur specifikimeve të sipërfaqeve sipas kërkesës fillestare drejtuar MM-së, si dhe gjatë

procesit të marrjes me qira të ambientit nga lidhja e kontratës bashkë me amendimin e kryer, i gjithë procesi ka qenë i pa argumentuar dhe i pa studiuar, konkretisht duke mos i'u përmbajtur kërkesave fillestare të përcaktuara në lidhje me sipërfaqen e ambientit si dhe nëpërmjet amendimit të kontratës së qirasë me qëllim zgjatjen e afatit mbi të cilin nuk paraqitet një analizë konkrete me arsyet specifike të këtij ndryshimi. Nga verifikimi në terren i ambientit të kontraktuar me qira, njësia "Garazh" është përdorur si parkim gjatë dorëzimit të materialeve për procesin e Cens, si dhe marrjes në dorëzim pas mbylljes së procesit, por aktualisht, kjo njësi nuk ka asnjë material brenda dhe nuk përdoret nga INSTAT, por vazhdon të paguhet qira mujore.

-Në ambientin e magazinës ruheshin dhe magazinoheshin pajisjet elektronike - tabletat. Njësia ku magazinoheshin tabletat *ambienti nuk ishte i pajisur me sistem kondicionimi kishte lagështirë në një pjesë të saj, si dhe objekti i marrë me qira aksesohet nga disa hyrje*, veprime në kundërshtim me specifikimet teknike të vendosura nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës.

- Nga auditimi i kontratës nr.1149/4 prot, datë 29.12.2022 me objekt "Shërbimi dhe ruajtjen e sigurisë fizike të ambienteve të INSTAT" i shoqëruar edhe me amendimin e kontratës me nr.1149/6 prot, datë 08.08.2023 me objekt "Ndryshimi i nenit 3 çmimi dhe vlera e kontratës" dhe Aneksit nr.1 duke shtuar objektin e ruajtjes së Magazinës me kohë ruajtje fizike 8 (tetë) orë (duke filluar nga ora 22:00 deri 06:00) nga e hëna në të dielë, u konstatua se, në amendim kontrate nuk specifikohet sesi do të bëhej ruajtja e magazinës Cens, por nga procesverbal i vënë në dispozicion nga përfaqësuesi i I.G sh.a.(pa datë), citohet se shërbimi është kryer me roje fizike për turnin e tretë, ndërsa turni i parë dhe i dytë me grupin e verifikimit të sinjaleve. Sa më sipër, ka një mospërputhje të termave të përcaktuara në Aneksin nr.1 të kontratës nr.1149/4 prot, datë 29.12.2022 dhe nr.1149/6 prot, datë 08.08.2023 dhe informacionit të vënë në dispozicion nga shoqëria I.G sha. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet nr. 107-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

26.1 Rekomandim: Nga ana e Titullarit të Institucionit në bashkëpunim me strukturat drejtuese në INSTAT të merren masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizimin e problematikave të konstatuara në lidhje me procesin e përzgjedhjes së ambienteve dhe pas evidentimit të mangësive në lidhje me kushtet e sigurisë, të kryhen përmirësimet konkrete duke rishikuar kushtet e kontratës së qirasë, me qëllim parandalimin në të ardhmen për rreziqet e mundshme nga humbja e të dhënave sensitive në kuadër të Projektit të Cens-it 2023.

Menjëherë e në vijimësi

26.2 Rekomandim: Nga ana e Titullarit të Institucionit në bashkëpunim me strukturat mbështetëse në INSTAT të merren masat e nevojshme për rishikimin e kontratës së qirasë me qëllim identifikimin e ambienteve të përdorshme dhe domosdoshme dhe për ato të pa përdorshme të merren masa për ndërprerjen e pagesave në vijim.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Referuar kontratës së blerjeve të pajisjeve elektronike – tableta, në kuadër të Projektit të Censit, si dhe Fletë Hyrjeve përkatëse në magazinën qendrore të INSTAT-it, numri total i këtyre pajisjeve rezultoi 7,700 copë. Nga verifikimi i procesverbaleve, konstatohet se në magazinën e Cens-it janë në total 6,963 copë. Diferenca prej 737 tableta (7,700 – 6,963), sipas shpjegimeve të dhëna nga personat përgjegjës dhe procesverbale e vëna në dispozicion, vazhdojnë të jenë në përdorim për projekte dhe anketa të ndryshme nga stafi monitorues i Cens në INSTAT, për të cilat janë mbajtur vetëm proces verbale të dorëzimit në fillim të procesit të numërimit të Cens, për rrjedhojë nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se nuk janë të

dokumentuara të gjitha proceset e cituara më sipër, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 19 “Gjurma e Auditimit”, si dhe neni 12, pika 3 germa “dh”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet nr. 107-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Nga ana e Strukturave përgjegjëse të merren masat e nevojshme për finalizimin e procesit të mbledhjes së tabletave që vijnë në përdorim për projekte dhe anketa të ndryshme jashtë Projektit të Cens-it, me qëllim reduktimin e riskut mbi dokumentimin e plotë të gjurmës së auditimit.

Menjëherë e në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve mbi të ardhurat e trashëguara nga donatorët ndër vite, konstatohet se 6 (gjashtë) urdhër shpenzime në shumën prej 2,213,360 lekë për dieta jashtë vendit dhe bileta avioni janë likuiduar në mospërputhje me marrëveshjet/kontratat përkatëse me donatorët IPA 2015, IPA 2017, si dhe legjislacionin shqiptar, specifikisht VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, lidhja 1. Nga auditimi i kontratave specifike të lidhura me donatorët IPA 2015 dhe IPA 2017, konstatohet se për pagesën e dietave/biletave të avionit ku përfaqësues të INSTAT kanë qenë pjesëmarrës nëpër konferenca/forume të ndryshme, të cilat nuk janë kryer në përputhje me objektin e marrëveshjes së lidhur, por janë përdorur sipas vendimmarrjes të INSTAT-it, duke mos u bazuar në legjislacionin shqiptar. Për rrjedhojë, vlera e paguar në shumën prej 2,213,360 lekë , konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 28-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e strukturave drejtuese në INSTAT të merren masat për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin e ligjshmërisë për të gjitha pagesat e kryera për trajtimet financiare të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit me burim financimi nga donatorët e huaj, duke specifikuar në mënyrë të detajuar marrëveshjet dhe kontratat përkatëse me donatorët si dhe për të gjitha urdhër shpenzimet të evidentuara, të nxirren përgjegjësitë e likuidimit të tyre jo sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, me qëllim shmangien e përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet si pasojë e likuidimit për dieta jashtë vendit dhe bileta avioni në shumën 2,213,360 lekë.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi u konstatua se INSTAT ka planifikuar dhe realizuar tre procedura të prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbimin e monitorimit mediatik” për vitet objekt auditimi, konkretisht për vitin 2021 me vlerën 458.900 lekë (mosrealizim kontrate), për vitin 2022 me vlerën 733,323 lekë me tvsh dhe 2023 me vlerën totale 720,000 lekë me tvsh. Referuar kontratave të nënshkruara me OE respektivë rezultoi se më anë të këtyre prokurimeve janë ndërtuar arkiva elektronike të çdo lajmi në mediat e monitoruara, shërbim ky, që duhet të realizohet nga pozicioni specifik i parashikuar në strukturën e institucionit, ‘Specialisti për Monitorimin dhe Raportimin Mediatik’ i cili ka detyrë funksionale realizimin e shërbimit për të cilin është pajtuar OE, bazuar në Rregulloren e Brendshme të INSTAT dhe përskrimeve të

pozicioneve të punës. Planifikimi dhe realizimi i këtyre shpenzimeve është bërë pa efektivitet në vlerën 1,453,323 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 95-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese, të marrin masa në vijimësi për mosrealizimin e procedurave të prokurimit të cilat janë të realizueshme nga stafi i INSTAT bazuar në përshkrimet e punës sipas përcaktimeve në Rregulloren e Brendshme, me qëllim shmangien e përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet si pasojë e likuidimit të shpenzimeve për shërbime që duhet t'i bënte specialisti në shumën **1,453,323 lekë**.

Menjëherë e në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i detyrimeve të prapambetura të deklaruara në pasqyrat financiare me ato në sistemin tatimor C@TS konstatohet se Instituti i Statistikave ka detyrime në Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe detyrime për tatimin nga të ardhurat personale në vlerën 1,633,319 lekë ku të ndarë sipas llojeve të tatimit vërehet se peshën më të madhe e kanë Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 1,382,556 lekë dhe Tatim mbi të ardhurat personale në vlerën 250,763 lekë. Këto detyrime nuk janë kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare, të cilat përfaqësojnë gjoba të regjistruara, gjoba të paregjistruara si dhe interesa të regjistruara dhe të paregjistruara në Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale. Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit verifikoi “moshën” e borxhit në këto lloje tatimesh si dhe arsyen e këtyre vlerave ku konstatohet se të gjitha këto vlera janë vetëm gjoba dhe interesa.

Në analizën e kryer u konstatua se këto gjoba dhe interesa vijnë si rezultat i deklarimeve me vonese të deklaratave tatimore (formularëve ESIG027) në Shumën 995,000 leke, pagese me vonesë të detyrimeve të lindura nga formularët ESIG027 për periudha të ndryshme 387,556 lekë si dhe interes i regjistruar në shumën 250,763 lekë gjeneruar nga sistemi i tatimeve për pagesat e kryera me vonesë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, tatim mbi të ardhurat personale si dhe tatim në burim. Sektori i Financës në INSTAT nuk ka ndjekur ecurinë e këtyre detyrimeve periodikisht si dhe nuk i kanë pasqyruar në detyrimet e prapambetura në pasqyrat financiare të INSTAT duke mos i “njohur” ato si të tilla, çka ka sjellë mos pasqyrim të drejtë të llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Instituti i Statistikave në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrin masa të menjëhershme vlerësimin dhe shlyerjen/sistemimin e detyrimit të shkaktuar nga ndërhyrja në sistemin tatimor duke gjeneruar gjoba dhe kamatëvonesa, me qëllim shmangien e përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet në shumën **1,633,319 lekë**.

Menjëherë e në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE:

C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE:

Mbështetur në nenin 59, pika 4, germa “a” dhe “b”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Titullarit të Institutit të Statistikave, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të cituara më poshtë, sipas përgjegjësive individuale të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës nga “vërejtje” deri në “largim”, për punonjësit si më poshtë:

1. A.C., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm; në cilësinë Kryesuesit të Njësisë së Kordinimit të Censit, për parregullsitë e konstatuara për Projektin Cens, si dhe të ardhurat e trashëguara nga donatorët. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet nr. 107-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. H.M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave; në cilësinë Anëtarit të Njësisë së Kordinimit të Censit, për parregullsitë e konstatuara për Projektin Cens. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet nr. 107-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. K.Sh., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Kordinimit, në cilësinë Anëtarit të Njësisë së Kordinimit të Censit, për parregullsitë e konstatuara për Projektin Cens. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet nr. 107-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. E.S., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor në cilësinë Anëtarit të Njësisë së Kordinimit të Censit, për parregullsitë e konstatuara për Projektin Cens. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet nr. 107-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. A.B., me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Financës, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për parregullsitë e konstatuara në argumentimin e fondit limit duke bërë studimin e tregut, ka publikuar ftesën për ofertë dhe ka parashikuar kushtet që duhet të plotësoj OE i cili duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi të tipit C kriter i cili nuk është i argumentuar, si dhe për mangësitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 34-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. A.Xh., në cilësinë e Drejtorit i Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve ka aprovuar kërkesën për Shërbimin e Monitorimit Mediatik. Është nënshkruar kontrata për dy vite të njëpasnjëshme për realizimin e një shërbimi i cili në bazë të Rregullores së Brendshme të INSTAT dhe përshkrimeve të pozicioneve të punës ka një pozicion specifik të parashikuar në strukturën e institucionit Specialisti për Monitorimin dhe Raportimin Mediatik i cili ka detyrë funksionale realizimin e shërbimit për të cilin është pajtuar OE. Planifikimi dhe realizimi i këtyre shpenzimeve është bërë pa efektivitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 95-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. M.L., në cilësinë e Përgjegjësi i Sektorit, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun: në datën 24.01.2022 ka bërë kërkesën për Shërbimin e Monitorimit Mediatik me argumentimin :Për kryerjen e detyrave dhe përmbushjes së përshkrimit të punës për monitorimin e përditshëm mediatik Është nënshkruar kontrata për realizimin e një shërbimi i cili në bazë të Rregullores së Brendshme të INSTAT dhe përshkrimeve të pozicioneve të punës ka një pozicion specifik të parashikuar në strukturën e institucionit Specialisti për Monitorimin dhe Raportimin Mediatik i cili ka detyrë funksionale realizimin e shërbimit për të cilin është pajtuar OE. Planifikimi dhe realizimi i këtyre shpenzimeve është bërë pa efektivitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 95-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. E.A., në cilësinë e Specialisti i Marrëdhënieve me Publikun , Sektori i Marrëdhënieve me

Publikun; ka bërë kërkesën me nr. 440 prot. e datës 06/03/2023 për Shërbimin e Monitorimit Mediatik me argumentimin :Për kryerjen e detyrave dhe përmbushjes së përshkrimit të punës për monitorimin e përditshëm mediatik Është nënshkruar kontrata për për realizimin e një shërbimi i cili në bazë të Rregullores së Brendshme të INSTAT dhe përshkrimeve të pozicioneve të punës ka një pozicion specifik të parashikuar në strukturën e institucionit Specialisti për Monitorimin dhe Raportimin Mediatik i cili ka detyrë funksionale realizimin e shërbimit për të cilin është pajtuar OE. Planifikimi dhe realizimi i këtyre shpenzimeve është bërë pa efektivitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 95-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9. B.K, me detyrë specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe i Integritimit Evropian, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për parregullsitë e konstatuara në argumentimin e fondit limit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 95-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10. A.D, me detyrë specialist në Sektorin e Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për parregullsitë e konstatuara në argumentimin e fondit limit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 95-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

C.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e konstatuar me shkelje të natyrës administrative nuk rekomandojmë masa disiplinore, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga “vërejtje” deri në “largim”, për punonjësit si më poshtë:

1. Z. D.K, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për parregullsitë e konstatuara në argumentimin e fondit limit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

2. Z. A.D, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për parregullsitë e konstatuara në argumentimin e fondit limit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

V. ANEKSE.

Drejtimi 2.1: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit.

Tabela 1: Kostot e projektit të Cens-it:

Shpenzimet:	Planifikimi	Kostot	% realizimit	Shënime për kostot në periudhën 2019-31.12.2023
Anketues (5240, për një periudhë kohore 2.1 muaj)	3,837,174	3,665,652	95.53	Grumbullimit i të dhënave në terren (Shtator-Nëntor)
Anketues special (72, për 1 muaj të cilët kryen mbledhjen e të dhënave në banesat kolektive)	28,476	24,842	87.24	Për mbledhjen e të dhënave në banesat kolektive (shtëpi fëmijësh, azile, konvikte etj) si dhe institucione korrektuese dhe penale IEVP/burgje.
Operator (20 Operator GIS për 10 muaj)	70,000	70,000	100	Kontrollit të cilësisë së azhornimit të hartave për vitin 2019.
Anketues GIS (113, për 9 muaj)	332,171	332,171	100	Për azhornimin e hartave në terren në vitin 2019 janë rekrutuar mesatarisht.
Shoferet për automjetet e marra me qera për selinë(viti 2019-2022)	13,240	13,238	99.98	Ne kuadër të aktiviteteve të Cens është rekrutuar 1 shofer për periudhën 2019-2022 mesatarisht për 37 muaj
Shoferet për automjetet e marra me qera për selinë (viti 2023)	5,250	3,196	60.87	Ne kuadër të aktiviteteve të Cens është rekrutuar 1 shofer për 8 muaj për vitin 2023

‘në euro

Drejtes për mjetet e marra me qira për transport për Njësitë e Regjistrimit të Bashkisë (viti 2023)	56,700	52,311	92.26	Janë rekrutuar mesatarisht 46 shofere për 2.8 muaj në nivel bashkie për vitin 2023 për te suportuar lëvizjen e stafit te Instat për monitorimit te terrenit dhe stafit te terrenit në zonat e Censit.
Anketues (47 anketues për 1.4 muaj, viti 2021)	21,707	21,707	100	Për mbledhjen e të dhënave gjatë Pilotit te dytë të Cens në vitin 2021 janë rekrutuar mesatarisht 47 anketues për 1.4 muaj.
Kontrollorë (6 kontrollorë për 1.8 muaj, viti 2021)	3,780	3,780	100	Për kontrollin e mbledhjes se te dhënave gjatë kryerjes se anketës për Pilot Cens 2021
Supervizorë (3 supervizorë për 2 muaj, viti 2021)	2,130	2,130	100	Ne kuadër të mbikqyrjes së procesit të realizimit të anketës se Pilotit te dyte te Cens 2021
IT support staf (3 staf IT për 1.8 muaj, viti 2021)	1,938	1,938	100	Për suportin stafin e terrenit për Pilotin e dyte të Cens 2021
Monitorimi dhe kontrolli i cilësisë nga operatorët GIS për përditësimin e hartave në zonat e përzgjedhura	1,400	1,400	100	Për kryerjen e kontroleve te cilësisë se azhornimit të hartave në terren për vitin 2021 janë rekrutuar 4 operator GIS per 1 muaj.
Regjistruues GIS për Pilotin e Dytë dhe PES (3 persona për 3 muaj viti 2021)	4,800	4,800	100	Anketa e mbulimit pas Cens Pilot
Operatorët GIS për Pilotin e Dytë dhe PES "2021" (2 operatorë*3 muaj, viti 2021)	2,100	2,100	100	Anketa e mbulimit pas Cens Pilot
Anketues për testimet CAPI (28 persona për 1 muaj)	9,163	9,163	100	Për testimin e aplikacionit CAPI dhe per monitorimin e infrastrukturën e TI-së
Kontrollorë për testimet CAPI (6 persona për 1 muaj)	2,017	2,017	100	Për kontrollin punën e anketës për aplikacionin CAPI
Supervizorë CAPI Tests (1 person për 1 muaj)	355	355	100	Për mbikëqyrjen e procesin e testimit të aplikacionit CAPI
IT support staf CAPI Tests (1 person për 1 muaj)	355	355	100	Për suportimin IT për testimin e aplikacionit CAPI
Anketues GIS për kryerjen e përditësimit të hartave (73 anketues GIS për 2 muaj, viti 2022)	45,621	45,621	100	Për kryerjen e përditësimit te hartave kryesisht në zonat me densitet të lartë
Operatorët GIS (5 operatore GIS për 2.7 muaj, viti 2022)	5,550	5,664.75	102.07	Për kryerjen e përditësimit te hartave kryesisht në zonat me densitet të lartë
Anketues GIS për gjeokodimin (85 anketues GIS për 2.6 muaj, viti 2023)	96,601	88,989	92.12	Për realizimin e procesit të gjeokodimit te ndërtesave kryesisht për ndërtesat e saponëduara ose të shkatërruara
Staf për logjistikën (3 persona për 1 muaj, viti 2023)	3,700	1,380	37.30	Për sistemin e bazës materiale të Censit.
Magaziniere (2 persona për 5 muaj, viti 2023)	14,798	4,479	30.27	Ne kuader te magazinimit te materialeve te Cens, magazinierët kane qene përgjegjës për regjistrimin e hyrje/daljeve te materialeve te Cens nga magazina dhe përgatitjen e dokumentacionit shoqërues.
Dieta për stafin e INSTAT-it për monitorimin e punës në terren	123,437	118,425	95.94	Për monitorimin e punës në terren për Cens Pilot (2019, 2021), 5 Testet e kryera dhe Cens 2023 në terren.
Totali për Burimet njerëzore	4,682,464	4,475,716	96%	
Makina me qira, në nivel qarku (13 makina për 3.3 muaj)	107,560	56,802	52.81	Për transportin e stafit te Cens ne nivel qarku.
Makina me qira, në nivel bashkie(54 makina për 3 muaj)	223,406	193,291	86.52	Për të suportuar lëvizjen e stafit te Cens në nivel bashkie ne zonat rurale dhe urbane.
Tableta	2,217,594	2,210,054	99.66	Për të realizuar anketën e Cens në vitin 2023 janë blerë 7700 tableta për stafin e angazhuar në procesi e grumbullimit të të dhënave (anketues, supervizorë, kontrollorë dhe staf mbështetës)
Tableta për pilotin e parë	28,000	28,000	100	Janë blerë 100 tableta për realizimin e anketës së pilotit të parë në Cens në vitin 2019
Totali për Pajisje zyre dhe mjete elektronike	2,576,560	2,488,148	97%	
Zyra me qira në nivel qarku	30,491	6,464	21.20	Jane marre 4 zyra ne nivel qarku per 4 muaj.
Zyra me qira në nivel bashkie	127,676	37,358	29.26	Ne nivel bashkie jane marre me qira 25 zyra per mesatarisht 3.4 muaj.

Magazinë me qira	70,000	13,055	18.65	Magazine me qira per grumbullimin, shpërndarjen dhe ruajtjen e materialeve te Cens sipas afateve ligjore.
Totali për qiratë	228,167	56,877	25%	
Karburant për transportimin e Census	79,995	61,060	76.33	Është blere karburant për te siguruar lëvizjen e 67 automjeteve gjate periudhës se terrenit.
Kostoja e trajnimit për aktivitetet e stafit në terren	712,900	334,136	46.87	Kosto trajnimi dhe akomodimi për stafin e përfshirë ne Cens (anketues, kontrollore, supervizorë (IT+ Terren), trajnues, Staf mbështetës)
Totali për shpenzime të tjera	792,895	395,196	50%	

Tabela 2: Të ardhurat e trashëguara nga donacionet

Viti 2021/donacionet

'në lekë

Donatori	Gjendja me 01.01.2021	Hyrje	Shpenzime	Gjendja ne fund
Gopa	123,766,057	6,443,341	83,995,438	46,213,960
ADENDIUM	2,155,163			2,155,163
INSTAT KOSOVE	1,391,891			1,391,891
Unesco	632,089			632,089
Puna Gjelber	399,069			399,069
AMF	1,674,928			1,674,928
Korrupsioni 1+2	199,354			199,354
Te ndryshme	324,115			324,115
Oferta Drurit	20,528			20,528
Turizmi ne familje	975,209			975,209
Turizmi ne ndermarje	1,209,320			1,209,320
Arsimi i te rriturve	2,046,045			2,046,045
Migracioni	8,882			8,882
ASE (Sociale Europiane)	121,177			121,177
UET	1,846,193			1,846,193
Salstat	1,452,439			1,452,439
UNFPA	0	5,061,653	5,061,402	251
Shendetesia EHS	1,555,933		683,747	872,186
SMEI (Riimbursim Fondesh)		1,618,300		1,618,300
PPP	134,216			134,216
SHUMA	139,912,609	13,123,293	89,740,587	63,295,315

Burimi i të dhënave INSTAT, përpunuar nga GA.

Viti 2022/donacionet

'në lekë

Donatori	Gjendja me 01.01.2022	Hyrje	Shpenzime	Gjendja ne fund
PPP (gopa)	46,348,423	19,967,775	9,111,763	57,204,435
ADENDIUM	2,155,163			2,155,163
INSTAT KOSOVE	1,391,891			1,391,891
Unesco	632,089			632,089
Puna Gjelber	399,069			399,069
AMF	1,674,928			1,674,928
Korrupsioni 1+2	199,354			199,354
Te ndryshme	324,115			324,115
Oferta Drurit	20,528			20,528
Migracioni	8,882			8,882
ASE (Sociale Europiane)	121,177			121,177
UET	1,846,193			1,846,193
UNFPA	251			251
Shëndetësia EHS	872,186			872,186
Turizmi ne familje	975,209			975,209
Turizmi ne ndermarje	1,209,320			1,209,320
Arsimi i te rriturve	2,046,045			2,046,045
Salstat	1,452,439			1,452,439
SMEI	1,618,300			1,618,300

UNDP (anketa e te moshuarve)	-249			-249
SHUMA	63,295,313.19	19,967,774.71	9,111,763.00	74,151,324.90

Burimi i të dhënave INSTAT, përpunuar nga GA.

Viti 2023/donacionet

'në lekë

Donatori	Gjendja me 01.01.2023	Hyrje	Shpenzime	Gjendja ne fund
PPP (gopa)	57,204,435	2,457,542	3,996,521	55,665,456
ADENDIUM	2,155,163			2,155,163
INSTAT KOSOVE	1,391,891			1,391,891
Unesko	632,089			632,089
Puna Gjelber	399,069			399,069
AMF	1,674,928			1,674,928
Korrupsioni 1+2	199,354			199,354
Te ndryshme	324,115			324,115
Oferta Drurit	20,528			20,528
Migracioni	8,882			8,882
ASE (Sociale Europiane)	121,177			121,177
UET	1,846,193			1,846,193
UNFPA	251			251
Shendetesia EHIS	872,186			872,186
Turizmi ne familje	975,209			975,209
Turizmi ne ndermarje	1,209,320			1,209,320
Arsimi i te rriturve	2,046,045			2,046,045
Salstat	1,452,439	787,396	1,822,646	417,189
SMEI	1,618,300			1,618,300
UNDP (anketa e te moshuarve)	-249			-249
SHUMA	74,151,325	3,244,938	5,819,167	71,577,096

Burimi i të dhënave INSTAT, përpunuar nga GA

Drejtimi 2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Aneks nr. I:

Fatura të shlyera mbi afatin 30 ditor/ Viti 2022

'në lekë

Nr.	Furnitori	Data e faturës	Data e USH	Shuma
1	F.	3/25/2022	7/21/2022	440,596
2	A sh.a.	5/4/2022	7/12/2022	11,359
3	B.A	10/10/2022	12/7/2022	140,124
4	K.S	11/15/2022	12/30/2022	1,357,036
5	F.	1/29/2022	3/29/2022	3,124
6	U.E	10/25/2022	12/16/2022	90,000
7	P.S	11/3/2022	12/21/2022	476,847
8	C.P	12/31/2021	2/10/2022	58,000
9	I sh.a	3/28/2022	5/11/2022	144,918
10	K.K	8/19/2022	9/30/2022	78,456
11	C.P	11/14/2022	12/21/2022	179,100
12	I.S	8/8/2022	9/14/2022	3,598,978
13	K.K	10/31/2022	12/6/2022	25,742
14	S.C	11/2/2022	12/6/2022	154,800
15	S.C	11/2/2022	12/6/2022	154,800
16	K.K	10/18/2022	11/21/2022	84,672
17	F.	2/23/2022	3/29/2022	447,652
18	I.S	8/1/2022	9/1/2022	2,058,658
19	A.T.B.T.O	10/20/2022	11/23/2022	51,090
20	E.T.T	11/22/2022	12/21/2022	44,460
21	F.	1/25/2022	3/1/2022	404,308
22	E.T.T	10/10/2022	11/14/2022	58,655
23	A.A	6/15/2022	7/13/2022	298,800

24	I.O	3/15/2022	4/11/2022	1,619,090
25	I.O	6/14/2022	7/13/2022	717,798
26	F	10/29/2022	11/30/2022	2,183
27	G.E	11/10/2022	12/7/2022	10,226
28	P.I	1/13/2022	2/10/2022	12,000
29	K.K	9/8/2022	10/10/2022	128,880
30	T.P SH.P.K	5/4/2022	6/2/2022	304,800
31	C.P	2/28/2022	3/29/2022	58,000
32	G.T	9/9/2022	10/10/2022	2,222,222
33	I.G	1/31/2022	3/1/2022	425,748
34	F.	5/28/2022	6/28/2022	1,528
35	U.K.T	2/28/2022	3/29/2022	36,552
36	P.A	4/29/2022	5/30/2022	187,200
37	P.S	6/28/2022	7/28/2022	580,800
38	I.S	6/13/2022	7/12/2022	421,822
39	O.	4/22/2022	5/20/2022	695,281
40	A sh.a	7/31/2022	8/30/2022	9,680
41	A.T.T	9/2/2022	9/29/2022	57,600
42	P.Sh sh.a	9/2/2022	9/30/2022	1,125
43	B.M	7/22/2022	8/18/2022	263,760
44	Fshu	4/26/2022	5/26/2022	408,340
45	A.T.T	9/2/2022	9/29/2022	69,600
46	F.	9/30/2022	10/28/2022	3,376
Totali				18,599,786

Burimi i të dhënave INSTAT, përpunuar nga GA.

Fatura të shlyera mbi afatin 30 ditor/ Viti 2023

'në lekë

Nr.	Furnitori	Data e faturës	Data e USH	Shuma
1	P.Sh sh.a	2/8/2023	2/15/2024	1,720
2	I.S	12/15/2022	7/13/2023	141,834
3	M.I	4/28/2023	10/3/2023	75,864
4	O.T.T	11/15/2023	4/16/2024	49,500
5	K.T	11/15/2023	4/16/2024	34,300
6	I.G	8/24/2023	12/27/2023	82,403
7	K.K	3/29/2023	7/26/2023	36,025
8	M.L	10/10/2023	1/17/2024	75,000
9	M.L	10/10/2023	1/17/2024	75,000
10	O.A	9/25/2023	12/26/2023	3,277,468
11	U.K.T	12/30/2023	3/27/2024	95,988
12	F.SH.U	8/27/2023	11/22/2023	184
13	F.SH.U	8/28/2023	11/22/2023	3,342
14	K.K	1/30/2023	4/24/2023	609,000
15	O.A	8/30/2023	11/22/2023	965
16	I.Sh	10/5/2023	12/27/2023	22,600
17	B.E	8/24/2023	11/15/2023	95,541
18	O.T.T	1/22/2024	4/10/2024	294,000
19	I.S	2/1/2024	4/18/2024	117,600
20	XH.GJ	6/11/2023	8/24/2023	49,440
21	E.	10/31/2023	1/12/2024	127,200
22	P.SH sh.a	12/4/2023	2/15/2024	1,865
23	K.K	1/22/2023	4/3/2023	1,044,432
24	K.S	5/18/2023	7/23/2023	4,587,235
25	E.	8/31/2023	11/5/2023	130,080
26	F.SH.U	10/24/2023	12/28/2023	326,692
27	B.A	9/12/2023	11/15/2023	64,000
28	F.SH.U	9/23/2023	11/22/2023	4,266
29	F.SH.U	9/23/2023	11/22/2023	604
30	A.Q	9/8/2023	11/5/2023	315,000
31	V.K	9/8/2023	11/5/2023	84,000

32	B.A	1/10/2023	3/8/2023	106,000
33	C.P	8/30/2023	10/25/2023	58,000
34	F.SH.U	9/28/2023	11/22/2023	5,812
35	A.M	11/3/2023	12/27/2023	510,000
36	D.P.2	8/30/2023	10/23/2023	8,583,973
37	O.A	9/29/2023	11/22/2023	1,339
38	F.SH.U	12/29/2023	2/20/2024	409,348
39	I.S	6/12/2023	8/3/2023	426,960
40	B.A	9/3/2023	10/25/2023	41,150
41	M.D	10/31/2023	12/21/2023	588,048
42	C.P	1/17/2023	3/8/2023	58,000
43	E.	8/15/2023	10/4/2023	126,000
44	N.C	9/26/2023	11/15/2023	60,404
45	S.A	10/16/2023	12/5/2023	101,400
46	XH.N.SH.G	1/8/2023	2/26/2023	335,856
47	I.S	5/25/2023	7/13/2023	2,810,734
48	O.A	9/6/2023	10/25/2023	26,725
49	F.SH.U	2/22/2024	4/10/2024	281,423
50	O.T.T	9/14/2023	11/1/2023	252,500
51	Inply	12/21/2022	2/5/2023	110,400
52	C.P	2/26/2023	4/13/2023	1,908,000
53	K.S	11/14/2022	12/29/2022	1,357,036
54	C.P	9/28/2023	11/12/2023	295,108
55	I.	1/23/2023	3/8/2023	139,200
56	F.SH.U	1/22/2024	3/6/2024	296,543
57	I.G	12/30/2023	2/11/2024	738,385
58	O.A	1/30/2023	3/14/2023	7,680
59	K.K	10/29/2023	12/11/2023	118,200
60	O.A	1/4/2024	2/15/2024	1,300
61	O.A	1/4/2024	2/15/2024	16,998
62	O.A	1/4/2024	2/15/2024	16,998
63	P.SH sh.a	1/4/2024	2/15/2024	74,746
64	E.T.T	9/13/2023	10/25/2023	39,500
65	O.T.T	9/20/2023	11/1/2023	1,200,000
66	F.SH.U	6/29/2023	8/9/2023	4,199
67	S.C	10/12/2023	11/22/2023	144,400
68	P.SH sh.a	1/7/2024	2/15/2024	1,080
69	O.A	3/30/2023	5/8/2023	21,015
70	F.SH.U	2/23/2023	4/2/2023	443,620
71	I.E.B.S	2/23/2023	4/2/2023	5,721
72	F.SH.U	5/25/2023	7/2/2023	312,580
73	K.K	6/8/2023	7/16/2023	86,400
74	F.SH.U	7/30/2023	9/6/2023	348,868
75	P.S	7/31/2023	9/7/2023	242,773
76	S.C	8/7/2023	9/14/2023	684,000
77	F.N.A	10/26/2023	12/3/2023	974,206
78	K.	6/19/2023	7/26/2023	246,000
79	I.T.T	6/19/2023	7/26/2023	58,900
80	F.SH.U	9/24/2023	10/31/2023	304,516
81	D.P.SH.T.R	2/11/2024	3/18/2024	3,000
82	C.P	2/27/2023	4/4/2023	58,000
83	E.T.T	9/19/2023	10/25/2023	40,399
84	I.O	10/15/2023	11/20/2023	265,133
85	F.SH.U	11/23/2023	12/28/2023	344,836
86	F.SH.U	1/24/2023	2/28/2023	284,356
87	O.A	2/7/2023	3/14/2023	16,873
88	O.A	2/7/2023	3/14/2023	2,000
89	O.A	2/7/2023	3/14/2023	1,300
90	F.SH.U	3/22/2023	4/26/2023	337,780

91	A.	6/14/2023	7/19/2023	1,450
92	I.O	8/15/2023	9/19/2023	13,083
93	M.A	9/20/2023	10/25/2023	10,000
94	E.	10/1/2023	11/5/2023	128,040
95	D.P.2	10/3/2023	11/7/2023	30,219,132
96	S.C	10/8/2023	11/12/2023	144,400
	Totali			68,674,974

Burimi i të dhënave INSTAT, përpunuar nga GA.

Drejtimi 2.3 Auditimi i llogarive vjetore

Aneksi nr.1:

Tabela nr. 1 Fonde te pashpenzuara nga sponsorizimet

në lekë

Donatori	Gjendja me 01.01.2023	Hyrje	Shpenzime	Gjendja me 31.12.2023
PPP (gopa)	57,204,435	2,457,542	3,996,521	55,665,456
ADENDIUM	2,155,163			2,155,163
INSTAT KOSOVE	1,391,891			1,391,891
Unesco	632,089			632,089
Puna Gjellbër	399,069			399,069
AMF	1,674,928			1,674,928
Korrupsioni 1+2	199,354			199,354
Te ndryshme	324,115			324,115
Oferta Drurit	20,528			20,528
Migracioni	8,882			8,882
ASE (Sociale Evropiane)	121,177			121,177
UET	1,846,193			1,846,193
UNFPA	251			251
Shëndetësia EHS	872,186			872,186
Turizmi ne familje	975,209			975,209
Turizmi ne ndërmarrje	1,209,320			1,209,320
Arsimi i te rriturve	2,046,045			2,046,045
Salstat	1,452,439	787,396	1,822,646	417,189
SMEI	1,618,300			1,618,300
UNDP (anketa e te moshuarve)	-249			-249
SHUMA	74,151,325	3,244,938	5,819,167	71,577,096

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

*Tabela nr. 2:*Llogaria analitike 4342 “Operacione me shtetin(Te drejta)”:

në lekë

Nr. rreshti	Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023
69	42	Detyrime ndaj personelit/Struktura& punonjës me kontrate	20,015,206.00
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa/Tatim mbi TR personale dhe ne burim	6,270,057.00
75	435	Sigurime Shoqërore/Struktura Instat	6,321,726.00
76	436	Sigurime Shëndetësore/Struktura Instat	955,446.00
77	437,438	Organizma të tjerë shtetërore/Sig Shoq&Shend për punonjësit me kontrate	6,442,766.00
82	467	Kreditorë të ndryshëm	160,359.00
Totali			40,165,560.00

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tabela nr. 3: Aktivitet afatgjata dhe ndryshimet midis tyre

në lekë

GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA (VLERA NETO)	VITI 2023
---	------------------

N r	Llogarit ë	EMERTIMI	Vlera neto 2023	Vlera neto 2022	Ndryshimi ne vlerë neto	Pesh a 2023	Pesh a 2022
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme	26,816,533	5,326,495	21,490,038	6%	2%
8	212	Ndërtime e Konstruksione	107,353,957	113,004,165	(5,650,208)	22%	46%
10	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	18,009,324	20,396,968	(2,387,644)	4%	8%
11	215	Mjete transporti	5,800,378	6,038,842	(238,464)	1%	2%
14	218	Inventar ekonomik	323,680,024	98,853,390	224,826,634	67%	41%
		TOTALI	481,660,217	243,619,861	238,040,356	100%	100%

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tabela nr. 4: Detyrimet afatshkurtra.

në lekë

Llogaria	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Diferenca
	I. Detyrimet Afatshkurtra	62,328,457	38,351,567	23,976,890
	1. Llogari të Pagueshme	62,328,457	38,351,567	23,976,890
42	Detyrime ndaj personelit	20,015,206	13,560,760	6,454,446
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	6,270,057	1,462,312	4,807,745
435	Sigurime Shoqërore	6,321,726	3,959,995	2,361,731
436	Sigurime Shëndetësore	955,446	487,512	467,934
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	6,442,766	4,409,905	2,032,861
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	160	160	-
467	Kreditorë të ndryshëm	22,041,308	14,185,203	7,856,105
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	281,785	285,720	(3,935)

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tabela nr. 5: Pasqyra e aktiveve neto/fondeve neto.

në lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022
C	AKTIVET NETO/ FONDET NETO (A-B)	567,887,086.00	332,660,386.00
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	167,326,428.00	63,168,462.00
12	Rezultatet e mbartura	74,151,327.00	63,295,313.00
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	(2,574,228.00)	10,856,013.00
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	296,350,065.00	100,614,963.00
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	32,633,494.00	94,725,635.00

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tabela nr. 6: Shpenzimet 2023

në lekë

74	B	SHPENZIMET	1,214,118,448
75	600	I. PAGAT DHE PËRFITIMET E PUNONJËSVE	527,345,798
76	6001	Paga, personel i përhershëm	246,366,617
77	6002	Paga personel i përkohshëm	280,979,181
80	601	II. KONTRIBUTE TË SIGURIMEVE	86,682,487
81	6010	Kontributi i sigurimeve shoqërore	77,603,557
82	6011	Kontributi i sigurimeve shëndetësore	9,078,930
83	602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	598,544,921
85	6020	Materiale zyre e të përgjithshme	2,177,847
86	6021	Materiale dhe shërbime speciale	41,718,618
87	6022	Shërbime nga të tretë	472,671,070

88	6023	Shpenzime transporti	7,840,620
89	6024	Shpenzime udhëtimi	20,565,484
90	6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	14,518,246
91	6026	Shpenzime për qiramarrje	38,215,401
92	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	818,960
94	6029	Shpenzime të tjera operative	18,675
101		V. TRANSFERIME KORRENTE	1,545,242
104	6041	Transferime korrente tek institucione qeveritare të ndryshme	414,000
114	6061	Transferta të paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,131,242

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tabela nr. 7: Rakordimi me thesarin Shpenzimet 2023

'në lekë

Shpenzimet korrente				
Nr Ilog	Shpenzimet	Rakordimi me Thesarin	Pasqyrat financiare	Ndryshimi
600	Pagat dhe përfitimet e punonjësve	516,361,742	527,345,798	(10,984,056)
601	Kontribute të sigurimeve	84,075,748	86,682,487	(2,606,739)
602	Blerje mallra e shërbime	595,979,065	598,544,921	(2,565,856)
604	Transferime korrente tek institucione qeveritare të ndryshme	418,800	414,000	4,800
606	Transferta të paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,114,264	1,131,242	(16,978)
	Totali	1,197,949,619	1,214,118,448	(16,168,829)

Burimi: Pasqyra Financiare INSTAT Aparati/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

VI. LISTA E DOKUMENTEVE

1. Akt Konstatimi nr. 1, datë 04.07.2024 “Mbi auditimin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit”;
2. Akt Konstatimi nr. 2, datë 04.07.2024 “Mbi auditimin e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës”;
3. Akt Konstatimi nr. 3, datë 04.07.2024 “Mbi auditimin e llogarive vjetore”;
4. Akt Konstatimi nr. 4, datë 04.07.2024 “Mbi auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”;
5. Akt Konstatimi nr. 5, datë 04.07.2024 “Mbi auditimin e prokurimeve publike”;
6. Akt Konstatimi nr. 6, datë 04.07.2024 “Mbi auditimin e vlerësimit të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe vlerësimi i Auditimit të Brendshëm”;
7. Akt Konstatimi nr. 7, datë 04.07.2024 “Mbi auditimin e inventarizimit të pajisjeve elektronike (tableta) në kuadër të Projektit të Cens-it 2023, përzgjedhjen e magazinimit të tyre, dokumentimit të gjurmës, kushteve dhe mbrojtjen e të dhënave sensitive që mbartin”
8. Akt Verifikimi nr. 1, datë 30.05.2024 “Për kryerjen e verifikimit në lidhje me Magazinën Qendrore në INSTAT”;
9. Akt Verifikimi nr. 2, datë 04.06.2024 “Për kryerjen e verifikimit në lidhje me Magazinën CENS në INSTAT”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. A.Gj, Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
2. E.Sh, anëtare

3. J.K, anëtar
4. M.M, anëtare
5. A.C, anëtar

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

Q.C